

Bisedimet
Drejt emrit të ri
pa mbështetjen
e VMRO-së

Fq.4



**KURSE
FALAS**

Universitetet
bëjnë punën e
shkollave të mesme

Fq.7



Kroacia, më e
pakënaqura e BE-së

Fq.19

Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3380 · E hënë, 4 qershor 2018

17°C | 29°C

15 DEN



KOHA për
sport

Fq.12-15

EDITORIAL

**Kosova në
agjendat e
munguara të
investimeve**



Modelin e biznesit të suksesshëm në rajon po e përhap një afarist vizionar nga Shqipëria, ndërkohë që gazetarisë së ndreshme investigative të Kosovës (ku nuk i ka fut hundët kapitali i fëlliqtë i mafias ballkanike) i mbetet të humtojë historinë e shanseve të dështuara në investime, përfshi edhe Shkupin si alternativë e shërimin të mijëra pacientëve kosovarë, por edhe e shumë shoppingjeve e...

Fq.2

GLOBI

**Slovenia,
edhe një
problem tjetër
për BE-në**

Fq.17

RAJON

**Serbia mban të
bllokuar linjën
energjetike
Kosovë-
Shqipëri**

Fq.16



VAZHDON ZHVILLIMI I PABARABARTË RAJONAL I MAQEDONISË

AUTOSTRADAT QË ANASHKALOJNË SHQIPTARËT



Dallime në rajonet ku punohet tregon vet harta e publikuar nga ministri Sugarevski lidhur me ndërtimet dhe rikonstruimet e autostradave dhe rrugëve rajonale të vendit. Kështu, për autostradën Gostivar-Kërçovë, në Strategjinë e punës së Ministrisë së Transportit është paraparë që sivjet ose në pjesën e parë të vitit të ardhshëm të përfundojë vetëm projektimi i projektit. Kështu do të ndodhë edhe me autostradën prej më rreth 20 kilometra Shkup-Bllacë

Fq.3

Ikin edhe kaminonxhinjtë

Shkup, 3 qershor - Nga Maqedonia nuk ikin vetëm mjekët apo programuesit, por edhe vozitësit profesionist të kamionëve si dhe mjeshtrit e profileve të ndryshme të ndërtimtarisë. Njohësit e sektorit të transportit thonë se në shtet në vitet e fundit janë importuar me mijëra e mijëra kamionë të profileve të ndryshme, por megjithatë mungojnë vozitësit profesionist që do të transportojnë mallra brenda dhe ja-

shtë Maqedonisë. Bile me pensionimin e vozitësve apo ikjen e tyre jashtë shtetit, është shumë vështirë që ato të zëvendësohen me shoferë të tjerë me përvojë. Nga Asociacioni i shoqatave të punëdhënësve të kompanive që kryejnë transport "Makam-Trans", thonë se ikja pas një vendi pune të paguar më shumë jashtë shtetit, por edhe pakujdesia e institucioneve relevante që të krijojnë kuadër...

Fq.6



EDITORIAL

KOSOVA NË AGJENDAT E MUNGUARA TË INVESTIMEVE



Emin AZEMI

Mbrëmjen e së enjtes në Shkup u prezantua projekti "Skopje East Gate", një prej qendrave më moderne dhe më të mëdha tregtare të rajonit, përfshi edhe një kompleks banesor bashkë me parkingje dhe objekte tjera në një sipërfaqe prej 155 mijë m². Është investuesi i njëjtë nga Shqipëria, që ngrii qendrën tregtare "Skopje Cuty Mall". Gjatë ceremonisë së hapjes, pronari i "Balfin Group" përmendi tri përfitime nga kjo qendër gjigante tregtare e banimi. Së pari - çmime më të lira, së dyti - shitje moderne dhe së treti - kënaqësia e konsumatorëve për të kaluar kohën e lirë, por edhe për të blerë më lirë.

Investimi fillestar në këtë projekt do të jetë 180 milion euro, kurse rrumbullakimi i gjithë projektit pritet të kushtojë mbi 300 milionë euro. Bëhet fjalë për një nga investimet më kapitale deri më tani në Maqedoni, nga një subjekt i vetëm afarist, ndërkohë që gjithë investimet e huaja (prej shumë kompanive) për këto pesëmbëdhjetë vite nuk kalonin mbi 250 milion euro.

Gjithë kush që do ta lexojë këtë editorial do ta kuptojë si marketing për një biznes që po shtrihet në rajon. Në fakt, përtej marketingut, i cili mund të bëhet edhe pa këtë editorial, projekti në fjalë do të duhej të nxis shumëkënd, sidomos në Kosovë, të vrajë mendjen se cili është aktualisht patriotizmi ekonomik, kulturor, arsimor, shëndetësor i klasës politike kosovare, e cila po ndërton rrugë moderne për t'i dërgua më shpejt qytetarët e këtij vendi në Shkup, atje ku ka spitale më cilësore, atje ku investimet e jashtme (sidomos nga Shqipëria) po krijojnë oaza parajsë për vizitorët, atje ku mirëmbahen e menaxhohen disa qendra skijimi e rekreimi, atje ku aeroporti ndërkombëtar ka aq shumë fluks udhëtimesh sa që ofron shërbime edhe për shumë kosovarë, atje ku vikendeve sheh mijëra makina nga Prishtina, Ferizaji, Mitrovica, Gjilani të parkuara pranë qendrave tregtare të Shkupit, e shumë e shumë pika të tjera referimi që të krijojnë përshtypjen sikur Shkupi është krijuar për inati të Kosovës.

Në këto 19 vite liri dhe 10 vite pavarësi, Kosova përpos që prodhoi shumë parti për t'ia hangër kryet njëra tjetrës, krijoi edhe kushte ideale për hajna të uritur për pushtet, të cilët shumëkush i quan politikan. Nuk u ndërtua një Spital i hairit, edhe përkundër faktit se në shumë

klinika e qendra spitalore të Europës, Amerikës e mbarë botës ke qindra mjekë nga Kosova që sot kryejnë me sukses ndërhyrjet më të ndërlikuara kirurgjikale në vendet ku ata punojnë. Nuk u ngrit një Universitet prestigjioz, me impakt madje edhe rajonal, edhe përkundër faktit se Kosova është një eksportues mjaft cilësor i kuadrove që sot i ke nëpër Japoni, Kanada, Zvicër, Skandinavi e gjetiu, të cilët merren me zbulime e projekte të rralla në fushat përkatëse, nuk u ndërtuan fabrika, që do të ishin degë e ndonjë parku industrial europian apo gjiganti prodhues, në të cilat do të bëhej montimi, prodhimi, përpunimi i pjesëve për automobila, aeroplanë, por edhe dhe për paisje e aparatura të ndryshme etj., ku do të punësoheshin të paktën 100 mijë veta, ose gati gjysmë milion anëtarë familjesh nuk do të kishin nevojë të mendojnë për ta siguruar kafshatën e bukës diku jashtë vendlindjes.

"Balfin Group" shkon në Shkup dhe hap 2000 vende të punës. Saimir Mane këtë e bën pa pasur nevojë të shtyhet me bërryla për t'u bërë anëtar i ndonjë partie politike dhe anëtarësimin për ta përdorur për favore personale, duke dëbuar pastaj të gjithë ata që mendojnë me tru e që mund të jenë rrezik i aktivistëve halabakë që diplomën e shkollës fillore e marrin pasi të punësohen diku ku merret rrogë pa punu, ose masterin, doktoraturën (pa shkollë të mesme) e sigurojnë frik e frik pasi të jenë bërë deputetë, ministra, drejtorë etj. Ai këtë e bën pa pasur nevojë të kushtëzojë njerëzit me lloj-lloj poshtërsish për të siguruar një vend pune, ose të negociojë me investitorë të huaj, siç bëjnë shumica e njerëzve të politikës në Kosovë, ku në fund dështon investimi sepse njëri nga akrobatë e kryeministrit apo ministrit ka kërkuar një kesh-avans të vockël prej 3 milion euro, si kusht për të startuar biznesi. Shumë kompani europiane, por edhe nga Lindja (sidomos me prejardhje nga biznesmenë shqiptarë të Turqisë), sot do të punonin në Kosovë, sikur në krye të këtij shteti të kishte patriotë të vërtetë, të cilët parandë publikë do ta konsideronin të shenjtë, kurse elektoratin nuk do ta shihnin si dele që duhet qethur në çdo cikël zgjedhor.

Në vend se të ishin marrë me projekte zhvillimore, sa janë marrë me Vetëvendosjen dhe me tema të kota që s'kanë prodhuar kurrfarë debati cilësor, në

Modelin e biznesit të suksesshëm në rajon po e përhap një afarist vizionar nga Shqipëria, ndërkohë që gazetarisë së ndreshme investigative të Kosovës (ku nuk i ka fut hundët kapitali i fëlliqtë i mafias ballkanike) i mbetet të hulumtojë historinë e shanseve të dështuara në investime, përfshi edhe Shkupin si alternativë e shërimit të mijëra pacientëve kosovarë, por edhe e shumë shoppingjeve e rekreimeve, si pasojë e politikave korruptive e kriminale të klasës politike në këto 19 vite

vend se të kishin inicuar projekte me interes publik, sa janë kujdesur për trashësinë e xhëpave të tyre privat, në vend se të kishin lidhur ura bashkëpunimi me shtetet tjera europiane (e jo takime diskrete me Serbinë) për punë e që do t'ia shihnin hajrin gjithë qytetarët, sa kanë shëruar komplekse katunareske duke pushuar nëpër hotele të shtrenjta me paratë e shtetit, në vend se të kishin promovuar një shoqëri të lirë me gazetarë kritike e profesionale e jo me (disa) gazetarë zagarrë që paradite i ke nëpër redaksi, e pas dite në kuloret mafioze të politikës kosovare (jo rrallë edhe nëpër do kruzhoqe politiko-biznesore serbe), pushtetarët e deritanishëm të Kosovës për këto 19 vite do të kishin ngritur një mini paraajsë në këtë cep shkëmbor të Europës Juglindore, që do t'ia kishin lakmi edhe vendet tjera të rajonit.

Modelin e biznesit të suksesshëm në rajon po e përhap një afarist vizionar nga Shqipëria, ndërkohë që gazetarisë së ndreshme investigative të Kosovës (ku nuk i ka fut hundët kapitali i fëlliqtë i mafias ballkanike) i mbetet të hulumtojë historinë e shanseve të dështuara në investime, përfshi edhe Shkupin si alternativë e shërimit të mijëra pacientëve kosovarë, por edhe e shumë shoppingjeve e rekreimeve, si pasojë e politikave korruptive e kriminale të klasës politike në këto 19 vite.

MEDIACitate

GJYSMA E FËMIJËVE NË AFGANISTAN NUK SHKOJNË NË SHKOLLË

Rreth 3.7 milionë fëmijë në Afganistan, e kanë të pamundur të shkojnë në shkollë, për shkak të konfliktit të vazhdueshëm, varfërisë, diskriminimit ndaj vajzave, raporton UNICEF. Në bazë të këtij raporti, shënohet rritja më e madhe e mos shkuarjes në shkollë që nga viti 2002, duke bërë thirrje kështu për angazhim të madh të qeverisë afgane dhe shoqërisë civile. "Tani është koha për një përkushtim më të madh, për t'ju mundësuar vajzave dhe djemve mësim të barabartë, atyre u duhet progres në jetën e tyre", tha përfaqësuesi i UNICEF në Afganistan, Adele Kodr. Raporti përfshin diskriminimin ndaj vajzave, që përbën 60 për qind prej tyre që iu është mohuar mësimi në shkollë. Në disa province, më shumë se 85 për qind të vajzave nuk shkojnë në shkollë.

(REL, 3 qershor)

BRITANI, DEPUTETËT DO TË MARRIN UDHËRRËFYESIN SI TË NDALOJNË BREXITIN

Anëtarët e Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar, do të pranojnë një udhërrëfyes javën e ardhshme nga organizata Best for Britain, në të cilën do të përfshihen detaje se si ata mund të ndalojnë Brexitin dhe të organizojnë një referendum të dytë. Organizata pro-BE e mbështetur nga miliarderi George Soros, ka pranuar së fundmi një donacion në vlerë prej 2.3 milionë sterlina të cilat do të duhet të shfrytëzohen në përpjekjet për të ndryshuar opinionin publik lidhur me qëndrimin e qytetarëve ndaj anëtarësimin në BE.

Grupi në fjalë do të publikojë edhe një tabelë me të dhëna se si mund të organizohet një referendum i dytë. Publikimi do të jetë pjesë e fushatës së organizatës në fjalë, për manifestin i cili do të zhvillohet më 8 qershor.

Best for Britain do të argumentojë se deputetët, duhet të përfshijnë amendamentet në ligjin për tërheqjen e Britanisë nga BE-ja, ku bëhet thirrje për një referendum të dytë lidhur me marrëveshjen përfundimtare të arritur nga qeveria e kryeministres Theresa May. Grupi i cili ka nisur fushatën thotë se mbajtja e referendumit të dytë, teorikisht është i mundur.

"Mendojmë se njerëzit meritojnë një shans për të krahasuar marrëveshjen që ne mund ta arrijmë, me atë që aktualisht kemi. Ajo që është e qartë është se ne nuk mund të kemi një Brexit të gjenjeshë, ndërsa debati rreth kufirit irlandez tregon diçka tjetër", i tha të përditshmes "Guardian", Eloise Todd, shef Ekzekutiv i Best for Britain.

Në fillim të javës që po lëmë pas, Soros deklaroi se Brexit është proces jashtëzakonisht i dëmshëm për të dyja palët, dhe se dalja do të jetë një proces afatgjatë, i cili do të zgjasë më shumë se pesë vite.

(The Guardian, 3 qershor)

Kush ishte Binak Alia?

Binak Alia (1805-1895) ishte prijës popullor i kryengritjeve antiosmane të malësorëve të Gjakovës e të Rrafshit të Dukagjinit në vitet 1840-1880. Lindi në fshatin Bujan të Tropojës.

Përmendet së bashku me Sokol Ramën që në vitin 1845 si drejtues i mijëra kryengritësve për të përzënë garnizonin turk të Gjakovës. Binak Alia u shqua gjithashtu në kryengritjet lokale të malësorëve të veriut gjatë viteve '60. Mori pjesë në Lidhjen Shqiptare të Prizrenit. Gjurmët e tij i ndoqi i nipi, Mic Sokoli. Ka lënë emër si pleqnar i mençur, sidomos për pajtimin e gjaqeve.



NËSE NUK E KENI DITUR...

Dallime në rajonet ku punohet tregon vet harta e publikuar nga ministri Sugarevski lidhur me ndërtimet dhe rikonstruimet e autostradave dhe rrugëve rajonale të vendit. Kështu, për autostradën Gostivar-Kërçovë, në Strategjinë e punës së Ministrisë së Transportit është paraparë që sivjet ose në pjesën e parë të vitit të ardhshëm të përfundojë vetëm projektimi i projektit. Kështu do të ndodhë edhe me autostradën prej më rreth 20 kilometra Shkup-Bllacë

Koha Vedat MEMEDALIU

Shkup, 3 qershor - Punimet intensive në infrastrukturën e Maqedonisë Lindore nuk kanë të ndalur. Është Ministria e Transportit dhe Lidhjeve ajo që duket se ka harruar pjesët tjera të Maqedonisë, ndërsa po vazhdon zhvillimin e pabarabartë të vendit, në veçanti pjesët që janë të banuar kryesisht me shqiptarë.

Pas nisjes së punëve muaj më parë të autostradës të ashtuquajtur "Ekspres Gradsko-Prilep", dy ditë më parë, ministri i Transportit, Goran Sugarevski i shoqëruar nga kryeministri Zoran Zaev dhe nga drejtori i ndërmarrjes publike "Rrugët Shtetërore", Zoran Kitanov, kanë marrë pjesë në fillimin e punimeve të fazës së dytë të autostradës "Ekspres Shtip-Radovish" me gjatësi prej 23.5 kilometra dhe e cila shtrihet nga qarkorja tek fshati Sofilari të Shtipit deri tek qarkorja afër minierës "Buçim" të Shtipit.

Autostrada "Ekspres Shtip-Radovish", siç ka thënë Sugarevski, do të ketë 11 ura, prej të cilëve një në gjatësi prej 320 metra, ndërsa do të kushtojë 27 milionë euro. Veç kësaj, ministri Sugarevski potencoi se ndërtimi i kësaj rruge ekspres është me rëndësi të jashtëzakonshme për qytetarët e Maqedonisë Lindore dhe Juglindore, pasi të njëjtit do të kenë edhe transport më të shpejt të prodhimeve bujqësore dhe industriale. Sugarevski po ashtu ka informuar se 320 milionë euro tjera do të investohen në ndërtimin e rrugëve ekspres në lindje dhe perëndim dhe në ndërtimin e autostradës Shtip-Miladinoc.

100 DITËT E SUKSESSHME TË SUGAREVSKIT

Po në muajin maj kanë filluar punët intensive edhe për përfundimin e autostradës Miladinov-Shtip me gjatësi 47 kilometra. Kjo autostradë kishte filluar ndërtimin që në vitin 2014, ndërsa disa herë ishin ndërprerë për shkak të ndryshme. Ministri Sugarevski, më 16 maj të këtij viti, u zotua se kjo autostradë do të përfundojë në fund të shtatorit.

VAZHDON ZHVILLIMI I PABARABARTË RAJONAL I MAQEDONISË

AUTOSTRADAT QË ANASHKALOJNË SHQIPTARËT



Punime intensive po vazhdojnë edhe në autostradën e ashtuquajtur "ekspres" Gradsko-Prilep, një autostradë kjo krejtësisht e re nga ajo që aktualisht lidh këto dy qytete. Projekti në fjalë, i filluar zyrtarisht më 14 maj të këtij viti, sipas ministrit Sugarevski, paraqet një ndër projektet më të rëndësishme të Ministrisë për Transport dhe Lidhje.

"Autostrada ekspres 'Gradsko-Prilep' është e një rëndësie të veçantë për mua dhe Ministrinë e Transportit pasi me këtë autostradë sigurojmë një rrugë moderne dhe të sigurt, e cila do të stimulojë rritjen ekonomike të rajonit nga Vardari e deri në Rajonin e Pellagonisë", është shprehur atë kohë ministri Sugarevski, duke shtuar se nga kjo autostradë do të përfitojnë 250 mijë qytetarët e Manastirit, Prile-

pit, Gradskos, Rosomanit, Kavadarit dhe rrethinës. Autostrada ekspres Gradsko-Prilep, siç ka siguruar Sugarevski, do të përfundojë në vitin 2020, ndërsa është e gjatë 33.5 kilometra dhe që kushton 70 milionë euro.

HARROHEN AUTOSTRADAT GOSTIVAR-KËRÇOVË DHE SHKUP-BLLACË

Në 100 ditët e para të Qeverisjes LSDM-BDI, Sugarevski në profilin e tij në Facebook është lavdëruar se Ministria që drejton ai tashmë ka filluar edhe punimet në rrugën e re Shtip-Koçan, Koçan-Vinicë, Shtip-Radovish, Negotinë-Demir Kapi, Manastir-Kamenicë, Kërklino-Manastir, Manastir-Novaci, Berovë-Ratëvë, Petrovec-Katllanovë...

E vetmja autostradë që shkurt-

SHKUP-BLLACË, HISTORIA QË NUK KA FUND

Duket se autostrada e shumëpërfolur Shkup-Bllacë nuk do të nis as në fillim të vitit të ardhshëm, ashtu siç u paralajmërua me pompozitet nga zyrtarë shqiptarë të BDI-së. Tek tani del të kenë qenë gënjeshtër deklaratat për vite të tëra se "projekti studimor është nga fundi". Projekti ideor, ashtu siç thuhet tani, ka nis të përgatitet ndërsa njëjta sikurse viteve të kaluara, edhe kjo autostradë do të insistohet të ndërtohet me partneritet-publiko privat. Madje, ka zëra se në fund të 2019-ës dhe jo në fillim të vitit do të mund të nisin punimet. Nga ana tjetër, deri në fund të këtij muaji, autostrada Prishtinë-Hani i Elezit në gjatësi prej rreth 70 kilometra do të lëshohet në përdorim deri në afërsi të Kaçnikut.

ton rrugën drejt Shqipërisë, e që duhej të ishte kryer që në 2016, është ajo Kërçovë-Ohër-Strugë. Megjithatë, pas shumë keqpërdorimeve të qeverisë së kaluar, duket se kjo rrugë edhe tri vite nuk do të mund të lëshohet në përdorim. Së paku, kështu ka thënë ministri i Transportit, kur Parlamenti miratoi

aneks-marrëveshjen e re që kjo autostradë të shtyhet për përfundim deri në fund të vitit 2021.

Se me të vërtetë ka dallime në rajonet ku punohet, tregon harta e publikuar nga vet ministri Sugarevski lidhur me ndërtimet dhe rikonstruimet e autostradave dhe rrugëve rajonale të vendit. Kështu, për autostradën Gostivar-Kërçovë, në Strategjinë e punës së Ministrisë së Transportit është paraparë që sivjet ose në pjesën e parë të vitit të ardhshëm të përfundojë vetëm projektimi i projektit. Kështu do të ndodhë edhe me autostradën prej rreth 20 kilometra Shkup-Bllacë. Harta e Ministrisë së Transportit tregon se aktualisht punimet në terren po zhvillohen në autostrada eksprese Gradsko-Prilep, në atë Shtip-Koçanë, si dhe në Shtip-Radovish. Autostrada eksprese deri në fund të vitit do të nis edhe për rrugën Rankocë-Kriva Pallankë, Prilep-Manastir dhe në rrugën Strumicë-kufiri me Bullgarinë.

Veç kësaj, rehabilitimet e dy-tre rrugëve rajonale që kalojnë nëpër vendimet shqiptarë e të paralajmëruara disa muaj më parë, duket se nuk janë prioriteti i shpejtë i MTL-së. Rehabilitimi i rrugës Ropalcë-Mateç-Likovë nuk ka filluar akoma. Ashtu siç nuk ka filluar edhe rehabilitimi i rrugës Kumanovë-Opajë-Slupçan. Nuk ka filluar as rehabilitimi i rrugës Gostivar-Kolar, si dhe ajo Strugë-Qafë Thanë.



Harta e Ministrisë së Transportit tregon se aktualisht punimet në terren po zhvillohen në autostrada eksprese Gradsko-Prilep, në atë Shtip-Koçanë, si dhe në Shtip-Radovish. Autostrada eksprese deri në fund të vitit do të nis edhe për rrugën Rankocë-Kriva Pallankë, Prilep-Manastir dhe në rrugën Strumicë-kufiri me Bullgarinë

Të hiqet "Leka i Madh" dhe "Porta Maqedonia"

Shkup, 3 qershor - Përmendorja "Ushtari mbi kalë" dhe "Porta Maqedonia" janë ndërtime pa leje dhe për këtë arsye duhet të hiqen ose të legalizohen, thotë kryetari i Asociacionit të Arkitektëve, Marin Panovski, i cili ishte pjesë edhe e Komisionit për analizë të projektit "Shkupi 2014".

Në intervistën e të dielës të Radios Evropa e Lirë, Panovski thekson se grupi i punës për "Shkupi 2014" punon në parim që t'i konfirmojë parregullsitë gjatë marrjes së lejeve ndërtimore, gjegjësisht punë procedurale rreth ndërtimit.

"Mendoj se në të gjithë raportet e analizuar të deritanishme, skulptura, evidencuam se procedurat nga fillimi janë kundërligjore. Në këtë mënyrë në fakt të gjithë ndërtimet të cilët janë nga 'Shkupi 2014', këto që i kemi hulumtuar deri tani, mund të konsiderojmë se janë ndërtime pa leje. Që nga fillimi atë kompetencë që e ka për vendosje të përmendoreve, asnjë nuk është përmes Kuvendit, i cili është kompetent për vendosje të përmendoreve, të gjithë thuajse janë vendosur ose nga komuna ose nga Qyteti i Shkupit, nga ai moment e tutje gjithçka duhet të jetë e pavlefshme", tha Panovski. Sipas tij, duhet bëhet analizë më e thellë edhe pse, siç tha, janë shkelur të gjithë procedurat ligjore, duhet të hyhet në analizë më të thellë se çka ka në ato objekte, për shkak se në objektet në këtë periudhë pjesë më të madhe që i kemi hulumtuar janë skulptura. Në intervistë thotë se në projekt janë investuar shumë më e madhe e parave, ndërsa në fund që me atë pjesë do të jetë vendim politik, e jo profesional. "Deri tani janë përgatitur raporte për 'Ushtarin mbi kalë', porta 'Maqedonia' dhe atë skulpturën që është tek Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, ku është familja e Aleksandrit të Maqedonisë. Për fat të keq ende nuk mundemi t'i marrim, aq është e bllokuar puna sa që projektet nuk mund të merren për shkak se nuk dihet se ku janë. Në mënyrë procedurale janë udhëhequr në atë mënyrë që vendimi i komunës është me një emër, projekti është me emër tjetër, leja është me një emër të tretë", thotë Panovski. Sipas tij, vendimi është i pushtetit se nëse do ta respektojnë ligjin ose jo.

"Vendimi është se nëse do ta respektojnë ligjin ose jo. Dihet dhe bukur është përkrahur se si veprohet me objekte të ndërtuara pa leje. Mund ta dorëzojnë në legalizim, ndërsa ky gjithashtu është vendim, për shkak se ende vlen ligji. Komunitat mund t'i legalizojnë këto objekte, por për momentin janë ndërtime pa leje. Komunitat përmes detyrës zyrtare duhet të pyesin edhe se kush e ka dhënë lejen e ndërtimit, e cila nuk guxon të jepet, se kur janë ata njerëz dhe se nëse dikush do të përgjigjet për këtë", konsideron Panovski. Ai shpjegon se përveç Shkupit edhe i gjithë shteti ka probleme me planifikimin urban. Konsideron se planifikimi urban dhe arkitektura është kthyer në përgatitës së dokumentacionit.

NË PRITJE TË BISEDËS TELEFONIKE MES DY KRYEMINISTRAVE

DREJT EMRIT TË RI PA MBËSHTETJEN E VMRO-së



Deri më tani, përveç përkrahjes që ka marrë nga partitë shqiptarë në pushtet, Zaevi nuk gëzon asnjë përkrahje për zgjidhjen e emrit përmes parimit erga omnes nga VMRO-DPMNE. Po njëjtë as në Greqi kryeministri Aleksis Cipras nuk gëzon përkrahjen e opozitës që termi Maqedoni të jetë pjesë e emrit të shtetit

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 3 qershor - Zgjidhja e çështjes së emrit po hyn në fazën finale edhe atë përmes bisedimeve direkte dhe indirekte të dy qeverive të majta - ajo e Maqedonisë me në krye Zoran Zaevi dhe atë të Greqisë me në krye Aleksis Cipras. Mënshkrimi i marrëveshjes, siç ka konfirmuar Zaevi, pritet të ndodh në Prespë të Maqedonisë. Por deri tek nënshkrimi do të ketë ende punë, së pari sipas asaj që ka thënë së fundmi kryeministri i Maqedonisë, duhet mënjanuar disa probleme teknike të disa neneve të tekstit të marrëveshjes dhe më pas të zhvillojë një bisedë telefonike me homologun e tij grek, Aleksis Cipras.

"E dini që unë në fillim isha optimist, nuk do të doja të jap hollësi. Besoj se do ta gjejmë zgjidhjen, por sapo të mënjanohen këto mundësi teknike, menjëherë do të

ndodhë biseda telefonike dhe besoj se në afatin më të shpejt të mundur, mund të publikojmë se gjithë ajo që është dakorduar, si do ta procedonin më tej vetë procedurat, që të mbërrim në kohë para Këshillit Evropian për shkak se atëherë do të vendoset për marrje të datës për fillim të negociatave për Maqedoninë. Kështu, ditëve të ardhshme jemi maksimalisht të përkushtuar dhe fokusuar, bëhet fjalë për dakordim përmes nga marrëveshja, për hollësi të cilat janë të rëndësishme, për shkak se tani është koha që ato saktësisht të dakordohen", ka theksua Zaevi. Ai flet për gatishmërinë e tij dhe të Ciprasit për ta nënshkruar Marrëveshjen, por nuk ka siguri për përkrahjen e opozitës kur thotë se duhet të gjejë mënyrën për t'ia shpjeguar opozitës marrëveshjen për emrin.

"Unë jam i gatshëm për këtë bisedë, e di se edhe ai është i gatshëm, gjithsesi se për ne është e rëndësishme se si këtë do t'ia shpjegojmë opozitës tonë të Maqedonisë me qëllim që ta ftojme për të qenë së bashku me ne. Më e rëndësishme është që t'u shpjegojmë qytetarëve të Maqedonisë, por gjithashtu paralelisht është e rëndësishme

që t'i shpjegojmë edhe opozitës në Greqi, si dhe qytetarëve të Republikës së Greqisë", ka thënë Zaevi. Çdo marrëveshje, ka shtuar ai, ka aspirata përfundimtare jo vetëm të mënjanojë një problem të caktuar, por të jetë vegël për rritje të miqësisë midis dy popujve.

"Unë besoj se edhe ashtu do të pranohet nga të dyja palët. Kjo vetëm të jetë arsye që të rritet intensiteti dhe bashkëpunimi i ndërsjellë në çdo aspekt midis qytetarëve të Maqedonisë dhe qytetarëve të Republikës së Greqisë", u shpreh Zaevi. Nga qëndrimet e tij shihet se Zaevi deri më tani, përveç përkrahjes që ka marrë nga partitë shqiptare në pushtet, nuk gëzon asnjë përkrahje për zgjidhjen e emrit përmes parimit erga omnes nga partia më e madhe opozitare maqedonase. Kryetari i VMRO-DPMNE, Hristijan Mickoski, nga tubimi i së shtunës para Qeverisë së Maqedonisë theksoi se VMRO nuk do të mbështesë një ndryshim të Kushtetutës për shkak të ndryshimit të emrit kushtetues. Ai akuzoi se bisedimet për emrin po zhvillohen në fshehtësi dhe në mënyrë jotransparente dhe informacioni rreth kursit të tyre ishte kryesisht nga me-

ÇËSHITJA E EMRIT ËSHTË PUNË E PARLAMENTIT DHE JO E KISHËS

Nuk e japim emrin tonë, por kjo nuk është punë e kishës, por e Parlamentit të zgjedhur nga qytetarët, thotë Kryepeshkopi i Kishës Ortodokse Greke, Jeronimos në lidhje me çështjen e emrit. Si njofton korrespondentja e MIA-s nga Athina, Jeronimos mori pjesë në ceremoninë e hapjes së ekspozitës në qytetin Avlonas, ndërsa ish-zëvendëskryetari i Parlamentit grek dhe ish-deputet nga Demokracia e Re Jorgos Surlas, sipas një njoftimi nga KOG kërkoi nga kryepeshkopi "të dërgojë një mesazh se askush nuk mund ta japë Maqedoninë". "Ne nuk bëhemi grekë për vetëm një moment ose një ditë. Ne jemi grekë çdo ditë, çdo orë. Kisha mori qëndrim. Ajo tha qartë se nuk po e japim emrin tonë, por kjo nuk është punë e kishës. Kisha nuk bën protesta, qytetarët zgjedhën Parlament dhe Parlamenti është përgjegjës për këtë. Grekët janë përgjegjës për votimin dhe Parlamenti për të udhëhequr vendin", tha kryepeshkopi Jeronimos.

ZORAN ZAEV

jam i gatshëm për këtë bisedë, e di se edhe ai është i gatshëm, gjithsesi se për ne është e rëndësishme se si këtë do t'ia shpjegojmë opozitës tonë të Maqedonisë me qëllim që ta ftojme për të qenë së bashku me ne. Më e rëndësishme është që t'u shpjegojmë qytetarëve të Maqedonisë, por gjithashtu paralelisht është e rëndësishme që t'i shpjegojmë edhe opozitës në Greqi, si dhe qytetarëve të Republikës së Greqisë

diat greke. Bile, Mickosvki shkoi më larg me qëndrimet e tij kundër Zaevit duke kërkuar edhe zgjedhje të parakohshme parlamentare bashkë me ato presidencialet.

Ndryshe, sa i përket emrit, do të mbetet i hapur deri në moment të fundit propozimi "Republika e Maqedonisë Veriore", dhe propozimi tjetër "Republika e Maqedonia së Epërme". Me gjasë, emri i shtetit do të shpallet në Prespë. Ndërkaq sipas disa informatave jozyrtare, në Prespë do të marrë pjesë edhe kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, njëherësh dhe kryetar i partisë socialiste në pushtet, kjo për të garantuar përkrahjen e Shqipërisë zyrtare njëjtë siç bëri Bullgaria për emrin e ri.

Deri më 20 qershor, kryeministri Zaev tha para pak ditësh se do të tentohet të arrihet marrëveshje përfundimtare me Qeverinë greke. Ajo që më shumë gjasa do të ndodh është pranimi emrit të ri erga omnes nga pala maqedonase, dhe në rast dakordimi - marrëveshja do të ratifikohet në Parlament me shumicë e votave. Por pikërisht pranimi erga omnes që do të pasojë ndryshimet kushtetues po has në kundërshtim e fortë opozitar dhe presidentit Gjorge Ivanov, i cili kërcënoi kohë më parë se nuk do ta nënshkruaj ratifikimin e Marrëveshjes për emrin nëse pranohet parimi erga omnes.

Nga ana tjetër, në Greqi jo vetëm partia më e madhe opozitare Demokracia e Re, por edhe partitë të djathta në pushtet më Ciprasin kundërshtojnë ashpër termin Maqedoni në emrin e shtetit. Mbetet të shihet deri në fund nëse marrëveshja mes dy qeverive do të gëzojë përkrahjen e partisë opozitare në të dyja vendet.

Me gjasë, përkrahja do të jetë negative dhe vetëm një angazhim direkt i bashkësisë ndërkombëtare mund të detyrojë opozitën greke dhe maqedonase të ndryshojnë qëndrim.

TRANSPORTI ALTERNATIV NË SHKUP



ÇIKLISTËT KËRKOJNË SHTIGJE

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 3 qershor - Infrastruktura urbane për çiklistët në qytetin e Shkupit ende është larg kushteve që i ofrojnë metropolet evropiane. Zhvillimi i kulturës së çiklizmit ndonëse në Maqedoni nga viti në vit shënon rritje, megjithatë nga organizata "Na toçak" theksojnë se projektet e paralajmëruara nga Qyteti i Shkupit, për ofrimin e hapësirës së nevojshme për çiklistët në komunikacion, nuk janë realizuar as gjysma. Përderisa lufta për krijimin e rrugëve të përshtatshme për çiklistët, siç thonë nga kjo organizatë jo qeveritare vazhdon ende, ajo është e kënaqur se kauza e tyre për ndryshimin e mentalitetit të popullatës për shfrytëzimin e biçikletës si mjet transporti, ndër vite është përmirësuar. "Numri i çiklistëve në komunikacion vazhdimisht shënon rritje. Kjo mund të shihet edhe përmes të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës, sipas të cilit gjatë tetë viteve të kaluar pothuajse për trefishë është shtuar importi i biçikletave. Ndaj kësaj rritje ndikim të madh kanë pasur subvencionet që i ofrojnë më shumë komuna për blerjen e biçikletave. Por, fatkeqësisht nga ana tjetër zhvillimi i infrastrukturës dhe kulturës në përgjithësi nuk e ka arritur shkallën e nivelin e duhur që e

Për të evituar kaosin në komunikacionin rrugor në kryeqendër, shfrytëzimi i biçikletave si mjet alternative për transport paraqet zgjidhjen më të duhur

kërkojnë çiklistët", thonë nga iniciativa qytetare "Na toçak"

Për të evituar kaosin në komunikacionin rrugor në kryeqendër, shfrytëzimi i biçikletave si mjet alternative për transport, paraqet zgjidhjen më të duhur. Megjithatë, vetëdija e ulët pjesëmarrësve tjerë në komunikacion dhe mungesa e shtigjeve adekuate për çiklistët, kryesisht në Shkup ndikon që kjo kategori e qytetarëve të hasin në pengesa të natyrave të ndryshme deri në arrijten e destinacionit të duhur. Iniciativa qytetare "Na toçak" me rastin e përvjetorit të gjashtë të tyre ka rikujtuar se në vitin 2015, Qyteti i Shkupit e promovoi projektin "Shkupi qytet i çiklizmi 2017", i cili përfshin katër mashruta kryesore, respektivisht shtigje për biçikleta në një gjatësi prej 80 kilometra.

"Pavarësisht se ky projekt duhej të finalizohet deri në fund të vitit të kaluar, ne sot jemi në maj të 2018 dhe ato premtime nuk janë përmbytur as gjysma. Ndërkohë, administrata e re e ka vazhduar projektin me moton 'Shkupi qytet i çiklizmit'. Po ashtu, pas gjashtë vi-

teve në Shkup, nuk ekziston sistem funksional për marrjen me qira të biçikletave. Ky model i transportit edhe tutje vazhdon të jetë privilegj vetëm për ato që personalisht kanë blerë biçikleta. Ne vlerësojmë se gjatë këtyre gjashtë viteve të kaluara çështja e vjedhjes së biçikletave vazhdon të mos trajtohet si një problematike serioze nga policia, ndërsa numri i çiklistëve që janë viktimë në komunikacion nuk ulët", thonë nga iniciativa "Na toçak".

Njëkohësisht ata e theksojnë se edhe pse Shkupi nuk është transformuar në një qytet të çiklizmit siç e kërkojnë nevojat, megjithatë gjatë periudhës së kaluar janë regjistruar disa ndryshime pozitive. Semaforët për çiklistët, disa shtigje nëpër rrugët kryesore të Shkupit, kthimi i policisë në biçikleta, e kështu me radhë janë çështjet të cilat i vlerësojnë nga iniciativa "Na toçak". Ndryshe, shqetësimi i vazhdueshëm i shumë qytetarëve që biçikletën e kanë pjesë të pandarë nga jeta e tyre, vazhdon të mbetet vjedhja enorme e tyre. Mbyllja me dry dhe lidhja me zinxhirë të ndryshme është treguar si preventivë e pamjaftueshme, për shkak se vjedhësit, të cilët merren me këto lloj të hajnisë, janë aq të organizuar sa që brenda disa çasteve i çmontojnë të njëjtat.

Në tremujorin e parë, 235 milionë euro investime

Shkup, 3 qershor - Në tremujorin e parë të këtij viti, në Maqedoni janë futur 235 milionë euro investime të huaja direkte. Ky është tremujori më i suksesshëm i çdo tremujori që nga viti 2007 dhe krahasuar me vitin 2017, por edhe me shumata vjetore në vitin 2015, 2014, 2012, 2010 dhe 2009. Kjo u njoftua në një konferencë për shtyp nga zëvendëskryeministri për Çështjet Ekonomike, Koço Angjushev, duke iu referuar të dhënave të përgatitura

në bazë të metodologjisë së Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë. Investimet në tre muajt e parë të vitit janë investime direkte të huaja si dhe investime nga kompanitë ekzistuese në vend që, shpjegoi Angjushev, vazhduan me investimin duke njohur klimën e favorshme të biznesit. Sipas tij qeveria, gjatë kësaj periudhe ka nënshkruar mbi 12 kontrata, aktualisht bisedon me më shumë se 200 kompani, 30 prej të cilave janë në

fazën përfundimtare të bisedimeve. "Në vetëm një vit, është e sigurt se do të nënshkruhen 16 kontrata, 12 prej të cilave tashmë janë nënshkruar, katër janë në fazën përfundimtare, të cilat do të jenë në javët e ardhshme, 30 të tjera në fazën absolute përfundimtare", tha Angjushev. Duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve, ai informoi se masa e premtuar për rimbursimin e TVSH-së në fazën pilot do të zbatohet në disa komuna.

KRONIKË

Digjet emigranti, u godit nga rryma duke hyrë në Maqedoni

Një emigrant nga Iraku pësoi djegie nga goditja elektrike që mori pasi hipi në një tren mal-lrash në përpjekje për të hyrë në mënyrë të paligjshme në Maqedoni nga Greqia. Sipas Ministrisë së Brendshme, dje në orën 22:20 është raportuar se në Stacionin Hekurudhor të Gjevgjeli personi T.H.A.B. nga Iraku në moshën 29-vjeçare, i cili kishte hipur në një vagon të trenit të mallrave, pësoi një goditje elektrike. Irakiani me automjetin e urgjencës u çua në Spitalin e Përgjithshëm të Gjevgjelisë ku iu konstatua djegie e shkallës së dytë dhe të tretë dhe u transferua më pas në kompleksin e klinikave "Nënë Tereza" në Shkup.

11-vjeçarja përdhunohet nga babai i shoqes së saj

Një vajzë njëmbëdhjetëvjeçare u dhunua dje nga babai i shoqes së saj. Sipas Ministrisë së Brendshme, në Stacionin Policor të Prilepit, A.H. njoftoi se më 31 maj 2018, rreth orës 9, vajza e saj 11-vjeçare shkoi për të vizituar shoqen e saj, ku nga babai i saj R.C. (39) është abuzuar seksualisht. Përdhunuesi u dërgua në stacionin policor. U bë hetim dhe u morën masa për zbardhjen e plotë të rastit. (O.Xh)

Grup parlamentare për përkrahjen e romëve

Shkup, 3 qershor - Në Parlamentin e Maqedonisë sot do të themelohet dhe promovohet Grupi Ndërparlamentar për të Drejtat e Romëve në Maqedoni, i cili do të përbëhet nga deputetë të partisë të ndryshme politike. Nismëtarët e kësaj ideje janë deputetët Samka Ibraimoski, Dime Velkovski, Irena Stefoska, Maja Moraçanin, Liljana Popovska, Enes Ibrahim, Agim Murtezanov, Mirsada Emini-Hasani, Ivana Tufegxhiq, Gjylmser Kasapi, Pavle Bogoevski, Slavica Shumanska-Miteva, Sonja Mirakovska dhe Juliana Nikollova. Përveç deputetëve, në themelimin e grupit të ftuar janë përfaqësues të ambasadave dhe OJQ-ve në këtë fushë.

Edhe dy investime të reja në Bunarxhik

Shkup, 3 qershor - Dy investime të reja në Zonën Teknologjike Industriale Zhvillimore - Shkup 1 arrijnë në 11 milionë euro, në të cilat do të hapen 80 vende punë, paralajmëroi dje zëvendëskryeministri për Çështje Ekonomike Koço Angjushev. "Komisioni për këshilla ekonomike miratoi një rekomandim të Qeverisë për të miratuar marrëveshjet mbi ndihmën shtetërore për investime të "Zenit International produkt" nga Emiratet e Bashkuara Arabe prej tre milionë eurosh me 80 të punësuar që në zonën Bunarxhik do të prodhojë rezistenca për bojlerë dhe të kompanisë turke "Balkanlar plastik" e cila do të investojë tetë milionë euro në kapacitet për prodhimin e paketimit të plastikës së derdhur dhe gjithashtu do të sigurojë 80 vende pune, tha Angjushev në një konferencë shtypi. Zëvendëskryeministri njoftoi se në tremujorin e parë të këtij viti në Maqedoni, sipas të dhënave dhe në bazë të metodologjisë së BPRM, janë futur 235 milionë euro investime të huaja direkte, të cilat, siç theksuan, janë një shumë rekord në 12 vitet e fundit. Angjushev nuk ka komentuar mbi kërkesën për zgjedhje të parakohshme parlamentare nga opozitarja VMRO-DPMNE nga tubimi i djeshëm, por vuri në dukje se zgjedhjet shumë të shpeshta nuk janë të favorshme për aktivitetet ekonomike. Për kritikën e opozitës ka njoftuar se do të përgjigjen me argumente dhe shifra.

Publike edhe shpenzimet e kryetarëve të komunave

Shkup, 3 qershor - Qeveria e ka përshëndetur konkluzionin e Këshillit drejtues të Bashkësisë së Njësisë të Vetëqeverisjes Lokale (BNJVL), e cila u ka rekomanduar të gjithë kryetarëve të komunave që të fillojnë ta zbatojnë Veglën për llogaridhënie për shpenzimet e bartësve të funksioneve publike. "Ky vendim fiton rëndësi edhe më të madhe nëse merret parasysh fakti se pushteti lokal në Republikën e Maqedonisë është tërësisht i pavarur në krijimin e politikave të tyre, dhe për këtë arsye pranimi i këtij rekomandimi flet për vetëdijen e lartë edhe të përfaqësuesve të vetëqeverisjes lokale për rëndësinë e transparencës dhe llogaridhënies para qytetarëve dhe të nivelit të njësisë të qeverisjes lokale", njoftoi sot shërbimi qeveritar për informim. Vendimi i KD të BNJVL-së vjen pas takimit të realizuar të punës midis ministrit pa resor i angazhuar për Komunikime, Llogaridhënie dhe Transparencë Robert Popovski dhe Petre Shilegov, si kryetar i KD të BNJVL-së, në të cilin biseduan për mundësitë, Veglën për llogaridhënie të cilët Qeveria e zbaton për shpenzimet zyrtare të ministrave dhe bartësve të tjerë të funksioneve publike, të zbatohet edhe në kuadër të pushtetit lokal.

MIGRIMI I PROFESIONISTËVE

IKIN EDHE KAMIONXHINJTË



Deri në vitin 2020, në tërë Bashkimin Evropian do të mungojnë 1 milion vozitës profesionist të kamionëve për shkak të vajtjes në pension të një pjese të madhe të vozitësve në shtetet perëndimore

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 3 qershor - Nga Maqedonia nuk ikin vetëm mjekët apo programuesit, por edhe vozitësit profesionist të kamionëve si dhe mjeshtrit e profileve të ndryshme të ndërtimeve. Njohësit e sektorit të transportit thonë se në shtet në vitet e fundit janë importuar me mijëra e mijëra kamionë të profileve të ndryshme, por megjithatë mungojnë vozitës profesionist që do të transportojnë mallra brenda dhe jashtë Maqedonisë. Bile me pensionimin e vozitësve apo ikin e tyre jashtë shtetit, është shumë vështirë që ato të zëvendësohen me shoferë të tjerë me përvojë.

Nga Asociacioni i shoqatave të punëdhënësve të kompanive që kryejnë transport "Makam-Trans", thonë se ikja pas një vendi pune të paguar më shumë jashtë shtetit, por edhe pakujdesia e institucioneve relevante që të krijojnë kuadër të vozitës profesionistë e që do të aftësohet në bankat shkollore për këtë profil që kërkohet në tregun e punës, kanë shkaktuar edhe mungesën e vozitësve të kamionëve në shtet.

"Shoferët nga Maqedonia ikin në Gjermani dhe shtetet e tjera perëndimore të joshur nga kushtet më të mira të punës dhe pagesës më të madhe, si dhe për shkak të faktit se u hap mundësia që në mënyrë legale të punojnë dhe jetojnë në këto shtete. Gjithashtu, edhe në nivel të Evropës mungojnë shoferë profesionistë të kamionëve, bile llogaritet se deri në vitin 2020 në tërë Bashkimin Evropian do të mungojnë 1 milion vozitës profesionist të kamionëve për shkak të vajtjes në pension të një pjese të

madhe të vozitësve në shtetet perëndimore", thotë Biljana Muratovska nga Shoqata e transportit "Makam-Trans".

Sipas saj, problem i mungesës së vozitësve profesionist të veturave të rënda, e ka burimin tek mos-përgatitja me kohë e kuadrove të tilla që kërkohen në tregun e punës.

"Mungesa e vozitësve profesionist të kamionëve vjen nga mos-shkollimi i tyre që nga shkolla e mesme për të këtë drejtim, ose mungesa e shkollimit të profileve të tyre që nga bankat e shkollës mesme, për shkak se jo të gjithë gjysmë-maturantët kanë mundësi të vijojnë shkollimin e lartë. Ne tani kërkojmë, që edhe në mënyrë institucionale të aftësohen vozitës në aspektin profesional duke ju ofruar edhe mbështetje financiare, sidomos për nxënësit nga viset rurale që janë edhe rajone më të varfra, që të mundet nesër pas përfundimit të shkollës mesme, që të dalin nga shkollimi i mesëm profesional edhe kuadro që menjëherë mund të punësohen duke zgjidhur edhe ekzistencën e tyre jetësore" shton më tej Muratovska.

Nga ana tjetër, analizat e ndryshme tregojnë se krahas Evropës, edhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës ju mungojnë afër 50 mijë vozitës të kamionëve.

Sipas gazetës "Uashington Post", rreth 51.000 shoferë janë të nevojshëm për të plotësuar kërkesën e paraqitur nga kompani të tilla si Amazon dhe Walmart që po dërgojnë më shumë mallra në të gjithë vendin, tregojnë analizat e Shoqatave Amerikane të Kamionëve. Mungesa e vozitësve po krijon edhe vonesat të dërgesave si dhe rritje të kostos, për mallrat që i blejnë amerikanët. Shoqata e kamionëve parashikon se ka ekzistojnë gjasa të mëdha që kjo gjendje të përqeshohet në vitet e ardhshme.

Bile mjaft kompani transportuese janë aq të dëshpëruara për situatën me vozitësit, sa që ofrojnë edhe bonuse të nënshkri-



BILJANA MURATOVSKA

Shoferët nga Maqedonia ikin në Gjermani dhe shtetet e tjera perëndimore të joshur nga kushtet më të mira të punës dhe pagesës më të madhe si dhe për shkak të faktit se u hap mundësia që në mënyrë legale të punojnë dhe jetojnë në këto shtete. Gjithashtu, edhe në nivel të Evropës mungojnë shoferë profesionistë të kamionëve, bile llogaritet se deri në vitin 2020 në tërë Bashkimin Evropian do të mungojnë 1 milion vozitës profesionist të kamionëve për shkak të vajtjes në pension të një pjese të madhe të vozitësve në shtetet perëndimore.

mit të kontratës si dhe paguajnë rritje të pagës.

Shoferët e kamionëve që kanë kryer këtë aktivitet prej katër muaj deri në 40 vjet, thonë se jeta e vështirë ku shumica prej tyre rrallë shohin familjen si dhe mungesa e respektit nga shoferët e automjeteve, policia apo kompanitë e mëdha të shitjes me shumicë largojnë të interesuarit të merren me këtë profesion. Shoferët shprehen për gazetën se një pjesë e tyre fitojnë 100 mijë dollarë, ndërsa shumica e tyre kanë paga vjetore më të vogla se 50 mijë dollarë. Nga ana tjetër, statistikat zyrtare thonë se paga mesatare në këtë veprimtari ekonomike është 42 mijë dollarë në vit. Pavarësisht vështirësive dhe ngarkesës së madhe në punë, një pjesë e madhe e vozitësve thonë se do ta rekomandonin punën e vozitësve për miqtë dhe familjen, sepse, sipas tyre kjo është paraja më e lehtë që mund të merrni pa diplomë kolegj.

EDHE VOZITËSIT E AUTOBUSËVE URBAN IKIN

Dhjetë vozitës të autobusëve kanë ikur nga Ndërmarrja Publike e Transportit në Shkup në Maltë të joshur nga paga më e madhe, ndërsa edhe dhjetëra të tjerë pritet të largohen nga Shkupi për të vozitur autobusët në shtetin ishull të Maltës. Nga ky shtet kërkohen përvojë trevjeçare, ndërsa ofrojnë pagë prej 1600 euro.

Derisa maturantët ishin në fazën e përcaktimit të lëndëve për provimet e maturës shtetërore, shumë universitete filluan organizimin e kurseve për mësimin e lëndëve të caktuara. Në disa fakultete të UKM-së paguhet regjistrimi në këto kurse, ndërsa UNT këtë vit i organizoi falas kurset e matematikës dhe biologjisë

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 3 qershor - Të sigurosh studentë në kohën kur tregu i institucioneve të arsimit të lartë është tej mase i liberalizuar, nuk është aspak e vështirë. Për më tepër, në raste të caktuara, universiteteve u duhet të bëjnë deri edhe punën e shkollave të mesme, pra të angazhohen dhe të gjejnë mënyrat si të rrisin nivelin e dijeve të nxënësve që ata i llogarisin si studentë potencial. Kjo përpjekje në disa universitete ka rezultuar me organizimin e kurseve për mësimin e lëndëve të veçanta sikurse janë ato të shkencave matematike-natyrore dhe varësisht institucioneve, kurset mund të jenë me pagesë apo falas.

Qendra për mësimin e gjuhëve të huaja në kryeqytet, prej vitesh ka zgjeruar paletën e aktiviteteve të veta duke e plotësuar ofertën me kurse nga informatika, mate-

KURSE FALAS PËR PËRGATITJEN E MATURANTËVE

UNIVERSITETET BËJNË PUNËN E SHKOLLAVE TË MESME



matika, fizika, biologjia e kështu me radhë. Për këtë qëllim janë formuar dhe veprojnë edhe shumë qendra të ngjashme në Shkup dhe qytete të tjera. Fakultete të caktuara të Universitetit "Kirili dhe Metodi", organizojnë gjithashtu aktivitete për mësimin e lëndëve të ndryshme e që në fakt janë lloj kursesh që ata ofrojnë për studentët e tyre të ardhshëm. Kup-tohet që regjistrimi nëpër këto kurse ka një çmim të caktuar, ndërsa organizatorët shprehen relativisht

të kënaqur me numri e atyre që regjistrohen të ndjekin kurset e tyre.

Përveç këtyre formave institucione në Maqedoni nuk kanë dalë mode as sot e kësaj dite format e organizimit të kurseve në mënyrë individuale nga vetë profesorët e lëndëve, që me mjeshtëri i kanë emëruar si "mbajtja e orëve plotësuese". Mirëpo, konkurrenca e fortë ka sjellë edhe organizimin e kurseve pa pagesë për maturantët nga ana e institucione të caktuara. Kë-

shtu, kohë më parë, derisa maturantët ishin në fazën e përcaktimit të lëndëve për provimet e maturës shtetërore, Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup organizoi mbajtjen e kurseve falas për lëndët e matematika dhe biologjisë. UNT angazhuan të punojnë me maturantët e Shkupit profesorët të cilat ligjërojnë në këto lëndë, ndërsa kurset u organizuan posaçërisht për këta dy lëndë me arsyetimin se "matematika dhe biologjia mbeten edhe më tej lëndë jo

shumë të lehta për nxënësit". Për këtë qëllim, sikurse shpjegojnë në organizimin e kurseve përgatitore për maturantët nga këto lëndë. UNT, plotësojnë më tej ato, ka vendosur në dispozicion profesorët përkatës dhe ambientet e universitetit për organizimin e kurseve të cilat ofrohen falas për të gjithë të interesuarit.

Universitetet, pa dyshim që mbeten të angazhuar në krijimin e kushteve lehtësuese dhe ndihmesës për mësimin e lëndëve, ku ata akne interes të regjistrojnë studentë të ardhshëm. Në rastin konkret meqë UNT është e fokusuar të programe studimore të shkencë teknike dhe sociale është në interesin eter që nga gjenerata e sivjetme e maturantëve të ketë sa më shumë kandidatë të cilët për provime të maturës shtetërore do të zgjedhin matematikën si lëndë të dytë dhe biologjinë, fizikën, apo socio-logjinë si lëndë të treta.

Përcaktimi sa më i madh i maturantëve për këta lëndë dhe kup-tohet vlerësimi me nota sa më të larta në provimet përkatëse shton gjasat për studentë sa më cilësor. Në këtë mënyrë ritën edhe pritjet për cilësinë e kuadrove të tyre, në përfundim të studimeve. Në fund të fundit cilësia e studimeve është në varësi të drejtpërdrejtë me cilësinë e shkollimit të mesëm, pasi edhe universitete do të nxjerrin produktet e tyre sipas elementëve hyrëse. Në këtë logjikë është mbështetur edhe angazhimi i universiteteve për organizimin e kurseve për mësimin e lëndëve të caktuara, qofshin aton falas apo me pagesë e që me logjikën e ekonomisë përkethehet si investim në llogari të vetvetes.

ASGJË KONKRETE NGA RIVITALIZIMI I QENDRËS TREGTARE NË TETOVË

Dikur Qendër tregtare, sot çerdhe e narkomanëve

Sot, kjo qendër punon me kapacitet të përgjysmuar, pasi pjesa dërmuese e lokaleve në katin e dytë janë mbyllur, kurse aty këtu gjen ndonjë lokal të hapur në katin e parë. Shkëlqimin e humbi për shkak të problemeve të shumta, sidomos pas rrahjeve dhe zënkave të përditshme. Madje, nuk kanë munguar as çerdhet e narkomanëve, e cila ndikoi që shumë lokale të mbyllen dhe të largohen njerëzit

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 3 qershor - Qendra e regtaretare në Tetovë vazhdon të jetë e lënë në mëshirën e kohës. Kati i parë dhe i dytë pothuajse janë shumë pak funksional, ndërsa vetëm kati përdhes është më i frekuentuar dhe më i rregulluar. Kjo qendër tregtare e ndërtuar në vitin 1995 në fillim shkëlqente, pasi pjesa dërmuese e lokaleve ishin të hapura dhe punonin, kurse frekuentimi i qytetarëve ishte më i madh. "Atëherë kishte më shumë lëvizje, më shumë punë, më shumë para kishin njerëzit, por me pas - me vite u zbeh kjo qendër", thotë një ish pronar në këtë qendër. Por me kalimin e kohës,

kjo qendër humbi shkëlqimin për shkak të problemeve të shumta, sidomos pas rrahjeve dhe zënkave. Madje, nuk kanë munguar as çerdhet e narkomanëve, e cila ndikoi që shumë lokale të mbyllen dhe të largohen njerëzit. Sot, kjo qendër punon me kapacitet të përgjysmuar, pasi pjesa dërmuese e lokaleve në katin e dytë janë mbyllur, kurse aty këtu gjen ndonjë lokal të hapur në katin e parë. "Në kohën kur filloi me punë kjo qendër, kishte lëvizje, kishte njerëz, punon të gjithë, por duke kaluar koha, problemet dhe kriza ekonomike e kanë bërë të veten. Tash shumë lokale janë shitur, janë mbyllur dhe nuk ka perspektivë. Disa herë e kam dhënë me qira

dhe nuk e ka mbajtur askush, sepse nuk ka punë", thotë pronari i një kafeterie në katin e parë. Mosisinteresimi për këtë qendër e ka bërë të veten, e njëjta ka probleme me kanalizimin atmosferik dhe me izolimin. Kështu si edhe viteve të kaluara, edhe këtë vit kur ka të reshura - grumbullohet uji, kurse kanalizimi jofunksional bën që uji të depërton edhe në lokale për shkak të mos izolimit të mirë. Kohë më parë, Këshilli për mirëmbajtjen e Qendrës së regtaretare, përmes një apeli drejtuar pronarëve të tjerë të lokaleve që nuk janë aktiv ose që i kanë të mbyllura, ka kërkuar nga ata të paraqiten në Qendrën tregtare që edhe ata të japin kontributin e tyre, sepse sh-



presohet se së shpejti - do të krijohen kushtet për funksionim e të gjitha lokaleve në këtë qendër tregtare. Ky Këshill disa herë ka tentuar të bëjë funksionalizimin dhe rregullimin e Qendrës, duke angazhuar pastrues dhe rregullim të ndriçimit, megjithatë jo çdoherë ka hasur në mirëkuptim, pasi një pjesë e pronarëve të lokaleve kanë humbur interesimin dhe i kanë lënë nën mëshirë lokalet me dyer dhe dritare dhe thyera. Momenta-

lisht, në këtë Qendër janë të hapura gjithsej afër 170 lokale, që paraqet një fuqi të madhe tregtare në dobi të biznesit tetovar. Në këtë Qendër, në katin e parë dhe të dytë më shumë janë funksional zyrat për kontabilitet, gjeodezi dhe kadastra. Zakonisht gjatë verës ka gjallërim, por jo në masën e dikurshme, sepse tashmë në katin përdhes kanë mbetur pjesa më e madhe e artarive, të cilët akoma vazhdojnë të kenë punë.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të Punësuarve në Sektorin Publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrimit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejtshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPLLJE PUBLIKE NUMËR – 69/2018

për punësimin e 5 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Drejtorinë e Mbrojtjes dhe të Shpëtimit “për vendet e punës në vijim:

1. UPR 0101B02000 Udhëheqës i Sektorit për çështje financiare 1 realizues(ë)
- Kushtet e përgjithshme:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
 - Të jetë i moshës madhore,
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
 - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Kushtet e posaçme:**
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat ekonomike
 - më së paku 5 (pesë) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 2 (dy) vjet udhëheqës në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 8 (tetë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 3 (tre) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat
- Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
 - mësim dhe zhvillim
 - komunikim
 - arrihte të rezultateve
 - punë me të tjerë/punë ekipore
 - ndërgjegjësimit strategjik
 - orientim kah palët/palët e interesuara
 - udhëheqje; dhe
 - menaxhim financiar
- Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
 - certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
 - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- Orari i punës :**
- Ditët e punës e hënë - e premte
 - Orët javore të punës 40
 - Orari ditor i punës 08:30 - 16:30
 - Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30
- Rroga neto: 35.872,00 denarë
- VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.
2. UPR0101B04000 Udhëheqës i njësies për informatikë dhe teknologji, Sektori për pajisje dhe mirëmbajtje materialo - teknike 1 realizues(ë)
- Kushtet e përgjithshme:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
 - Të jetë i moshës madhore,
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
 - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Kushtet e posaçme:**
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, teknika kompjuterike dhe informatikë, informatikë ose inxhinieri e telekomunikacionit
 - më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat
- Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
 - mësim dhe zhvillim
 - komunikim
 - arrihte të rezultateve
 - punë me të tjerë/punë ekipore
 - ndërgjegjësimit strategjik
 - orientim kah palët/palët e interesuara
 - udhëheqje; dhe
 - menaxhim financiar
- Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
 - certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
 - njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- Orari i punës :**
- Ditët e punës e hënë - e premte
 - Orët javore të punës 40
 - Orari ditor i punës 08:30 - 16:30
 - Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30
- Rroga neto: 28.303,00 denarë
- VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.
3. UPR 0101B04000 Udhëheqës i njësies për koordinimin e buxhetit, Sektori për çështje financiare 1 realizues(ë)
- Kushtet e përgjithshme:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
 - Të jetë i moshës madhore,
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
 - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Kushtet e posaçme:**
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat ekonomike
 - më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat
- Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
 - mësim dhe zhvillim
 - komunikim
 - arrihte të rezultateve
 - punë me të tjerë/punë ekipore
 - ndërgjegjësimit strategjik
 - orientim kah palët/palët e interesuara
 - udhëheqje; dhe
 - menaxhim financiar
- Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
 - certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
 - njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- Orari i punës :**
- Ditët e punës e hënë - e premte
 - Orët javore të punës 40
 - Orari ditor i punës 08:30 - 16:30
 - Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30
- Rroga neto: 28.303,00 denarë
- VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.
4. UPR 0101B04000 Udhëheqës i njësies për punë juridike, Sektori për punë të përbashkëta 1 realizues(ë)
- Kushtet e përgjithshme:**
- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
 - Të jetë i moshës madhore,
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
 - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
- Kushtet e posaçme:**
- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat juridike
 - më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat
- Kompetencat e përgjithshme:**
- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
 - mësim dhe zhvillim
 - komunikim
 - arrihte të rezultateve
 - punë me të tjerë/punë ekipore
 - ndërgjegjësimit strategjik
 - orientim kah palët/palët e interesuara
 - udhëheqje; dhe
 - menaxhim financiar
- Kompetenca të posaçme:**
- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
 - certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
 - njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
- Orari i punës :**
- Ditët e punës e hënë - e premte
 - Orët javore të punës 40
 - Orari ditor i punës 08:30 - 16:30
 - Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30
- Rroga neto: 28.303,00 denarë
- VËREJTJE:** Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.
- Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.
- Afati i aplikimit zgjatë 20 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.
- Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.
- Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.
- Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.
- Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai inicohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.
- Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

Dermatologu Agron Starova thotë se fillet e kësaj sëmundje vijnë nga djegia e diellit dhe është një ndër shkaktarët kryesorë të melanomës, por nuk përjashton faktin se ajo mund të jetë edhe trashëguese

Koha Delvina KËRLUKU

Shkup, 3 qershor - Në Maqedoni vazhdon të rritet numri i pacientëve me kancer të lëkurës. Vetëm këtë vit raportohen 480 pacientë të diagnostifikuar me "melanoma malinje", ndërkohë që pacienti më i ri që vitin e kaluar ndërroi jetë pikërisht nga ky lloj i kancerit ishte 23 vjeç. Specialistët alarmojnë se rastet e personave të prekur nga kjo sëmundje po vijnë gjithnjë e më rritje. Ata thonë se kanceri i lëkurës po prek edhe të rinjtë. Edhe pse askush nuk është i mbrojtur nga melanoma, mjekët thonë se ajo mund të parandalohet duke filluar me një vetëkontroll. Dermatologu Agron Starova thotë se fillet e kësaj sëmundje vijnë nga djegia e diellit dhe është një ndër shkaktarët kryesorë të melanomës, por nuk përjashton faktin se ajo mund të jetë edhe trashëguese.

Por nëse diagnostikohet me kohë, shanset e shërimit janë të suksesshme. Kjo është arsyeja pse mjekët bëjnë thirrje për vizitë mjekësore nëse pacientët shohin edhe ndryshimin më të vogël në lëkurë, apo edhe paraqitjen e gungave. "Shkaqet janë në një bazë gjenetike, dhe e dyta - vjen si rezultat i rrezeve të diellit, shkak ky që është edhe arsyeja kryesore për para-

RRITJE ALARMANTE E NUMRIT TË PACIENTËVE ME PROBLEME NË LËKURË

KANCERI I LËKURËS I PRANISHËM EDHE TEK TË RINJTË



qitjen e karcinomit të lëkurës", thotë për gazetën KOHA, doktor Starova. Nga djegia e diellit ka pësuar edhe Atdheu, 48-vjeçar, i cili sot bën shumë kujdes për trupin e tij. "Kam probleme me lëkurën, sa dal në diell, kam reaksione. Vitet e para të adoleshencës nuk jam kujdesur nga rrezet e diellit. Një herë jam djegur gjatë rrezitjes në plazh aq shumë dhe mu bë trupi me puçrra. Jam vizituar te mjeku dhe tashmë bëj kujdes të vazhdueshëm. Kur dal të në pazar, vë kapele, syze dhe nga brezi e lart vishem me këmbë me mëngë të gjata. Ndërsa kur shkoj në det, tërë kohën rri nën çadër. Përdor vitamina dhe kremin mbrojtës", thotë Atdheu. Dr. Starova thotë se

diagnoza identifikohet në pasqyrën klinike edhe me metodat si demoskopio, me të cilën me shumë siguri mund ta vërtetojmë është apo jo karcinom. "Nëse është karcinom, mjekimi është në bazë kirurgjike vetëm me operacion. Por ne duhet ta konstatojmë sa më herët se është karcinom, që rezultatet nga mjekimi të jenë më efikase, atëherë kur karcinomi ka madhësi më të vogël. Ne kemi rastin e melanomit që është një prej karcinomeve, dhe mjekimi është qind për qind i suksesshëm nëse është me madhësi deri në 6 milimetra. Edhe kur e kemi këtë madhësi dhe e bëjmë operacion, rezultatet dhe prognoza janë shumë më të mira. Nëse karcinomi

është më i madh, shanset janë që të përhapet edhe në organet e tjera, posaçërisht në tru, në mushkëri dhe në mëlçi, Këto janë pjesë që përthithin më shumë metastaza", sqaron doktor Starova.

Por, ai shton se personat duhet të jenë të kujdesshëm në rast se paraqitet ndonjë shqetësim në lëkurë dhe duhet të paraqitet te mjeku. "Mentaliteti i shoqërisë tonë është i vakët për t'u vizituar te mjeku. Kur të paraqitet një shenjë në trup që gjatë kohë nuk shërohet, në vendet ku ekspozohet si në fytyrë, dorë, këmbë, te femrat posaçërisht te këmbët dhe nuk është e qartë se çfarë është, patjetër që duhet vizitë te mjeku dhe nuk duhet të humbim kohë. Se-

pse, nëse vizitohemi më shpejtë - shanset janë që të konstatojmë se çfarë është dhe mundësitë për mjekim janë më të mëdha. Duhet kontroll që të dihet çfarë ka pacienti dhe në bazë të diagnozave që i kemi, të jepet terapia. Nëse nuk zhduket vetvetiu shenja për shtatë ditë, katërbëdhjetë ditë ose për tre javë, patjetër vizitë te mjeku", tha Starova. Edhe për kirurgen Sofija Pejnova, personat me shqetësim në lëkurë kanë përherë kohë të shërohen nëse vizitohen në mjek apo spital. "Shumë shpesh te pacientët ka një mendim se nëse ka një ndryshim në lëkurë, ka kohë. Por është një humbje kohe vetëm të mendosh. Çdo ditë e humbur merr kohën për trajtim. Për çdo ndryshim duhet të bëjmë një konsultim me një ekspert", thotë Sofija Sofija Pejnova.

Dr. Starova sugjeron që pacientët me lëkurë të ndjeshme t'i shmangen diellit nga ora 11 deri në ora 16, sidomos ata që shkojnë në plazhe, të shmangin të njëjtat në këtë orë kur rrezet e diellit janë shumë të rrezikshme.

Sipas të dhënave të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, çdo vit zbulohen rreth 232.000 raste të reja të kancerit të lëkurës, ndërsa 55.000 njerëz vdesin çdo vit nga sëmundja e lëkurës.

KËRKOHET ME NGULM SHPALLJA E MALIT SHARR PARK KOMBËTAR

Edhe një dokument për mbrojtjen e Malit Sharr

Dokumenti do tu dorëzohet të gjithëve institucioneve përgjegjëse, ndërsa i njëjti pritët të merret parasysh edhe gjatë procesit të shpalljes së Malit Sharr si park kombëtar

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 3 qershor - Një dokument i përbashkët i quajtur "Vizioni për Malin Sharr 2038" është nënshkruar në Kodrën e Diellit. Dokumenti është përpunuar nga më shumë shoqata joqeveritare, shoqata malore dhe banorë të këtyre zonave, ndërsa ka për qëllim që sa më shpejt këtë zonë të shpallë të mbrojtur. Sipas këtij dokumenti, parashihet se që të ndalohet ndërtimi i hidrorcentraleve, të hapen

shtizë dhe jo udhë, të kthehen të gjithë ata kafshë të egra që janë zhdukur ose janë në zhdukje e sipër. Dokumenti do tu dorëzohet të gjithëve institucioneve përgjegjëse, ndërsa i njëjti pritët të merret parasysh edhe gjatë procesit të shpalljes së Malit Sharr si park kombëtar. Sipas këtij dokumenti, mbrojtja e Malit Sharr, për të cilin pritët me dekada të ndodhë, do të sjellë zhvillimin e turizmit, degë kjo e pazhvilluar në këto hapësira ndërsa do të jetë edhe burim ekzistence për këta banorë dhe më gjerë.

Brenda një periudhe prej tre muajve, në gjashtë komunat e rajonit të Pollogut që gravitojnë në Malin Sharr, u mbajtën diskutime me popullatën lokale, në të cilën ata theksuan problemet, si dhe mënyrat e zgjidhjes për të mbrojtur Malin Sharr.

"Ne do t'ua dërgojmë rekomandimet institucioneve shtetërore që duhet të përfundojnë procesin e shpalljes së Parkut

Kombëtar Mali Sharr. Ne kërkojmë që sa më shpejt të jetë e mundur të mbrohet Mali Sharr dhe ne shpresojmë se kjo do të jetë në vitet e ardhshme", tha Frosina Pandurska nga Shoqata Ekologjike Maqedonase. Për Meti Muaremin nga Qendra për Edukim dhe Zhvillim - CED, pikërisht mungesa e përfaqësuesve të institucioneve në këtë ngjarje konfirmon vetëm skepticizmin e tyre ndaj këtij procesi që ka filluar 20 vite më parë.

"Pas të gjitha takimeve dhe bisedave me vendasit nga rajoni i Pollogut ne kemi kuptuar dhe identifikuar problemet e tyre ekzistuese, por edhe nevojat e tyre për ruajtjen e natyrës, prandaj urgjentisht kërkojmë mbrojtje të këtij rajoni. Ky proces nuk duhet të jetë vetëm formal, por plotësisht të zbatohet në terren, në bashkëpunim me popullatën lokale në mënyrë që ky masiv malor të jetë potencial turistik për popullatën e rajonit, por edhe për të huajt. Andaj, përmes dokumentit të përga-



titur në kuadër të projektit, do të punojmë në sensibilizimin e popullatës, institucioneve lokale dhe atyre qendrore që të merren masa të shpejta në drejtim të mbrojtjes së rajonit, ndryshe në ardhmëri të ballafaqohen edhe me fenomene të tilla si në vitin 2015, vërshime të ndryshme", theksoi Muaremi. Dokumenti "Vizioni për Malin Sharr 2038" është nënshkruar nga shumë shoqata që merren me ekologji dhe shoqata malore, ndërsa aktiviteti solemn u mbajt në Ko-

drën e Diellit. Organizatat joqeveritare që marrin pjesë në Platformën "Miqte e Sharrit" do të shkëmbejnë eksperiencën të tilla me kolegët e tyre nga Kosova dhe Shqipëria. Për këtë qëllim u krijua një organ këshilldhënës ndërkufitar Shara-Korab-Koritnik. "Vizioni për Malin Sharr" është një studim i bazuar në idetë dhe rekomandimet e fermerëve, gjuetarëve, alpinistëve, mbledhësve të frutave dhe njerëzve të tjerë të cilët kujdesen për Malin Sharr.

Kur i "rrjepti dhe i shqepti" hiqen për "vatanli!"



Nga
Fadil LUSHI

Kryetitulli i këtij artikulli gjithësesi që del nga thesari i së folmes sonë krahinore. Që ky shkrim, të mos dalë si "lesh arapi" a edhe të mos marrë bojë "jeshile", fillimisht do të bëjmë përpjekje që t'i "çajmë drutë tona e mandej t'i qajmë hallet e të tjerëve". Detyrimisht do t'i shmangemi ngatërrimit të kompetencave si dhe pështjellimit të mendimeve, që kështu të mos krijojmë huti të lexuesi. Është paksa e vështirë ta zbrërthesh kuptimin e këtyre dy fjalëve emërtuese që ndërtojnë këtë shprehje dialektore, megjithatë përbërësit e saj shënojnë dy nofka tallëse që i hasim në komunikimin tonë të përditshëm. "Të rrjeptit dhe të shqepetit", përkundërt mangësive të njohurive të plota dhe të përpikta për problemet e caktuara që dalin në lëmenj të ndryshëm, bëjnë "hyxhym" për të futur hundët aty ku nuk e kanë vendin, me qëllim që të duken të dijshtëm. Sipas nofkave që mbajnë, ata të krijojnë përshtypjen se janë të "këndshëm" dhe herë-herë të ngjallin dhe "ndjenjën e simpatisë", thjeshtë sikur të "bëjnë për vete!".

Sot është bërë praktikë që në përditshmërinë tonë, "i rrjepti dhe i shqepti" bëjnë politikanin, bëjnë bilancin e ekonomisë popullore, bëjnë kryeopozitarin e shqetësuar, bëjnë spekulatorin, ata madje "bëjnë vampirin e natës dhe engjëllorin e mirësisë", bëjnë akademikun duke përjashtuar atë të mirëfilltin, bëjnë "hajmalinë e Burdushit" dhe mandej ta varin në qafë me qëllim që të mos biesh mësysh, bëjnë mantelin e bardhë të mjekut, sikur po bëjnë mjekrën e qoses, ndonëse e dinë fare mirë se ajo mjekër asnjëherë nuk rregullohet, sikur për "hatër të aga babës" bëjnë pazarin politik, një pazar që na e solli shpirtin në majë të hundës, bëjnë punën e tyxharit i cili mallin e vatanit ia jep armikut veresie, bëjnë pabesinë sikur bëjnë regjisorin e estradës, operës si dhe aktorin e teatrit veror, ndonëse nuk dinë se ç'është opera, teatri a aktori, bëjnë bedelin, bëjnë "asqerin" e..., bëjnë ligjin, bëjnë punën e sekserit, bëjnë daulltarin e muajit të ramazanit, ndonëse nuk kanë hiç haber nga agjërimi. Këta "të rrjeptit dhe të shqepetit" bëjnë këpucëtarin dhe marangozin, zhgënjehen nga autori i editorialit të gazetës pse nuk ka shkruar për këngën tal-

lava të nipit të tyre, sikur imitojnë ministrin që nuk ta kthen "selamin", sikur bëjnë bojaxhiun pavarësisht se vuajnë nga daltonizmi, duan të bëjnë ciceronin e muzeut, ndonëse një të tillë asnjëherë nuk e kanë frekuentuar, duan të bëjnë kryeparin e partisë politike, të bëjnë qeveritarin si dhe zëdhënësin e tij, sikur bëjnë shefin e protokollit të organizatës-bazë të partisë politike, sikur bëjnë deputetin e Kuvendit Popullor, duan të bëjnë filozofin, ndonëse në jetën e tyre asnjëherë nuk kanë dëgjuar për urtësinë antike, shtiren sikur bëjnë lëmoshëtarin e Stambollit-vidh këtej e jep andej, duan të bëjnë gojëtarin, të bëjnë Shqipërinë natyrale (Ehe, ti vëllaçko! Sa e madhe më duket kjo Shqipëri londineze!).

"I rrjepti dhe i shqepti" bëjnë çorape prej pambuku..., bëjnë protesta në "Çadrën e lirisë" për të kërkuar demokracinë e athinasve të moçëm, bëjnë pordhën në mexhlinin e burrave mendjendritur a mendjefemër, bëjnë "gjimnastikën e mëngjesit të diktatorit", ndonëse gjumin e "prishin" pasdreke, bëjnë dajrexhiun, po njëkohësisht bëjnë edhe kritikën letrare, pavarësisht se nuk dinë se ç'është proza, poezia, romani a

edhe eseja. Sipas qejfit të tyre, kur t'u teket dhe si t'u teket ata bëjnë mësuesin e historisë kombëtare, shtiren sikur bëjnë klerin e lartë mysliman, bektashian, katolik e ortodoks, ani se nuk kanë haber se ç'është religjioni, ç'është xhamia, teqeja, katedralja dhe kisha, ata mëtojnë të bëjnë pashain, pavarësisht se asnjëherë nuk e kanë pasur "gradën e nizamit", të bëjnë lajmdhënësin e rremë, të bëjnë guvernatorin, të bëjnë këshilltarin ushtarak, ani se asnjëherë nuk kanë qenë tatar, të bëjnë qesëndisjen me të gjithë fukarenjtë, të bëjnë intelektualin pavarësisht se nuk e kanë as të mesmen, të bëjnë komplete dhe manovra me fisheskjarrë shumëgjyresh, të bëjnë hafijen e pushtuesit. Do të mbjellin arat e fqinjëve me manaferra, sa herë që t'u teket dhe si t'u teket, do të nxjerrin avaze të vjetra dhe ca doke të mërziqshme dhe të padëshirueshme. Miku im i nderuar! Nëse nuk të "bezdisa", pa më thuaj, këta të "rrjeptit dhe të shqepetit" çka nuk bënë dhe a thua çka tjetër nuk do të bëjnë. Ç'është e vërteta, kur këtyre të "rrjeptëve dhe të shqeptëve" do t'u shteren qejfet dhe kërkesat për t'u bërë diçka, do të këmbëngulin të bëhen "atdhetarë a vatanli" njësoj si miku



Njerëzit me moshë të shkuar nuk e kanë kollaj kur takohen me shokët e burgut... dhe sa herë që shihen, ata vihen në siklet. Ndaj një nga këta në vend të përshëndetjes, më tha: "Eh, miku! Ç'më ka marrë malli për një lot foshnje prej gjiri, për një lot nëne dhe për një lot prej vatani..., ç'taksirat kam unë?! Ç'kam bërë unë, ç'faj kam unë!" Më la gojëmbullur dhe iku toptan me plagët e shpirtit të tij.

im me taban kombëtar, i cili disa ditë më parë u duk këtejpari në mëhallën time.

Njerëzit me moshë të shkuar nuk e kanë kollaj kur takohen me shokët e burgut... dhe sa herë që shihen, ata vihen në siklet. Ndaj një nga këta në vend të përshëndetjes, më tha: "Eh, miku! Ç'më ka marrë malli për një lot foshnje prej gjiri, për një lot nëne dhe për një

lot prej vatani..., ç'taksirat kam unë?! Ç'kam bërë unë, ç'faj kam unë!" Më la gojëmbullur dhe iku toptan me plagët e shpirtit të tij. Kjo thënie e tij seç ishte një mlllef i akumuluar, seç ishte një dashuri e munguar ndaj vatanit, ndaj foshnjës a ndaj nënës, seç ishte një ndjenjë e hidhërimit, unë me taktin e mendjes sime nuk e "kapa"... një gjë më mbeti peng..., mos vallë këtë thënie të tij ma "faturoi" mua dhe ca të tjerëve të tillë si ai. Ky miku im, nuk të lejon ti thuash 'i dashur', sepse ky nocion human, i ngrohtë, emancipues dhe po aq paqësor, për të është i panjohur. Ky miku ynë, ka një të kaluar sa të lavdëruar, po aq edhe të ngatëruar..., ka kohë që të "rrjeptve dhe të shqeptve" dhe disa bashkëqytetarëve të tjerë nuk u ha palla hiç as për vatan e as për din e iman..., sepse lavdin dhe të shkuarën e mikut tonë, ashtu padrejtësisht e kanë vënë në grykë të harresës së tyre kolektive!

Këta të "rrjeptit dhe të shqepetit" që hiqen për "zurnaxhinj, sehixhinj, sherxhinj dhe lodraxhinj" nuk mund t'i bësh me faj, sepse në vaktin e mikut tonë fisnik ata ndodheshin në koqet e prindërve të tyre dhe, rrjedhimisht, nuk mund të dukeshin këtejpari.

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel 3 qershor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

D o të ishte çudi po të mos rezultojë kryeministri i ri një marionetë në duart e dy kryetarëve të partive Lega dhe Lëvizjes Pesë-Yjet. Sepse profesori i panjohur i lëndëve juridike nuk ka rrënjë as te Lega, as te Pesë-Yjet, pushtetin ai e ka vetëm të marrë hua. Giuseppe Conte është destinuar që të jetë një figurë e dobët - një kryeministër, të cilit i duhet të telefonojë më parë në dy qendra të partive, përpara se t'u premtojë gjë kolegëve Merkel dhe Macron. Kjo qeveri përbëhet nga fillestarë - me përjashtim të ministrit të ri të Jashtëm. Kjo i jep asaj në sytë e zgjedhësve edhe më shumë besueshmëri, sepse bën pjesë në standardet e populistëve, që të shajnë e mallkojnë të ashtuquajturat establishmente.

Programi i kësaj martese midis dy partive krejt të papajtueshme ideologjikisht me njëra-tjetrën, konsiston para së gjithash në dhurata të papagueshme për zgjedhësit. Dhe ata janë kaq të etur për ndryshime, për njerëz të rinj në politikë, sa kanë harruar se si bëhet llogari. Sepse taksa e shtë, me të cilën do t'i lumturojë mbështetësit e tij udhëheqësi i Lega-s Matteo Salvini do t'i kushtojë shtetit miliarda dhe do të sjellë fitime vetëm për të ardhura që

Avanti dilettanti!

prej 30.000 euro. Por njerëzit me të ardhura të pakta, ata të cilët votuan në radhë të parë për populistët, do të jenë në një pozitë më të keqe se më parë.

NJË ËNDËRR E KEQE PËR EVROPËN

Ndërsa e ardhura bazë, të cilën ia premtuar Lëvizja Pesë Yje jugut të varfër, në fakt zëvendëson sigurimin social, që mungon prej dekadash në Itali. Për fat të keq shteti për këtë nuk i ka aktualisht paratë dhe vrimat gjigande, të cilat do t'i japin në buxhet të dyja projektet, nuk mbushen duke marrë vetëm ca borxhe.

Në përgjithësi ideja bazë ekonomike e kësaj qeverie është shumë e diskutueshme: që Italia do të dalë nga borxhet, duke shpenzuar më shumë para. Janë një grusht ekspertësh që përfaqësojnë pikërisht këtë doktrinë. Por meqenëse Donald Trumpi po e çon aktualisht në humnerë koniunkturën

globale, nuk mund të parashikohet se si do t'i shpëtojë Italia kësaj vullbule thithëse negative. Në Bashkimin Evropian ende pa u kapërcyer mirë kriza e Greqisë, po afrohet kriza tjetër, më serioze për eurozonën. Ekonomikisht Italia është dhjetë herë më e madhe se fqinji i vogël në jug. Nëse Roma do të ecte drejt një falimentimi shtetëror, kolapsi në tregun financiar mund të merrte me vetë për poshtë të gjithë monedhën e përbashkët.

Ende nuk dihet se sa nga premtimet e pafinancueshme do të zbatohen të rinjtë në Itali. Por gjithsesi Brukseli ka para vetes kohë të paqeta, sepse qeveria Conte do të kërkojë leje për të hyrë në borxhe pa u shqetësuar. Por këtë leje BE nuk mund t'ia japë, përplasja është e programuar.

SI DUHET TË QËNDROJË NË KËMBË KY KOALICION?

Edhe përtej kësaj, nuk do të ketë gjë tjetër veçse grindjes me

Edhe një gjë: populistët në Romë u mbushin mendjen njerëzve se fajin për krizën e Italisë e ka Gjermania. Ky është një budallallëk dashakeq. Mesatarja statistikore e mirëqënies për frymë në Itali është më e lartë se në Gjermani. Por fqinjët kanë një problem të madh të shpërndarjes. Shikoni veten tuaj, të dashur italianë, dhe mos ua hidhni të tjerëve kaosin, korrupsionin, punët shkel e shko, zhvatjet dhe të tjerat që e paralizojnë këtë vend të bukur

këta italianë. Shprehjet e shefit të Legas, Salvini për ndarjen racore në tramvaje tregojnë mendësinë e tij ekstremiste të djathtë, raciste.

Nëse si ministër i Brendshëm ai do t'i çojë emigrantët në kamp, në Itali do të shpërthejë një luftë e ashpër për të drejtat e njeriut.

Edhe një gjë: populistët në Romë u mbushin mendjen njerëzve se fajin për krizën e Italisë e ka Gjermania. Ky është një budallallëk dashakeq. Mesatarja statistikore e mirëqënies për frymë në Itali është më e lartë se në Gjermani.

Por fqinjët kanë një problem të madh të shpërndarjes. Shikoni veten tuaj, të dashur italianë, dhe mos ua hidhni të tjerëve kaosin, korrupsionin, punët shkel e shko, zhvatjet dhe të tjerat që e paralizojnë këtë vend të bukur. Dhe parësisht nga kjo ajo që ka rëndësi: Avanti dilettanti!



Nga
Barbara WESEL

Viti 1968 dhe dështimi i një gjenerate në Jugosllavi

N doshta studentët në qershor 1968 në Beograd nuk e dinin aq mirë në fillim se çfarë dëshironin.

Por ata e dinin shumë mirë se kundër kujt ishin. Ata protestonin kundër rritjes së pabarazisë, kundër ndalimeve të shprehjes së mendimit dhe dhunës brutale të policisë. Në ditët e qershorit edhe kërkesat e tyre e qartësuan: Më shumë pjesëmarrje. Një shoqëri më të drejtë. Më shumë liri. Më shumë socializëm –por ndryshe.

Për ironi të fatit studentët arritën shumë pak për vete. Ata kërkuar ndër të tjera një pagë minimale për punëtorët. Shumica e punëtorisë nuk e kuptonte avantgardën studentore. Gjatë pushtimit shtatëditor të Universitetit në Beograd, firmat e mëdha rekrutuan mes punëtorëve trupa të gatshme për rrahje, nëse do të ishte e nevojshme. Nuk qe e nevojshme, sepse Tito e mori situatën në dorë, duke u dhënë studentëve pak a shumë të drejtë. Më e keqja, një larje llogarish me përgjakje u pengua. Protestuesit ndjeheshin të konfirmuar. Por ishte një fitore si e

Vështrim pas në histori: Lëvizja studentore jugosllave ka qenë ndoshta mundësia e vetme për një zhvillim paqësor në Jugosllavi. Por ajo dështoi në mënyrë katastrofike

Pirros. Nga këndvështrimi gati 25-vite pas luftërave të Jugosllavisë, kjo fitore rezultoi në një dështim katastrofik.

ALTERNATIVA E VDEKUR QË NË LINDJE

Pasi Tito, udhëheqësi legjendar partizan dhe president deri në fudn të jetës u brohorit nga studentët, protestat u zbehën. Hapi tjetër ishte prerja e filizave të paratë liberalizimit ekonomik. Në të njëjtën kohë partia e forcoi kontrollin ndaj skenës kulturore. Disa drejtues të studentëve, si Vladimir Mijanovic, i njohur si "Vlada" e paguan guximin e tyre me burg dhe

ekzil. Tetë profesorë të Fakultetit të Filozofisë në Beograd që u shpallën fajtorë si nxitës të protestave u larguan me dekret nga universiteti.

Megjithatë diçka u vu në lëvizje. Filmi i ri jugosllav, i përmbledhur nën nocionin "Vala e zezë", muzika e re rock, letërsia më e guximshme - të gjitha këto megjithë ndalimet nuk u penguan dot. Librat e shkrimtarëve të "Shkollës së Frankfurtit" u përkthyer, dhe vazhdoi edhe balafaqimi kritik me marksizmin dogmatik.

EPILOGU JUGOSLLAV NË VITET 80-TË

Tito ndërroi jetë në vitin 1980. Dhjetëvjeçari që pasoi ishte një përzierje e retorikës së konsumuar socialiste me nëntone nacionaliste gjithnjë e më në forcim, një përkeqësim i madh i gjendjes ekonomike dhe një lirie që nuk kishte ekzistuar më parë. Në librari dhe biblioteka gjeje të gjithë disidentët e Lindjes si edhe qëndrime kritike të perëndimit. Për të jetuar njerëzit kishin shumë pak. Por mund të

mendonin disi të lirë dhe të udhëtonin pa pengesa.

Në këtë vakuum u krijua shpresa e gabuar, se është i mundur demokratizimi pa dhunë i Jugosllavisë. Por komunistët jugosllavë e kishin goditur dhe marginalizuar alternativën shoqërore dhe politike të ngritur në vitin 1968.

Në fund u konfirmua diagnoza lakonike e disidentit të njohur jugosllav të epokës së Titos, Milovan Djilas: Rrugëdalja e vetme e komunizmit do të jetë nacionalizmi. Viti jugosllav 1968 dështoi në përpjekjen e tij për një socializëm demokratik.

MASHTRIM MAKIAVELIST

Në vitin 2018 këtij përcaktimi mund t'i shtosh edhe një dozë ironie: Mund të ndodhte më keq, si në Perëndim për shembull. Avantgarda e viteve 68 e mori pushtetin në vitet 90-të në Berlin, Bruksel, Uashington. Por çfarë ndodhi me idealet e tyre për "marshimin e gjatë përmes institucioneve?"

Javier Solana, një spanjoll i ri, kundërshtar i vendosur i diktaturës së Francos dhe socialist i bin-

dur, disa dekada më vonë si Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s dha urdhrin për bombardimin e Jugosllavisë. Joshka Fischer, një djalë kasapi dhe luftëtar në rrugë themeloi një parti pacifiste, të cilën përmes keqpërdorimit të fjalës Aushvitz e futi në kursin e luftës. Dhe Bill Clinton, një baptist amerikan, aktiv në lëvizjen për të drejtat e njeriut dhe kundër luftës në Vietnam, dha urdhrin për bombardime bashkë me ish-pacifistin gjerman dhe spanjoll.

Ndërsa Vlada, revolucionari në Beograd nuk do të marrë ndonjëherë ndonjë titull doktor nderi apo një honorar të majmë për një leksion mbi vitet 68. Fantazia e tij nuk synoi pushtetin, prandaj edhe nuk mund të dilte një ditë si mashtrim makiavelist.

(Dragoslav Dedović është poet, gazetar dhe përkthyes. Ai ka lindur në Serbi, është rritur në Bosnje-Hercegovinë. Vite me radhë ka drejtuar redaksinë serbe të Deutsche Welles.

Dragoslav Dedović përkthen poezi dhe shkruan tekste eseistike në gjuhën gjermane)



Nga
Dragoslav DEDOVIĆ

Përcaktohet afati i fundit i merkatos

Ndryshe nga vitet e tjera, kur merkatoja mbyllet më herët dhe më 31 gusht, këtë herë Serie A vjen me ndryshime. Qëllimi është që merkatoja të jetë e mbyllur para se të startojë kampionati, ndaj është vendosur data 17 gusht, si afati i fundit për të depozituar kontratat e blerjeve të reja. Gjithçka është bërë zyrtare nga Liga italiane e Futbollit, që njofton se do të pranojë depozitimet kontratash deri të premten e 17 gushtit, në orën 20:00, çka do të thotë se pas këtij orari, merkatoja është zyrtarisht e mbyllur. Kujtojmë që Serie A do të startojë më 18 gusht, ndërsa këtë herë skuadrat do të duhet të tregohen më të shpejta në merkato, për të kompletuar organikën para se të bjerë 'gongu' final.



HAXHI KRASNIQI SHPALLET KAMPION EVROPE

Haxhi Krasniqi zhvilloi një ndeshje mjaft të mirë dhe të kontrolluar, duke parë se kishte të bënte me një kundërshtar të vështirë. Në fund, Krasniqi arriti të fitonte takimin me pikë, pas vendimit të gjyqtarëve, duke u shpallur Kampion Evrope

E shtuna ishte vërtetë një ditë e shënuar për boksingun shqiptar. Pas Ferit Ketës i cili regjistroi një fitore të madhe, u rikthye në mënyrën më të mirë në ring edhe Gjetan Keta, i cili mposhti kolumbianin Caceres, me "knock-out" në raundin e 6-të. Megjithatë fitorja më e rëndësishme e ditës ishte ajo e Haxhi Krasniqit. Në "Wee Arena", Bad Tutz të Gjermanisë boksieri me origjinë shqiptare u ndesh me rusin Stanislav Kastanov me të cilin diskutoi titullin e kampionit për peshat super të mesme. Me kwtw fitore boksieri shqiptar është sh-

S'KAM KUFË, DUA TË BËHEM KAMPION BOTE



pallur kampion Evrope Krasniqi ndërsa ka dominuar pothuajse të 12 raundet, duke rrëmbyer kështu titullin kampioni në kategorinë super të mesme. Shqiptari nga Juniku pas këtij triumfi është një nga

pretendentët për tu shpallur edhe kampion bote në këtë kategori. "Shumë kanë menduar se lufta ime ka mbaruar", ka thënë Krasniqi pas ndeshjes në "Sky Sport News HD", transmeton gazeta

KOHA. "Nuk i njoh kufijtë e mi, jam i gatshëm të bëjë edhe shumëçka dhe dua të bëhem kampion bote", deklaroi Krasniqi. Edhe pse rusi u ringrit në raundin e shtatë dhe u përpoq që të gjunjëzonte Krasniqin, nuk arriti t'ia dal mbanë, pasi boksieri shqiptarë e kishte marrë epërsinë që në raundin e parë. Krasniqi tani ka 48 fitore nga 53 duela. Ai i shkaktoi Kashtanovit humbjen e tretë në karrierë, pasi deri para këtij dueli ai i kishte 36 fitore nga 38 sfida të zhvilluara. Për luftën për Kampion Bote, Krasniqi o të preferonte të ndeshesh në vendlindjen e tij, Prishtinë, para 30 mijë spektatorëve. Më 2015, ai humbi meçin për kampion bote kundër Jurgen Brahmerit.



Atalanta nuk do të mbajë Gjimshtin

Berat Gjimshti duhet të fillojë të mendojë për sistemimin e ri në Itali, në atë që do të jetë klubi i katërt në po aq vite në futbollin e këtij vendi. Mbrojtësi i përfaqësueses shqiptare ka edhe një vit të mbetur në kontratën e tij me klubin zikaltër, por atje duket se e nuk e llogaritin në sezonin e ri ndaj po mendojnë ta shesin për të përfituar diçka nga transferimi i tij para se të largohet me parametër zero. Sipas mediave italiane, ndonëse në klub vlerësojnë paraqitjen e Gjimshtit në këtë sezon që e mbylli te Benevento, klubi nuk është gati të rinovojë me të. Ndaj për ta mbajtur një vit në stol e më pas për ta humbur me parametër zero, nuk është një opsion që u pëlqen aq shumë drejtuesve të Atalantës. Si rrjedhojë, Gjimshti është lajmëruar që të fillojë kërkimin për një klub të ri, gjë që nuk do të jetë e vështirë për t'u siguruar nga mbrojtësi shqiptar, i cili ndiqet me interes nga disa skuadra pas paraqitjeve pozitive me fanellën e Beneventos në edicionin e fundit.

LENA LARGOHET NGA GJEOGJIA

Midis Superligës dhe FC Shkupi



Shkup, 3 qershor - Nijas Lena largohet nga skuadra gjeorgjiane, FC Telavi. Mesfushori 32-vjeçar ka përfunduar marrëveshjen me klubin e ligës së dytë në Gjeorgji dhe tashmë është një futbollist i lirë.

Lena u transferua pak muaj më parë te FC Telavi në Gjeorgji, për të mos qëndruar pa aktivitet, duke qenë se kishte përmbytur numrin e ekipeve në kampionatet e Evropës në Perëndim, që mund të luash brenda një sezoni (Kukësi, Teuta).

Ndaj, për Lenën ekzistonte mundësia që të luante në Lindje. Thuhet se për Lenën ka bërë ofertë zyrtare klubi i FC Shkupi, e cila këtë sezon do të luajë në garat e Liga Evropës. Por, në anën tjetër edhe Superliga mbetet opsion për mesfushorin i cili u shpall kampion një vit më parë me ekipin e Kukësit.

Pobeda mbetet në Ligën e Parë

Shkup, 3 qershor - Skuadra e Pobodës do të vazhdojë garat në Ligën e Parë Futbollistike të Maqedonisë, pasi në sfidën e balotazhit, mundi Borecin me rezultatin 2-1. Skuadra nga Prilepi hapi rezultatin në minutën e 8-të falë golit të realizuar nga Ivanoviç, para se Velkovski të dyfishojë epërsinë në minutën e 29-të. Në pjesën e

dytë skuadra e Borecit, kaloi në ofensivë të plotë dhe shpërblimi erdhi në minutën e 56-të, kur Kudijan shënoi gol për skuadrën nga Velesi. Në këtë mënyrë Pobeda i bashkohet anëtarëve të rinj nga Liga e Dytë, skuadrave të Makedonija Gjorçe Petrovit dhe Bellasicës, në garat elitare të futbollit vendor.



Keta mposht me nokaut teknik Kaseresin



Mbrëmja e së shtunës ka dhuruar emocion për dashamirësit e boksit pasi në Munih të Gjermanisë, Gjetan Keta është rikthyer në ring pas një pushimi të gjatë një vit e gjysmë. Përballë Gjetanit ishte Kolumbiani 27 vjeçar Devis Kaseres me 24 fitore nga të cilat 19 me nokaut.

Raundi parë ishte disi i qetë ku të dy studiuan strategjitë taktikat. Raundi i dytë shfaqet disi superioriteti Ketës por shohim kolumbianin teksa rivalizon. Raundi i tretë ishte i bukur, shumë taktik nga ana e kolumbianit

ndërkohë Keta provon të grushtojë më shumë. Gjetani kërkon një taktik "inside", ndërsa Kaseres "outside" e kjo e vështirëson më shumë këtë përballje. Fillimi i raundit të katërt vjen më i fuqishëm për shqiptarin, i cili fiton më shumë pikë me goditjet e tij. Ndërkohë, Kaseres shfaqet gjatë gjithë kohës më shumë taktik sesa përdorues i forcës. Në raundin e pestë ndeshja shkapet për pak pasi kundërshtari pëson një dëmtim në këmbë si pasojë e një rreshqitje. Gjetani tenton të afrohet vazhdimisht

drejt kundërshtarit kur e grushton por kolumbiani di të mbrohet mirë. Në fund të këtij raundi Keta u shfaq superior teksa e bombardoi kundërshtarin me goditje. Raundi i gjashtë mbyll këtë përballje me nokaut për Gjetan Ketën, një ndeshje e vështirë por që u dominua gjatë gjithë kohës nga boksieri shqiptar. Ndërkohë në këtë eveniment është ndeshur edhe ish kampioni i Gjermanisë Ferit Keta i cili fitoi me nokaut teknik në raund të 3, kujtojmë se boksieri ka 10 fitore ndër të cilat 7 me nokaut teknik.

HOZE MURINJO NUK NDALET

PAS FREDIT KËRKON EDHE VERATIN



Ka kohë që përflitet se Verratti do të largohet nga kampionët e Francës dhe me ardhjen e trajnerit të ri kjo mund të bëhet realitet, ndaj dhe Murinjo po kërkon një mesfushor fantazist për skuadrën e tij

Pasi ka siguruar mesfushorin e Shakhtar Donetsk për shumë e 52 milionë stërlinave, skuadra e Mançester Junajtedit po përgatitet për një tjetër blerje të madhe. Sipas të përditshmes britanike "The Sun", trajneri Hoze Murinjo ka vendosur në krye të listës së shpenzimeve mesfushorin e PSZH-së, Marko Verratti, për të cilin është gati të paguajë 75 milionë sterlina. Ka kohë që përflitet se

Verratti do të largohet nga kampionët e Francës dhe me ardhjen e trajnerit të ri kjo mund të bëhet realitet, ndaj dhe Murinjo po kërkon një mesfushor fantazist për skuadrën e tij. Duke qenë se mesfushorët Fellaini dhe Karrik do të largohen nga skuadra e Junajted këtë verë, trajneri portugez kërkon dy zëvendësues të denjë dhe pas Fred, Verratti konsiderohet si ideal për lojën e Murinjos.

Mesfushori italian konsiderohet si Çavi për sa i përket magjisë me topin dhe mund të krijojë shumë aksione sulmuese për skuadrën e Junajted. Duket se trajneri Hoze Murinjo kërkon të ndërtojë një skuadër me lojtarë teknikë, që të përballlet me "armë" të njëjta me rivalët e Sitit. Palët kanë nisur bisedimet dhe pritet që Verratti të komplotojë transferimin në Premier Ligë.



Juve arrin akordin me Perin

Pas Kaldarës dhe Spinazzolës, Juventus po bën gati prezantimin e dy afrimeve të tjera, gjatë javës së ardhshme. Së pari pritet të vijë e të firmosë një kontratë 4-vjeçare, mesfushori turko-gjerman Emre Khan, që vjen me parametra zero nga Liverpooli. Më pas do të prezantohet edhe Mattia Perin, portieri i Xhenoas, për të cilin mediat raportojnë se është arritur akordi i transferimit në Torino. Juventus do të paguajë në arkat e kuqebluve 15 milionë euro, për të sjellë në Torino atë që bashkë me Sçesnin do të tentojnë të zëvendësojnë legjendën Buffon. Gjithsesi edhe pas këtyre katër afrimeve, mund të thuhet se puna në merkaton e Juves sapo ka nisur, pasi synimet dhe objektivat janë ende të shumta. Kështu në orët e fundit janë shtuar përpjekjet për të marrë nga Milani mbrojtësin Alessio Romanjoli, i cili pëlqehet shumë nga Allegri. Bardhezinjtë po shpresojnë në një pezullim të Milanit nga Liga e Evropës, për ta pasur më të lehtë të arrijnë të mbrojtësi 23-vjeçar. Më pas puna do të përqendrohet për të gjetur një mesfushor cilësor, ku më i pëlqyeri është Milinkoviç-Saviç dhe një sulmues, duke qenë se tashmë besimi ndaj Higuain mungon.

Klopp te Reali, vetëm nëse ia plotësojnë dy kushte

Në Real Madrid janë duke punuar për të gjetur zëvendësuesin më të mirë për Zinedin Zidan. Emri i cili është më favorit është ai i Mauricio Pochettino, por Tottenhami ka deklaruar që do e kenë të vështirë për tu marrë trajnerin dhe presidenti i "Los Blancos" është duke menduar për të tjera alternativa. Përveç trajnerit të Tottenhamit, një tjetër trajner i Premier Ligës është shumë i pëlqyer në "Santiago Bernabeu". Bëhet fjalë për Jurgen Klopp, trajneri gjerman i cili udhëheq Liverpoolin. Klopp është vendosur në dijeni që ekipi i bardhë e kërkon dhe



ka vendosur disa kushte për të marrë drejtimin e kampionëve të "Champions League". Pikë së pari

janë nënshkrimet. Klopp dëshiron dy lojtarë nëse përfundon tek Real Madrid si trajner. Dhe ata

janë dy bombat e "kuqve", Mohamed Sallah dhe David De Gea. Klopp dëshiron që në klub ku supozohet të shkojë të ketë shërbimet e egjiptianit, të cilat i cilëson thelbësore për idetë themelore të lojës. Ai gjithashtu ka kërkuar De Gean, pasi dëshiron në klub një portier të një klasi të lartë të futbollit botëror. De Gea është një nga synimet e hershme të Florentino Perez. Sipas "Don Balon" Klopp nuk e llogarit te Real Madridi Bejllin, pasi dëshiron Sallah dhe për uellsiani nuk ka hapësirë. Kushtet e tij Klopp ja ka lënë në tavolinë Perez.

Të gjithë pas talentit të Serisë A

Është vetëm 20 vjeç, ka shkëlqyer në Serinë A me Fiorentinën, ku në 63 ndeshje ka realizuar 9 gola, ndjekur gjurmët e babait të tij. Aq sa të grumbullohet edhe në kombëtaren "azzurre", ku pritet të ketë një fanellë prej titullari. Ai është Federico Chiesa, djali i futbollistit Enriko Chiesa, që këtë verë pritet të jetë protagonist në merkaton mes shumë të rinjve si Mbappe e Dembele. Ofertat në adresë të Chiesa nuk kanë munguar, ku e para që bëri hapin e madh për ta marrë ishte Roma, duke ofruar 40 milionë euro si dhe sulmuesin El Shaaravy, por pa sukses. Më pas tentoi Napoli, duke ofruar 50 milionë euro edhe një lojtar, por edhe kjo ofertë u refuzua nga klubi "vjolcë". Por edhe skuadra të tjera italiane si Interi dhe Juventus synojnë të marrin talentin e Fiorentinës. Chiesa ka një kontratë me Fiorentinën deri në vitin 2022, nga e cila përfiton rreth 2 milionë euro për sezon



(bashkë me bonuse), shumë që natyrisht do të rritet këtë verë në rast se lojtari do të gjejë një skuadër tjetër. Për këtë arsye ka nisur një ankand për të marrë lojtarin, në të cilin janë përfshirë edhe ekipet "big" të Evropës si Liverpool, Mançester Junajted e Mançester Siti, që kanë nisur kontaktet me menaxherin e lojtarit.

Levandovski te Juventus nëse ikën Higuain


Sulmi i Juventusit mund të pësojë një ndryshim radikal sezonin e ardhshëm, por për të mësuar emrat atyre që do të jenë nën urdhrat e trajnerit Maks Allegri duhet pritur deri në fund të Botërorit "Rusi 2018". Nëse sulmuesi argjentinas Gonzalo Higuain do të lërë kampionët e Italisë, atëherë këta të fundit do të kërkojnë një zëvendësues të denjë dhe orët e fundit përflitet se drejt Torinos mund të shkojë sulmuesi polak Robert Lewandovski, që kërkon të largohet nga Bajerni Munihi. Lewandovski, 106 gola në 126 ndeshje me kampionët e Gjermanisë, ka kërkuar të largohet nga skuadra bavareze, pasi kërkon një aventurë të re dhe pasi dështuan negociatat për të luajtur me Real Madridin, është hapur një dritare e re, ajo e transferimit te Juventus. Polaku konsiderohet një sulmues i klasit botëror, i nivelit të Ronaldo, Messi e Higuain, i aftë të realizojë dhe me përvojë në arenën ndërkombëtare, aty ku bardhezinjtë synojnë të shkruajnë em-



rin, për të fituar "Champions League" sezonin e ardhshëm. Sulmuesi polak më 21 gusht do të mbushë 30 vjeç dhe kushton rreth 80 milionë euro, një shumë e lartë, ndaj bardhezinjtë do të nisin manovrat në merkato për të ulur çmimin e lojtarit, duke ofruar edhe lojtarë të tjerë. Një pjesë e mirë e të ardhurave mund të vijnë nga shitja e Higuain, që mund të largohet drejt Çellsit pas Botërorit.

RUSI 2018

Nga njëra anë do të jenë të pranishëm kampionë që vlejnë më shumë se 100 milionë euro, nga tjetra ata që nuk arrijnë as në 500 mijë euro. Më poshtë, do të analizojmë pikërisht lojtarët e Rusi 2018 që vlejnë më pak



LOJTARËT QË VLEJNË MË PAK

Për shumë futbollistë të grumbulluar nga 32 kombëtarët që do të luajnë në Kupën e Botës, që do të fillojë 14 qershorin e ardhshëm, do të jetë mundësia e vetme për të treguar vlerat e tyre në nivel ndërkombëtar. Nga njëra anë do të jenë të pranishëm kampionë që vlejnë më shumë se 100 milionë euro, nga tjetra ata që nuk arrijnë as në 500 mijë euro. Më poshtë, do të analizojmë pikërisht lojtarët e Rusi 2018 që vlejnë më pak. Sipas vlerës së merkaton që çdo lojtari i është dhënë nga portali i specializuar "Transfermarkt", dy lojtarët me vlerësimin më të ulët mes atyre që do të udhëtojnë drejt Rusisë, janë dy shokë skuadre. Vlejnë 175

mijë euro dhe janë pjesë e Panamasë, e kualifikuar për herë të parë në historinë e saj në fazën finale të një Botërorit. Bëhet fjalë për qendërmbrojtësin 23-vjeçar të Nju Jork Red Bulls, Fidel Eskobar, i cili ka luajtur vetëm dy ndeshje në 13 javët e para të kampionatit amerikan. Tjetri është sulmuesi 36-vjeçar i ekipit peruan të Sport Boys, Luis Tejada, veteran i kombëtares të vendit të Amerikës Qendrore, me të cilin ka luajtur 104 ndeshje dhe ka realizuar 43 gola, që e bëjnë atë golashënuesin më të mirë të historisë së Panamasë. Më pas, me një vlerësim 200 mijë euro, gjejmë tre lojtarë të tre kombësive të ndryshme. Janë mesfushori 35-vjeçar i

Islandës (luan me Karabukspor) Olafur Ingi Skulason (16 ndeshje dhe një gol në kampionatin e fundit, qendërmbrojtësi 34-vjeçar i Kosta Rikës, Xhonny Akosta, i cili luan me kolumbianët e Rionegro Aguilas, dhe portieri 32-vjeçar peruan, kapiteni i Klub UTC, Hose Karvallo. Pak më i lartë është vlerësimi i shokut të tij të skuadrës, qendërmbrojtësit 34-vjeçar të Perusë, Alberto Rodriguez, kartoni i të cilit vlen 225 mijë euro. Ndërkohë, me një vlerë 250 mijë euro është një katërshë e përbërë nga dy lojtarë të Panamasë, sulmuesi 24-vjeçar, Abdiel Arrojo, dhe mbrojtësi 26-vjeçar, Harold Kummings; nga mbrojtësi 20-vjeçar i krahut të

djathtë, që luan me Kosta Rikën, Ian Smith, dhe nga portieri 35-vjeçar i Japonisë, Eiji Kavashima. Ky i fundit është i vetmi mes lojtarëve të këtij klasifikimi, i cili ka luajtur në 5 kampionatet kryesore të Evropës. Në fakt, në sezonin e fundit ka zhvilluar 30 ndeshje në Ligue 1 me fanellën e Metz. Janë të shumtë lojtarët që kanë një vlerë më të ulët se 500 mijë euro, por vetëm njëri prej tyre luan në një prej 5 kampionateve kryesore të Evropës. Bëhet fjalë për portierin 19-vjeçar nigerian të Deportivo La Korunja, Francis Uzoho, që ka luajtur vetëm dy ndeshje në sezonin e fundit. Vlera e tij është 300 mijë euro.



Yjet e Realit tallen me Liverpoolin në "Anfield"

Tifozët e Liverpoolit do të donin ta harronin sa më shpejt të ishte e mundur humbjen e pësuar kundër Real Madridit në "Champions League", por kjo është gjëja e fundit për të cilën mendojnë lojtarët e Real Madrid. Fati ka dashur që disa prej yjeve të Real Madrid të luajnë një miqësore në shtëpinë e Liverpoolit para fillimit të Kupës së Botës, me Brazilin që do të ndeshet të dielën pasdite me Kroacinë. Pjesë e këtyre dy ekupeve janë Marcelo, Luka Modriç dhe Mateo Kovačić, të cilët shfaqen duke qeshur para logos së Liverpoolit në "Anfield". Një rastësi apo një tallje ndaj skuadrës së Klopp? Fotografia Po bënit xhiron e internetit dhe komentet tallëse ndaj Liverpoolit nuk mungojnë.

Lëndohet Kompani



Gjendja fizike e Vinsent Kompani është një brengë e madhe për Roberto Martinezin, pasi mbrojtësi i Manchester Sinit e braktisi fushën duke çaluar në sekondat e para të pjesës së dytë në një ndeshje miqësore. Kur Martinezin i kanë mbetur vetëm edhe dytë ditë për ta publikuar listën prej 23 futbollistëve që do ta përfaqësojnë Belgjikën në Rusi, Kompani e tërhoqi muskulin teksa u zgjat për të bërë një ndërhyrje në barazimin pa gola të Belgjikës kundër Portugalisë të shtunën në Bruksel. Kompani ka qenë pronë e lëndimeve në kofshë në vitet e fundit dhe tani vendi i tij në Kupën e Botës është vënë në dyshim serioz. Martinez, megjithatë, është i gatshëm t'i japë kohë atij ta dëshmojë formën fizike para se ta bëjë të ditur listën me lojtarët që do t'i marrë në Botëror. "Sot duhet të shohim se çfarë nuk shkon me Vinny", tha Martinez. "Ai ndjeu diçka në kofshën e tij. Të hënën do ta skanojmë. Lëndimet e tilla kërkojnë pushim fillimisht, por jam vërtet i brengosur", deklaroi Martinez.

HUMB 37 KILOGRAM

I kërkon Kuperit ta ftojë në Botëror

Sulmuesi i njohur egjiptian, Mido, javë më parë ishte kritikuar shumë nga tifozët për kilogramët e tepërt. Por, ai është përgjigjur tifozëve në mënyrë të mundshme, ka humbur 37 kilogram në pak muaj. Në mes të tjerave ka edhe një kërkesë për trajnerin e Egjiptit, Hektor Kuper. "Zotëri Kuper, e di që je i dëshpëruar për një sulmues që mund të mbajë topin për ju në kundërsul-

me. Kam shënuar gol çdo dy ndeshje për Egjiptin, pra ju keni të garantuar gol nga unë në Kampionatin Botëror në tri ndeshjet e fazës së grupeve", ka shkruar Mido në "Twitter". 35-vjeçari është pensionuar nga Përfaqësuesja e Egjiptit në vitin 2009. Si futbollist ai luajti për skuadra të mëdha si Gent, Ajaksi, Marsej, Roma, Tottenham dhe Midëllzboro.



PËRDOR PASAPORTË IZRAELITE



Abramoviç rrezikon dëbimin nga Anglia

Roman Abramoviç mund të ndalohet dhe të riatdhesohet nga Mbretëria e Bashkuar nëse ai do të përdorë pasaportën e tij të re izraelite për të hyrë rregullisht në Angli. Miliarderit rus, pronar i Çellsit nuk iu rinovua viza, pasi kishte skaduar në prill, por ai mori nënshkrimin dhe pasaportë izraelite këtë muaj, për të mundësuar futjen e tij në Mbretërinë e Bashkuar. Pasaporta e re i lejon Abramoviç që të vizitojë Mbretërinë e Bashkuar për biznes

për 6 muaj në çdo udhëtim. Por zyrtarët qeveritarë deklaruan se ai nuk mund të futet dhe të dalë kur të dëshirojë. Ligji britanik për emigracionin nuk i lejon vizitorët për biznes që të jetojnë në Britani për një periudhë të gjatë kohe, përmes vizitave të shpeshta ose të njëpasnjëshme. Ky fakt mund të ketë një impakt domethënës në të ardhmen e Abramoviç në krye të Çellsit. Abramoviç tashmë ka anuluar propozimin e klubit për ndërtimin e

stadiumit të planifikuar me vlerë 1 miliardë sterlina, duke cituar motive që lidhen me eficientësinë e kostos për një impiant që do të kishte 18,000 vende më shumë se "Stamford Bridge". Hierarkia e Çellsit ishte gjithashtu e shqetësuar në lidhje me koston e rialokimit gjatë asaj që do të ishte një mërgim 4-vjeçar pa stadium me "Wembley" si vend kandidat, aktualisht është objekt ankandi, me Shahid Khan që ka ofruar 900 milionë sterlina.

SKANDAL NË MOTO GP

Tifozët i bëjnë varrin Marquezit në Mugello

Që fansat italianë të Moto GP nuk e duan aspak pilotin spanjoll Mark Marquez kjo dihet. Edhe se mikpritja që i rezervuan kampionit të botës nuk ishte nga më të mirët dihej gjithashtu, por

këtë herë fansat kanë kaluar çdo limit. Të paktën duke parë fotot që kanë postuar në rrjetet sociale, ku është improvizuar një varr me datën e lindjes dhe atë të vdekjes së pilotit të Hondës (3 qershor).

Një gjest aspak i këndshëm, që ka krijuar mjaft polemika, pasi varri që është improvizuar është bërë në zonën pranë pistës së Mugello, ku u zhvillua gara e djeshme.



IVAN RAKITIÇ VLERËSON BASHKËLOJTARIN E TIJ

MESSI DO T'I FITONTE 50 TITUJ "GRAND SLAM" SIKUR TË LUANTE TENIS

"Natyrisht se kur e ke lojtarin më të mirë në botë je favorit, edhe pse ai thotë se nuk janë. Ai do t'i jepte disa tituj me Barcelonën për Kupën e Botës. Sikur Messi të luante tenis, ai do t'i kishte fituar 50 tituj grand slam", pohon Rakitiç



Lionel Messi është sportist aq dominues sa që do t'i kishte fituar hiç më pak se 50 tituj "grand slam", sikur të ishte tenisist, thotë bashkëlojtari i tij te Barcelona, Ivan Rakitiç. Messi e ka frymëzuar Barcelonën drejt dy titujve në sezonin 2017/18, La Ligën dhe Kupën e Mbretit, teksa vetë e fitoi Këpucën e Artë si golashënuesi më i mirë për herë të pestë në karrierë. Megjithatë, ai ende nuk ka fituar ndonjë trofe të madh ndërkombëtar, pasi me të Argjentina e humbi një finale të Kupës së Botës dhe dy finale të Kupës së Amerikës në katër vitet e fundit. Por, Rakitiç, i cili është duke

u përgatitur për Kupën e Botës 2018 po ashtu, sugjeroi se Argjentina – që është në një grup me Kroacinë – kanë mundësi të mirë për ta fituar Botërorin në Rusi, përkundër se Messi ka insistuar se nuk janë favorit. "Siç u kam uruar të gjithë bashkëlojtarëve tjerë që marrin pjesë në Botëror edhe Messit i kam uruar

fat", ka thënë Rakitiç. "Natyrisht se kur e ke lojtarin më të mirë në botë je favorit, edhe pse ai thotë se nuk janë. Ai do t'i jepte disa tituj me Barcelonën për Kupën e Botës. Sikur Messi të luante tenis, ai do t'i kishte fituar 50 tituj grand slam", deklaroi Rakitiç. "Grand slam"-et janë titujt më të rëndësi-

shëm në sportin e tenisit, dhe mbahen katër herë në vit. Rekordin për më së shumti tituj të fituar e mban tenisisti zviceran, Rogjer Federer, me 20 në total. Federer konsiderohet nga shumë si njëri prej atletëve më të mëdhenj në histori të sportit dhe si tenisist më i mirë i të gjitha kohërave.

Diaz kërkon nga UFC të ndeshet me MekGregorin



Nate Diaz ka bërë me dije se në mendjen e tij është një rival me të cilin ai dëshiron të përballlet në rikthimin e tij në kafaz, pas dy vitesh pushim. Amerikani i arteve marcialë mikse nuk duhet që kur ka humbur revanshin me Konor MekGregor dhe këtë vit ka deklaruar se do të ngjitet sërish në kafaz, por ende nuk ka një datë të saktë se kur do të ndodhë kjo gjë. 33-vjeçari, duke folur për mediat, tha: "I kam kërkuar UFC-së që të përballem me një njeri të vetëm, të zhvilloj atë duel. Tani pres një përgjigje nga ata, pasi unë jam gati për t'u rikthyer", u shpreh Nate Diaz. Por duket se presidenti i UFC-së, Dana Uajt, ka të tjera plane për kampionin amerikan, duke u shprehur: "Unë i kam ofruar atij mjaft duela në këto dy vite, por ai ka refuzuar gjithnjë. Në kontratën që të dy vëllezërit (Nik dhe Nate) kanë me UFC-në, ata duhet të zhvillojnë tri përballje në vit, në të kundërtën duhet t'i paguaj. Unë e kam përbushur detyrën time, por ata i kanë refuzuar sfidat, duke i vënë kapak marrëveshjes. Megjithatë, ne po punojmë që të organizojmë një duel të madh mes Nate Diaz dhe Georges St-Pierre këtë vit", tha Dana.

Të gjithë stërviten për botëror, Ronaldo luan tenis

Lojtari më i mirë zyrtarisht në botë, në 2 vjet e fundit është duke e shijuar një pushim të vogël para se të nisët me Kombëtarën e Portugalisë në Kupën e Botës, Rusi 2018. Ronaldo ka kaluar sezon fantastik, duke ndihmuar Realit të fitoj titullin e Ligës së Kampionëve për

herë të tretë radhazi. Ndeshja e tij e fundit ka qenë më 26 Maj, ndërkaq për tu relaksuar para Kupës së Botës ai po pushon me miqtë e tij në Marbella të Spanjës. Ronaldo ka gjetur kohë edhe për një ndeshje tenisi në fushë me dhe të kuq, me shokët e tij.



Përmirësohet gjendja shëndetësore e Fergusonit

Sër Aleks Ferguson është tashmë jashtë spitalit, më pak se një muaj pas operacionit emergjent të trurit, pas një hemorragjie cerebrale. Legjenda e Mançester Junajtdit, 76 vjeç, tani është nën kujdesin për shëndet të plotë nga të dashurit e tij. Burime nga rrethi i tij i njerëzve të brendshëm shpreson që ai të kthehet në vendin e vet në "Old Trafford" për fillimin e sezonit, në gusht. Një burim tha për "The Sun" se, "Të gjithë e dinë

se Ferguson është fitues dhe kjo ishte një betejë, që kurrë nuk do ta humbiste. Ai është kthyer me këmbët e tij në shtëpi dhe është i kënaqur që ndodhet jashtë spitalit, transmeton KP. Natyrisht, është pafundësisht mirënjohës ndaj stafit mjekësor, që e ka trajtuar. Parashikimet janë jashtëzakonisht premtuese dhe do të jetë vetëm çështje kohe, para se Ferguson të kthehet në "Teatrin e Ëndrrave". Ndërkohë, ai mund të ndjekë nga

televizori Kupën e Botës, të jetojë sërish me emocionet e futbollit. Ferguson kaloi në koma dhe u vendos në spitalin "Royal Salford", më 5 maj, pasi pësoi një hemorragji cerebrale. "The Sun" zbuloi fjalët e tij të para, kur u përmend, pas operacionit: "Si doli Donkaster sot?" E kishte fjalën për ekipin e të birit, Darren, që humbi 1-0 ndaj Vigan. Ai, madje, bëri shaka me familjen, edhe pse në shtrat, për të shkuar e parë Liverpuln në finalen



e Ligës së Kampionëve të javës së kaluar, në Kiev. Një zëdhënës i Mançester Junajtdit tha se nuk

do të ofronte përditësime mbi gjendjen shëndetësore të Sër Aleks Ferguson.

Ka dy vjet që është inauguruar linja e interkoneksionit mes Kosovës dhe Shqipërisë, por e cila ende mbetet jofunksionale për shkak të bllokimit të lëshimit në qarkullim nga ana e Serbisë, thonë zyrtarët në Qeverinë e Kosovës

SERBIA MBAN TË BLOKUAR LINJËN ENERGETIKE KOSOVË-SHQIPËRI



Kjo linjë, ishte shpallur e përfunduar, inauguruar dhe testuar në qershor të vitit 2016. Linja interkoneksionit 400 kilovatësh në mes Shqipërisë dhe Kosovës, ka një shtrirje në një gjatësi totale prej 241.1 kilometrave, nga të cilat 151.1 kilometra shtrihen në territorin e Shqipërisë dhe 90 kilometra në territorin e Kosovës, ka kushtuar 75.5 milionë euro. Mbi 33 milionë euro u financuan nga Kosova, ndërsa 42 milionë të tjera nga Shqipëria.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik në Qeverinë e Kosovës, Valdrin Llluka, thotë se trysnia e Qeverisë së Kosovës për zgjidhjen e këtij problemi është rritur shumë. Por, Beogradi zyrtar, sipas tij, po pengon zhblokimin e linjës, duke insistuar që marrëveshja energjetike të ngritet në bisedimet Prishtinë - Beograd, që po zhvillohen në Bruksel me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. "Kjo punë ka marrë një hov më të madh, jemi shumë më dinamik. Tashmë kemi edhe një negociator gjerman, ish ministër të Gjermanisë, Klaus Toepfe, i cili po na ndihmon

në zgjidhjen e problemit, në mes Kosovës dhe Serbisë".

"Jemi në diskutime e sipër. Në takimin e fundit që kemi qenë se bashku jemi pajtuar që të shikojmë edhe në një takim në nivel politik në Berlin, në mes Kosovës e Serbisë me ndërmjetësimin e ish ministrit gjerman për të shikuar zgjidhjen e problemit në mënyrë sa më të shpejtë", ka thënë Llluka për Radion Evropa e Lirë. Ndërkaq, ish-ministria për Dialog në Qeverinë e Kosovës, Edita Tahiri për Radion Evropa e Lirë, vlerë-

son se në këtë drejtim po mungon një angazhim më serioz i Qeverisë së Kosovës, por që edhe Bashkimi Evropian, sipas saj, nuk po bën presion sa duhet ndaj Serbisë.

Tani kur Kosova e ka filluar procesin drejtë zbatimit marrëveshjes së Asociacionit, shprehet ajo, është koha që edhe Serbia të zbatojë marrëveshjen energjetike, por edhe marrëveshjet tjera të arritura të cilat nuk po zbaton. "Atëherë në një mënyrë Bashkimi Evropian nuk është një ndërmjetësues i cili po përcjell agjendën kohore dhe

obligimet e të dyja e palëve. Pastaj, Qeveria e Kosovës duhet të jetë më e zëshme, unë nuk po e shoh se është e zëshme. Kjo qeveri vetëm një herë ka mbajtur takim teknik në Bruksel dhe në atë ka dështuar. Pra, nuk po shoh angazhim serioz në këtë drejtim nga ana e Qeverisë sonë", thotë Tahiri. Ajo tha po ashtu se Beogradi po zvarritë zbatimin e marrëveshjeve të arritura me Prishtinën, duke u munduar që ato t'i bartë për fazën finale të bisedimeve.

Ndryshe, nga moszbatimi i

marrëveshjes për energjinë, të nënshkruar në vitin 2013 ndërmjet përfaqësuesve të Prishtinës dhe Beogradit, shteti i Kosovës humb rreth 25 milionë euro në vit, thotë në anën tjetër, ministri Llluka, duke përfshirë këtu edhe bllokimin e linjës energjetike Kosovë-Shqipëri. "Rreth 10 milionë euro nga inkasimi i tarifave të transmisionit, që energjia kalon transit përmes Kosovës, kurse Serbia i inkason mjetet në emër të Kosovës. Kemi deri 11 milion euro që qytetarët e veriut nuk e paguajnë energjinë e shpenzuar, 2 milion euro humbin për shkak mos të aktivizimit të linjës dhe po ashtu rreth 2 milion euro që paguhen për kthimin e kredisë që është bërë investimi në rrjet", tha Llluka. Linja e interkoneksionit Kosovë-Shqipëri është bllokuar për shkak të mos zbatimit të marrëveshjes energjetike në mes Prishtinës dhe Beogradit, që është arritur në Bruksel.

Në bazë të kësaj marrëveshje kusht për Serbinë është edhe regjistrimi i një kompanie të re serbe, sipas kornizës ligjore të Kosovës, e cila do të furnizojë me energji konsumatorët në katër komunat veriore më shumicë serbe. Autoritetet kompetente të Kosovës kanë plotësuar të gjitha kriteret dhe kushtet për regjistrimin e kësaj kompanie, por që Serbia nuk po e bën një veprim të tillë.

Akuzat për korrupsion përfundojnë në "plehra"

Luftimi i krimit të organizuar dhe korrupsionit, përbën tashmë një prej kërkesave më të shpeshta të faktorit ndërkombëtar, drejtuar institucioneve përgjegjëse të Kosovës

Ngritja e aktakuzave ndaj zyrtarëve të ndryshëm, pikërisht nën dyshimet për përfshirje në krim dhe korrupsion, nuk ka munguar. Por, sipas organizatave që monitorojnë punën e organeve të drejtësisë, edhe në këtë çështje ka një element shqetësues, pasi që shumica nga këto aktakuzat hidhen poshtë, si të pabaza nga gjykatat.

Zhvillime të tilla ngrenë shumë dilema e shqetësime rreth punës, qoftë të Prokurorisë dhe Hetuesisë, e po ashtu edhe rreth punës së gjykatave.

Janë disa raste në Kosovë për të cilat janë ngritur aktakuzat, por më pas janë hedhur poshtë për mungesë të provave. Kryeprokurori i Shtetit, Aleksandër Lumezi, ishte akuzuar se e kishte falsifikuar provimin e jurisprudence, por pas hetimeve të bëra nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, nën monitorimin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit, EULEX, doli se Lumezi nuk e kishte falsifikuar provimin. Ditë më parë, Gjykata Themelore në Prishtinë, kishte shpallur të pafajshëm ish-kryetarin e Gjykatës së Apelit, Salih Mekaj, i cili ishte akuzuar për veprën penale ushtrim i ndikimit.

Derisa i pafajshëm ishte shpallur edhe ish-rektori i Universitetit të Prishtinës, Enver Hasani, i cili ishte akuzuar për keqpërdorime duke lidhur kontratë për përkthi-

min e disa librave nga gjuha angleze në gjuhën shqipe, për nevoja të Universitetit të Prishtinës. Ehat Miftaraj nga Instituti i Kosovës për Drejtësi, thotë për Radion Evropa e Lirë se sistemi i drejtësisë në Kosovë ka të bëjë me shumë raste gjyqësore ku aktakuzat hidhen si të pabaza. "Instituti i Kosovës për Drejtësi, si rezultat i monitorimit sistematik të rasteve të korrupsionit, ka gjetur se te rastet e korrupsionit të nivelit të lartë, një numër jashtëzakonisht i madh i tyre hidhen poshtë për shkak të mungesës së provave, fakteve ose të njëjtat janë trajtuar në mënyrë joprofessionale. Si institut, kemi thënë vazhdimisht se është jashtëzakonisht e vështirë që të hidhen poshtë aktakuzat e prokurorëve nëse po të njëjtat do të ishin të mbështetura në fakte dhe prova", thotë Miftaraj.

Ai thekson se rastet kur prokurorët konstatojnë apo kanë dyshime se aktakuzat e tyre hidhen poshtë si të pabaza, ata mund dhe

obligohen edhe në bazë të ligjit dhe Kushtetutës, që në çdo rast kur dyshohet se këto raste manipulohen nga gjyqtarët, të iniciojnë edhe ndjekjen penale. Por, fatkeqësisht shton Miftaraj, pavarësisht se ka një numër të madh të aktakuzave që hidhen poshtë, ende nuk ka pasur asnjë analizë apo vullnet nga sistemi prokurorial për t'i trajtuar këto çështje dhe për t'i adresuar ato në praktikë. Rezultatet konkrete në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, sidomos të nivelit të lartë, tashmë janë kushti i fundit për Kosovën nga ana e Komisionit Evropian, për liberalizim të vizave.

Jeton Zulfaj nga organizata joqeveritare "FOL" thotë për Radion Evropa e Lirë se aktakuzat për korrupsion të nivelit të lartë po ngrihen edhe për shkak, siç thotë ai, plotësimit të kushtit për liberalizim të vizave. Megjithatë, ai shton se nuk do të duhej të ngrihen aktakuzat vetëm për të përmbushur një kriter, por ato duhet të

jenë të bazuara në prova. Ai shton se nuk mund të ketë edhe nivel të lartë të korrupsionit edhe mungesë të provave.

"Prokuroria duhet të ngritë një aktakuzë kur është e sigurt se i ka provat përtej dyshimit të bazuar dhe ka mjaftueshëm prova që nuk mund të rrëzohen në gjykatë. Nganjëherë për shkak të luftës kundër korrupsionit, që është bërë edhe kusht për liberalizim të vizave, duket se shumë aktakuzat janë ngritur vetëm për të shënuar si numër dhe kanë hyrë në hetim dhe kanë shkuar në gjykatë", thotë ai. Institucionet e Kosovës, sidomos ato të sundimit të ligjit, janë ndihmuar në 10 vjetët e fundit edhe nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit - EULEX. Por, sipas vlerësimeve të bëra, po nga organizatat joqeveritare, edhe ky mision nuk kishte përmbushur pritjet, sidomos kur bëhet fjalë për rastet e cilësuar të ndjekjes dhe gjykimin të rasteve të nivelit të lartë.

NATO nuk do të mbrojë Izraelin nëse e sulmon Irani



Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, deklaroi se aleanca ushtarake nuk do të dilte në mbrojtje të Izraelit në rast se e sulmon "armiku i madh" Irani. Stoltenberg të shtunën për revistën "Der Spiegel" tha se Izraeli është partner, por jo edhe anëtar, ashtu që "garancia e sigurisë nga NATO" nuk ka të bëjë me këtë vend. Ai theksoi se NATO nuk është i përfshirë në përpjekjet për paqe në Lindjen e Mesme apo përlëshjet në atë rajon. Stoltenberg këto deklarata i bëri në kohë të tensionit të rritur mes Izraelit dhe Iranit. Kryeministri izraelit, Benjamin Netanyahu, kohët e fundit ka intensifikuar kritikën për marrëveshjen midis fuqive botërore dhe Iranit që bëri lehtësimin e sanksioneve të Teheranit në shkëmbim të frenimit të programit të tij bërthamor. Shtetet e Bashkuara muajin e kaluar u tërhoqën nga marrëveshja. Izraeli dhe Irani po ashtu konfliktohen për shkak të pranisë ushtarake të Iranit në Siri.

Grabit e më pas e vret nusen

Ministria e Brendshme e Kirgizisë tha se policia do të dënojë vrasësin brutal të 20 vjeçarës që ishte kidnapuar si shkak i traditës së kidnapimit të nuseve. Ministri i Brendshëm Kashkar Junushaliev po merret drejtpërsëdrejti me këtë çështje, për shkak se pas ndalimit nga policia kishte ndodhur edhe vrasja. Hetuesit kishin lënë viktimën dhe vrasësin në një dhomë për arsye të panjohura. "Sot ose nesër, si rezultat i hetimeve të brendshme, zyrtarët që janë treguar neglizhentë, do të mbajnë përgjegjësi", tha ministri.

Prokurorët e Kirgizisë kanë hapur hetime mbi këtë vrasje, ndërkaq 29 vjeçari, identiteti i të cilit ende nuk dihet, është hospitalizuar për shkak të plagosjes së vetvetes, thanë zyrtarët.



Sllovenia është anëtare e BE dhe NATO-s, ka si monedhë euron, dhe në vitet e fundit të krizës së migrimit në Ballkan i mbajti lart vlerat europiane. Por tani drejtimi i erës duket se po ndryshon. Një problem i ri për BE?

Mbi 1.7 milionë votues sllovenë votuan dje për Parlamentin e ri slloven. Sipas të gjitha sondazheve, partia opozitare konservatore, SDS del fituese. Në një analizë të agjencisë gjermane të lajmeve, DPA për zgjedhjet në Slloveni, theksohet debati në Slloveni për rrezikun e "urbanizimit" të vendit. Kreu i qeverisë hungareze, Viktor Orban ka marrë pjesë në fushatën zgjedhore të demokratëve konservatorë sllovene, SDS. Ai ka qenë i ftuar nga partia sllovene, si idol i kreut të partisë SDS, Janez Jansa. Politikanët e qendrës dhe të majtë nuk lodhen me paralajmërimet për një "urbanizim" të Slloveinsë.

Orban me konceptin e tij të "demokracisë iliberale" do t'u mësojë sllovenëve mbrojtjen pa kompromis nga refugjatët, luftën kundër shoqërisë civile dhe pengimin

e punës së organizatave jo-qeveritare, thekson dpa. Kështu një kryetar i mundshëm i një qeverie konservatore, Janez Jansa do ta afronte Slloveninë me vendet e Vishegradit. Që tani shtetet e bashkuara aty, Polonia, Çekia, Sllovakia, Hungaria i shkaktojnë dhimbje koke Brukselit. E tronditur partia Desus pjesëmarrëse në qeveri paralajmëron sllovenët nga një "model hungarez".

Programi për politikën e brendshme i partisë konservatore, SDS duket se pritet mirë nga shumë votues sllovenë: ulje tatimesh, reduktim i burokracisë shtetërore, ndalim i mbulimit të fytyrës. Por Jansa (që ka qeverisur në vitet 2004-2008 dhe 2012-2013) duket se ka për të pasur vështirësi në gjetjen e një partneri për krijimin e koalicionit qeverisës. Sepse shumica e partive, si pas gazetës më të rëndësishme sllovene

"Delo" kanë tradicionalisht një "refleks anti Jansa". 59 vjeçari është një figurë e kontestuar që nga fillimet e pavarësisë së Sllovenisë dhe ka luajtur një rol në disa afere korupsioni si në blerjen e disa armatimeve ushtarake apo shitjen e truallit.

Gazeta sllovene "Dnevnik" shikon politikanin e ri, Marjan Sarec si "kurorëzues", pra që mund të ketë një rol të rëndësishëm në krijimin e koalicionit të ardhshëm. Ekspertët janë të mendimit, se 40 vjeçari, ish-komedian dhe kryetar bashkie më qëndrim të majtë e të qendrës mund të kapë vendin e dytë me 16% të votave. Në vendin e tretë sondazhet nxjerrin socialdemokratët me 14% dhe në vend të katërt partinë e kryetarit aktual të qeverisë, Miro Cerar, SMC. Krijimi i qeverisë sllovene këtë herë duhet se nuk ka për të qenë i lehtë.

SLLOVENIA,

EDHE NJË PROBLEM TJETËR PËR BE-në

Zgjedhjet lokale, vriten 107 kandidatë



Në 24 orët e fundit, dy kandidatë për zgjedhjet lokale në Meksikë janë qëlluar për vdekje në shtetet e Oaxaca dhe Puebla. El Pais njofton për dy vrasjet, të cilat tregojnë se shumë zona të vendit janë nën "juridiksionin" e bandave të drogës dhe krimit të organizuar.

Që nga fillimi i procesit zgjedhor, të paktën 107 politikanë janë vrarë në të gjithë vendin. Dy viktimat e fundit ishin Maldonado Juan Iraís, një kandidat për Partinë e Gjellbër dhe Pamela Terán, një candidate për Partinë Revolucionare Institucionale (Pri).

Edhe Kanadaja padit Amerikën

Vetëm pak orë pas Bashkimit Europian, Kanadaja ka bërë të ditur se do të padisë SHBA në Organizatën Botërore të Tregtisë. Ministria e Jashtme kanadeze, Chrystia Freeland i quajti ilegale doganat për çelikun dhe aluminin. Doganat e vendosura nga qeveria amerikane me pretekstin e sigurisë kombëtare janë në kundërshtim me detyrimet ndërkombëtare të SHBA-së dhe rregullat e Organi-

zatës Botërore të Tregtisë, OBT, bëri të ditur ministria e Jashtme kanadeze, Chrystia Freeland. Për Kanadanë, aleatin më të rëndësishëm dhe blerësin më të madh të çelikut nga SHBA, këto dogana janë "të papranueshme". Vendi i saj do të mbrojë "punonjësit kanadezë dhe interesat kanadeze ndaj proteksionizmit, që e minon sistemin botëror tregtar", theksoi Freeland. Doganat ndëshkuese amerikane për

çelikun (25%) dhe aluminin (10%) për BE, Kanadanë dhe Meksikën hynë në fuqi të premtën në mëngjes. Të tre partnerët tregtarë të SHBA-së i quajnë ato të padrejta. Si BE edhe Kanadaja dhe Meksika kanë bërë të ditur se do të vendosin dogana për produktet amerikane. Kanadaja planifikon dogana miliardëshe për produktet agrare nga SHBA. Kosi, kafeja dhe lavatriçet nga SHBA do të kenë do-

gana ndëshkuese. Meksika do të vendosë dogana për llampat dhe mollët nga SHBA. Ndërsa BE ka bërë që më parë të ditur kundërmasat, dogana për produkte amerikane që kapin një vlerë prej 2,8 miliardë dollarë, si uiskin, xhinset dhe gjalpin e kikirikut. Europeanët paraqitën tek OBT ankesë zyrtarisht dhe po shohin mundësinë e doganave për produktet amerikane. Komisarja e BE për Tregtinë,

Cecilia Malmström tha se BE nuk i pranon këto dogana mbrojtëse ilegale të SHBA-së. "SHBA luan një lojë të rrezikshme", tha Malmström. Doganat amerikane janë "proteksionizëm i pastër." Edhe Gjermania bën thirrje që europianët të paraqiten "të vendosur e me vetëbesim". "Ndoshta kështu edhe mund ta ndalim një luftë tregtare", tha ministri gjerman i Ekonomisë, Peter Altmaier.

Pagesa bëhet vetëm në para në dorë dhe ka pak ndërveprim mes klientëve dhe stafit. Në vitin 2017, gjithsej 5145 njerëz u regjistruan në Mekanizmin Kombëtar të Referimit si viktimat të mundshme të skllavërisë - 739 ishin vietnamezë, grupi i tretë më i lartë pas shqiptarëve dhe britanikëve

Bandat e krimit të organizuar po veprojnë nëpërmjet salloneve vietnameze të thonjve, që mbulojnë të gjithë Mbretërinë e Bashkuar. Ata po përdorin sallonet për të pastruar paratë e gjeneruara nga fabrikat e kanabisit dhe prostitucioni dhe po lëvizin fëmijë-skllavër mes dyqaneve të ndryshme për të shmangur kapjen nga autoritetet.

Sallonet e thonjve janë gjithashtu të lidhura me emigracionin e paligjshëm, thotë Agjencia Kombëtare e Krimit (AKK). Aktualisht po kryhen 500 hetime mbi skllavërinë moderne. Shtetasit vietnamezë janë grupi i dytë më i madh i huaj i regjistruar si viktimat të mundshme, pas shqiptarëve.

Policia thotë se shumë të rinj vietnamezë po punojnë me orë të gjata me pagesë të vogël, ose pa pagesë fare. Dhe ka mundësi që

NË SALLONET E THONJVE, ATY KU FSHIHEN SKLLEVËRIT VIETNAMEZË DHE SHQIPTARË



dhjetëra fëmijë, të cilët mungojnë nga këshilli i kujdesit kanë rënë përsëri në duart e bandave pasi u shpëtuan nga skllavëria. Sallonet për thonjtë, të cilët janë shtuar në Britani vitet e fundit, u lejojnë bandave të fshehin viktimat, thonë detektivët.

Adam Thompson, nga AKK dhe njësisia e trafikimit të qenieve njerëzore tha: "Sallonet e manikyrit janë një nga zonat më të përhapura ku shohim viktimat vietnameze, zakonisht meshkuj në moshë mjaft të re, rreth 18 ose 19 vjeç". Bandat i rekrutojnë ata nga Vietnamit. Njerëzve u thuhet: "Ejani në Britani të Madhe, do të keni një

punë mjaft të mirë, do të paguheni shumë dhe do të keni para për t'ia dërguar familjes suaj". Ata më pas do të përdorin shërbimet e një bande të organizuar të emigracionit... përmes Kinës, Rusisë, pastaj në Evropë dhe më pas në Mbretërinë e Bashkuar, zakonisht në mënyrë klandestine në anën e pasme të një kamioni.

Pastaj ato do të lidhen me bandat në Britani të Madhe, të cilët do t'i dërgojnë të punojnë në një salon manikyri. Ai tha se bandat kanë zhvendosur viktimat në të gjithë vendin, duke shtuar: "Disa prej tyre pretendojnë se janë fëmijë... ata do të shkojnë në kujde-

sin e shërbimeve sociale, por pastaj do të zhduken shumë shpejt, duke u shfaqur në pjesë të tjera të Britanisë së Madhe. Shërbimet tona të inteligjencës sugjerojnë se ka rrjete që veprojnë në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar, të cilat ka lidhje në një shpërndarje mjaft të gjerë gjeografike".

AKK tha se rastet e punës së detyruar prekin "çdo qytet të madh" dhe në vitet e fundit ka pasur bastisje në sallonet e manikyrit në York, Berkshire dhe Torquay. Në Vietnam, biznesi i akademisë së thonjve po lulëzon, me studentët të etur për të lëvizur jashtë vendit.

Nuk dihet se sa sallone thonjsh

vietnamezë janë në Britaninë e Madhe, por Royal Mail ka zbuluar se në vitin 2016 janë hapur më shumë sallone bukurie se çdo biznes tjetër i pavarur. Në Derby ekzistojnë pesë sallone të ndryshme manikyri, të gjithë punësojnë të rinj vietnamezë dhe ofrojnë shërbime që fillojnë nga vetëm 10 paund, shtatë ditë në javë.

Pagesa bëhet vetëm në para në dorë dhe ka pak ndërveprim mes klientëve dhe stafit. Në vitin 2017, gjithsej 5145 njerëz u regjistruan në Mekanizmin Kombëtar të Referimit si viktimat të mundshme të skllavërisë - 739 ishin vietnamezë, grupi i tretë më i lartë pas shqiptarëve dhe britanikëve. Shtetasit vietnamezë përbënin numrin më të madh të viktimave të shfrytëzimit të punës dhe ishin referuar 362 fëmijë vietnamezë, nga 277 në vitin 2016.

Shifrat e lëshuara vitin e kaluar treguan se më shumë se 152 fëmijë vietnamezë në kujdesin e këshillit ishin zhdukur që nga viti 2015. Shumë prej tyre u zhdukën brenda dy ditëve. Anti-skllavëria bamirëse "Të padukshmit" këshillon klientët e salloneve të manikyrit të vërejnë nëse punëtorët e stafit duken të tërhequr ose jo të gatshëm për të punuar. (Daily Mail)

Kroacia, anëtarja më e pakënaqur e BE-së

Studimet më të reja për disponimin e banorëve të vendeve të Bashkimit Evropian (Eurobarometri) tregojnë se në shumë vende të cilat janë anëtarësuar së fundi po rriten simpatitë ndaj BE, por jo edhe në Kroaci. Gati 60% e të anketuarve e mbështet anëtarësimin në BE, ndërsa në Kroaci ka rënë kjo përqindje në vetëm 36%. Kjo do të thotë se numri i mbështetësve është zvogëluar me 7% brenda vetëm një viti.

Ndërsa 49% e kroatëve kanë një qëndrim neutral ndaj BE. Ndërkohë që 46% e shtetasve të Kroacisë mendojnë se gjërat në BE po shkojnë në drejtim të gabuar. Po pse kroatët kanë qëndrime kaq negative ndaj BE?

DËSHPËRIMI DHE MOSBESIMI

"Rënia e besimit nuk e befason askend", thotë Berto Shalaj nga Fakulteti i shkencave politike në Zagreb. Sipas tij, BE nuk është duke funksionuar si duhet në aspektin ekonomik dhe social, nuk është mundësuar një sistem më i mirë shëndetësor dhe një shkollim më i mirë. Ndërkohë që standardi i pensionistëve po bie gjithnjë e më shumë. Një aspekt tjetër proble-



Në Kroaci vetëm pesë vite pas futjes në BE është shtuar dukshëm qëndrimi negativ ndaj tij. Ekspertët thonë se kroatët kanë shumë shkaqe pse kanë qëndrime negative ndaj BE-së

matik është edhe sistemi i marrjes së vendimeve të rëndësishme në BE. Kroatët nuk janë mësuar me një nivel të lartë të demokracisë, ndërsa BE e ka rrënuar këtë sistem edhe më shumë.

"Brukseli e ka larguar mekanizmin e marrjes së vendimeve nga populli", thotë Shalaj. Parlamenti Evropian nuk pyetet për asgjë të rëndësishme, ndaj dëshpërimi është pasojë logjike. E gjitha kjo ka shkaktuar ngritjen e skepticizmit kroat ndaj BE.

MIGRIMET

"Kroacia dhe një pjesë e madhe e BE-së gjendet aktualisht mes teknokratizmit dhe populizmit. Mes distancimit dhe ekspertizës së Macronit dhe djathtëtëve që kanë fituar pushtetin në Itali", thotë Shalaj për DW. Sa i përket nivelit të shkencës në vend, Shalaj thotë se Kroacia nuk duhet të ikë nga përgjegjësia e vet. "Por fakt është që në këtë vend ka më pak mjete financiare për projekte serioze nga fondet evropiane. Nga këto fonde financohen vetëm

projektet e vogla dhe jo ato të mëdha dhe komplekse".

Ndërsa sociologu Toni Prug mendon se shkak i mungesës së mjeteve financiare ka të bëjë edhe me mungesën e interesit të shkencëtarëve kroatë për këto tema. Në BE ekziston frika nga rritja e influencës së nacionalizmit, por ende i besohet sistemit të tregut të hapur. Por problemet po shtohen.

Nga Kroacia është larguar një numër i madh i njerëzve e dihet që njerëzit ikin vetëm në kohërat e krizave, thotë Prug. Këtë gjendje e dëshmon edhe fakti që 29% e të ardhurave përdoren për ushqime. Mesatarisht në BE shpenzohen vetëm 12% e të ardhurave për ushqime. Të ardhurat në Kroaci janë më të ulëta se në vendet e tjera, ndaj është e qartë që gati një e treta e rrogave shpenzohet për ushqime. Banka e Zagrebit aktualisht jep kredi me interes prej 3,72%. Ndërsa UniCredit ofron në Itali kredi me interes prej 1-2%. Toni Prug thotë se në Kroaci kemi edhe një model të keq integrimi dhe lëshime të tjera. Ndaj nuk të befason fakti që në Kroaci po bie interesimi i njerëzve për BE. (Deutsche Welle)

Qepa konsiderohet nga mjekësia popullore e shumë shteteve të botës si një lëndë profilaktike, kurative, kundër sëmundjeve infektive, ngjitëse

1. Mjekët e lashtë në Rusi kundër dhimbjeve të forta të gjoksit rekomandonin fashatura me qull qepe të zier ose të pjekur që aplikohen në sternum në formë të ngrohtë, duke e përzier me pak gjalpë e mjaltë. Që në lashtësi njihet qepa e pjekur ose e zier që aplikohet lokalisht në furunkula e karbunkula, por me efikasë janë kataplazmat me qull-qepe të regjura në qumësht të nxehtë. Lëngu i qepës së njomë, të freskët i përzier me pak mjaltë rekomandohet për të lyer kapakët e syve përpara gjumit për të përmirësuar ndjeshëm pamjen, shikimin dhe për favorizuar dhe lehtësuar gjumin, në rast pagjumësie. Qepa konsiderohet nga mjekësia popullore e shumë shteteve të botës si një lëndë profilaktike, kurative, kundër sëmundjeve infektive, ngjitëse. Prandaj rekomandohet mbi ushqim me qepë në kohën e këtyre epidemive ose pandemive. Qepa njihet që nga lashtësia për vlerat e saj profilaktike e kurative kundër diabetit, prandaj rekomandohet si mbiushqim i zakonshëm, sidomos mbi 50-60 vjeç, të prirura më shumë për diabetin. Ushqimi me shumë qepë rekomandohet edhe si mjet profilaktik dhe kurativ përkundër aterosklerozës, përkundër adipozitetit (mbipeshës), reumatizmit. Qepa ka veti afrodiastike dhe antihelmintike. Rekomandohet për fëmijët.

2. Në mjekësinë popullore dhe shkencore të Austrisë, Bullgarisë,



QEPA KUNDËR PAGJUMËSISË DHE PËR SHIKIM MË TË MIRË

Polonisë, Kinës dhe më pak të Shqipërisë, qepa ka veti të larta ushqimore, dietetike e mjekësore në shumë fusha të jetës. Gatesat me qepë rekomandohen në sëmundjet e sistemit nervor qendror, si në: asteni, dobësi, distoni, lodhje, nevrasteni, në stresin nervor intelektual, në cefale e migrenë, në dizorientim, në insomni, në vertizhe, në epilepsi, në melankoli etj. Në disa nga këto sëmundje llapate me lëng ose me qull qepe aplikohen si kataplazma me fashaturë në ballë rreth kokës, rreth qafës, ku shpesh njomen edhe me pak uthull ose me pak vaj.

3. Gatesat e qepës së freskët e të njomë, si dhe gatesat e qepës së zier me ujë ose qumësht, si edhe

gatesat e pjekura me vaj ose me gjalpë shfrytëzohen gjerësisht në mjekësinë popullore të shumë shteteve të Evropës, Azisë, Amerikës e më gjerë, edhe për aplikime lokale, si: lëngje qull, llapa, kataplazma, në trauma të mbyllura, në goditje e shembje, në konfuzione, luksacione, madje me fashatura shtrënguese që shërbejnë si mjekime primare të urgjencës familjare mjekësore.

4. Gatesat e qepës përdoren me efikasitet të lartë në sëmundjet e aparatit respirator që shoqërohen me kollë e gëlbasë të theksuar dhe me vështirësi në frymëmarrje, sepse ato tregojnë veprim aktiv emolient ekspektorant pektoral, sekretolitik e spazmolitik,

duke zbutur dhe eliminuar fuqishëm gëlbasën dhe kollën dhe duke lehtësuar fuqishëm edhe gjendjen e të sëmurëve.

5. Qepa dhe gatesat e thjeshta të saj rekomandohen me efikasitet të lartë për parandalimin dhe mjekimin e sëmundjeve të gjithë traktit tretës, sepse ato tregojnë veprim amato-tonik, qetësues e karminativ, sekretolitik, anti fermentativ, spazmolitik, anti-dear-reik, anti hemoroidal, anti-inflamator si dhe veprim anti helmintik, anti parazitar, përkundër parazitëve të zorrëve, sidomos në fëmijët e vegjël, që në rrethin e Lushnjës arrijnë deri në 80% (parazit) bartës, (disertacioni i autorit të librit) etj.

Prindër kujdes: Kur fëmija juaj prek ekranin e telefonit, humb 16 minuta gjumë!



“Prindër mbani larg fëmijët nga ekranin e telefonit”, kështu ka deklaruar Tim Smith, mjek pediater, i cili mori pjesë në një studim më të fundit të kryer në Britaninë. Sipas rezultateve të studimit nëse një fëmijë qëndron përpara ekranit të telefonit përgjatë një ore, rrezikon të humbasë 16 minuta gjumë.

“Qasja e fëmijëve ndaj ekraneve celulare me prekje është gjithnjë e në rritje dhe kjo nënkupton gjumë të reduktuar. Shifrat janë vërtet alarmante dhe pas këtij studimi prindërit duhet të reflektojnë dhe në këtë mënyrë duhet t'i mbajnë fëmijët e tyre sa më larg telefonit. Sepse gjumi është faktori që siguron një rritje të shëndetshme”, është shprehur Smith. Përdorimi i telefonave celularë sipas studiuesve mund të sjellë pasoja të rënda për fëmijët pasi ul përqendrimin e tyre në shkollë si dhe ndikon në gjendjen emocionale dhe sociale. Nga anketat e bëra në Britani në lidhje me fëmijët që përdorin telefonat rezultoi se 75% e tyre prekin të paktën një herë në ditë një ekran telefoni, ndërsa 51% e të vegjëlve nga 6-11 muajsh luajnë nga një prekje e tillë teknologjike çdo ditë. Më tej, përdorimi i këtyre pajisjeve rritet në 92% për ata të moshës 25-36 muajsh. Në këtë mënyrë një foshnjë luan mesatarisht 25 minuta me pajisje të tilla, duke humbur kështu 6 minuta gjumë.

Konsumi i rregullt i çajit ul rrezikun e humbjes së kujtesës

Konsumi i rregullt i çajit mund të zvogëlojë rrezikun e humbjes së kujtesës me 50 për qind, tregon studimi i shkencëtarëve në Fakultetin e Mjekësisë në Universitetin e Singaporit. Studimi është realizuar me ndihmën e 957 kinezëve, konsumatorë të çajit. Ata në periudhën 2005-2015 kanë pirë rregullisht çaj sipas zakoneve dhe të dhënat e tyre në lidhje me sasinë e çajit të pirë ia dorëzuan studiuesve. Deri në vitin 2016, të anketuarit një herë

në dy vite i janë nënshtruar testeve të cilat, ndër të tjera, duhej të tregonin nivelin e kujtesës së tyre. Sipas rezultateve, konsumi ditor i çajit për 50 për qind ul rrezikun e problemeve të humbjes së kujtesës. Sa i përket të moshuarve, kur paraqitet rreziku i prekjes nga sëmundja e Alzheimerit, atëherë kjo shifër arrin në madje 86 për qind. Rezultatet e studimit janë publikuar në revistën “Journal of Nutrition Health&Aging”.



Përse na vjen gjumë pas një ushqimi të bollshëm



Një drekë apo darkë e mirë, i bën njerëzit më përtacë. Një studim amerikan tregon se edhe insektet flenë më gjatë pas ushqimit

Shkencëtarët e Institutit humltues “Scripps” në SHBA kanë krijuar sistemin me cilin mund të matni sjelljen e mizave të pemëve, kur është fjala për gjumin dhe ushqimin. Është konstatuar që insektet, sikurse edhe njerëzit, flenë më gjatë pas ushqimit.

Studimi ka treguar që lloje të caktuara të ushqimit çojnë në përgjumje pas ushqimit. Shkencëtarët kanë krijuar sistemin “Activity Recording CAFE” (ARC), i cili mundëson përcjelljen vizuale të konsumimit të ushqimit dhe lëvizjen e insekteve.

Rezultatet e sjelljes së mizave të pemëve pas ushqimit, kanë treguar që ato kanë fjetur më gjatë. Periudha e gjumit zgjat nga 20 deri në 40 minuta, ndërkaq mizat të cilat hanë më shumë në përgjithësi flenë më gjatë. Për të

konstatuar a mund të ndikojnë disa përbërës ushqimorë në gjumë pas racionit, shkencëtarët u kanë dhënë ushqim mizave i cili përbëhet nga proteinat, kripa apo sheqeri.

Pas studimit të bërë lidhur me këtë fakt është konstatuar që proteinat dhe kripa ndikojnë në gjumë pasi jemi ushqyer, gjë që tregon që këtë lloj gjumi vërtet e rregullojnë lloje të caktuara të ushqimit. Shkencëtarët shprehen se i njëjti studim i bërë me mizat e pemëve, vlen edhe për njerëzit.

Në bazë të nenit 172 të Ligjit për arsimin e lartë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 82/2018), Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore, shkencore, mësimore-profesionale dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës si dhe në mbështetje të nenit 144 të Statutit të Universitetit të Tetovës, shpallet

KONKURS

Për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore shkencore dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës

Shpallet Konkurs për zgjedhjen-rizgjedhjen e mësimdhënësve në të gjitha thirrjet mësimore-shkencore dhe të bashkëpunëtorëve në Universitetin e Tetovës:

FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE

- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Gjenetika
 - Inxhinieria gjenetike dhe bioteknologjia
 - Bioteknologjia farmaceutike
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Qarqet logjike I
 - Struktura e të dhënave
 - Teoria e kodimit dhe kriptografia
 - Teknologji informative (në Fakultetin Ekonomik)
- Një asistent për lëndët:
 - Elektroteknikë
 - Spektroskopji
- Një asistent për lëndët:
 - Algjebra vektoriale
 - Analiza matematike IIA

FAKULTETI JURIDIK

- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Sistemi politik
 - E drejta financiare
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - E drejta ndërkombëtare publike
 - Të drejtat e njeriut (në programin studimor Kriminalistikë)

FAKULTETI PEDAGOGJIK

- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Pedagogji shkollore
 - Arsimi multikulturor
 - Pedagogji familjare
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Didaktika e mësimdhënies së DNSH-së I dhe II, me praktikë pedagogjike
 - Etika pedagogjike
- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Intervenim i hershëm, edukim dhe rehabilitim me lojërë tek fëmijët me invaliditet trupor

- Orientim profesional, aftësim dhe punësim

FAKULTETI FILOLOGJIK

- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Gjuhë angleze V
 - Gjuhë angleze VI
- Një asistent për lëndët:
 - Gjuhë angleze I
 - Gjuhë angleze II

FAKULTETI I ARTEVE

- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Vizatim
 - Vizatim me pikturë

FAKULTETI I SHKENCAVE MJEKËSORE

- Një asistent për lëndët:
 - Fiziologjia I
 - Fiziologjia II

FAKULTETI I SHKENCAVE TË ZBATUARA

- Një asistent për lëndët:
 - Projektim urbanistik 2A
 - Projektim urbanistik 2B
- Një asistent për lëndët:
 - Bazat e projektimit
 - Konstruksione arkitektonike

FAKULTETI EKONOMIK

- Një mësimdhënës për lëndët:
 - Menaxhment financiar
 - Financa publike

Kushtet për thirrjen mësimore-shkencore docent, profesor inordinar dhe profesor ordinar:

- Thirrje mësimore – shkencore, me Vendim të organit kompetent, nëse e posedon;
- Diplomë për gradën shkencore doktor i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;

- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtër;
- Ta dorëzojë punimin e doktoratës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

Kushtet për thirrjen e bashkëpunëtorit:

- Diplomë për kryerjen e arsimit të lartë dhe marrjen e gradës shkencore magjistër i shkencave nga fusha shkencore në të cilën zgjidhet;
- Kandidatët që konkurrojnë duhet të kenë kontinuitet në studimet nga fusha përkatëse;
- Listë të punimeve shkencore dhe publikimeve profesionale të botuara, si dhe kopje të punimeve të publikuara;
- Biografi e shkurtër (CV);
- Ta dorëzojë punimin e magjistraturës;
- Vërtetim për njohjen e një gjuhe të huaj;
- Njohje të gjuhës shqipe - shkrim dhe lexim;
- Certifikatë nga libri amë i të lindurve;
- Certifikatë e shtetësisë.

*Kandidatët duhet t'i plotësojnë kushtet për zgjedhje në thirrje mësimore-shkencore dhe për zgjedhje në thirrje të bashkëpunëtorëve, të parapara me nenin 166 dhe 170 të Ligjit për arsimin e lartë.

*Fletëparaqitjen bashkë me dokumentet e nevojshme, kandidati duhet t'i dorëzojë në afat prej 5 ditë pune, nga dita e shpalljes së Konkursit, në Rektoratin e Universitetit të Tetovës, në adresën: Rektorati i Universitetit të Tetovës, Rr. e Ilindenit, p.n. Tetovë.

Tetovë, 02.06.2018
Universiteti i Tetovës



**Institucioni nacional
Enti për mbrojtje të përmendoreve
të përmendoreve dhe Muzeu - Strumicë**

**National Institution
Institute for Protection of Cultural
Monuments and Museum - Strumica**

Në bazë të nenit 21 dhe 22 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik, nenit 76 të Ligjit për kulturë të RM dhe nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune, IN Enti dhe muzeu – Strumicë publikon:

SHPLLJE

Për punësim për kohë të caktuar të 6 personave

I. Për nevojën për themelimit të marrëdhënies së punës për kohë të caktuar prej katër muaj në IN Enti dhe muzeu – Strumicë në vitin 2018, për vendet e punës në vijim:

- KUL0102V03001 bashkëpunëtor për resurse njerëzore (1) realizues;**
Kushtet e përgjithshme – të përcaktuara me ligj dhe të parapara me Rregulloren nr. 02-114/7 të datës 22.02.2017 për sistematizim të vendeve të punës në IN Enti dhe muzeu – Strumicë;
Kushtet e posaçme PSP, së paku 180 kredi ose shkallë të VII/1 të mbaruar – shkencat juridike;
Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
Njohje aktive të një prej gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane);
Neto pagesa fillestare për vendin e punës është 19.015 denarë
Marrëdhënia e punës është me orar të plotë të punës – 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte; ndërsa orari ditor i punës është prej ora 08:00 deri në ora 16:00.
- KUL0102V03002 bashkëpunëtor për furnizime publike (1) realizues;**
Kushtet e përgjithshme – të përcaktuara me ligj dhe të parapara me Rregulloren nr. 02-114/7 të datës 22.02.2017 për sistematizim të vendeve të punës në IN Enti dhe muzeu – Strumicë;
Kushtet e posaçme PSP, së paku 180 kredi ose shkallë të VII/1 të mbaruar – shkencat juridike ose ekonomike;
Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
Njohje aktive të një prej gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane);
Neto pagesa fillestare për vendin e punës është 19.015 denarë
Marrëdhënia e punës është me orar të plotë të punës – 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte; ndërsa orari ditor i punës është prej ora 08:00 deri në ora 16:00.
- KUL0304GJ02003 fotograf (1) realizues;**
Kushtet e përgjithshme – të përcaktuara me ligj dhe të parapara me Rregulloren nr. 02-114/7 të datës 22.02.2017 për sistematizim të vendeve të punës në IN Enti dhe muzeu – Strumicë;
Kushtet e posaçme PSP, së paku 180 kredi ose shkallë të VII/1 të mbaruar njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
Njohje aktive të një prej gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane);
Neto pagesa fillestare për vendin e punës është 19.015 denarë
Marrëdhënia e punës është me orar të plotë të punës – 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte; ndërsa orari ditor i punës është prej ora 08:00 deri në ora 16:00.
- KUL 0304D03004 punëtor profesional për përpilim të dokumentacionit (1) realizues**
Kushtet e përgjithshme – të përcaktuara me ligj dhe të parapara me Rregulloren nr. 02-114/7 të datës 22.02.2017 për sistematizim të vendeve të punës në IN Enti dhe muzeu – Strumicë;
Kushtet e posaçme PSP, së paku 180 kredi ose shkallë të VII/1 etnologji;
Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
Njohje aktive të një prej gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane);
Neto pagesa fillestare për vendin e punës është 19.015 denarë
Marrëdhënia e punës është me orar të plotë të punës – 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte; ndërsa orari ditor i punës është prej ora 08:00 deri në ora 16:00.
- KUL 0304D03004 punëtor profesional për mbrojtje të trashëgimisë arkitektonike (1)realizues;**
Kushtet e përgjithshme – të përcaktuara me ligj dhe të parapara me Rregulloren nr. 02-114/7 të datës 22.02.2017 për sistematizim të vendeve të punës në IN Enti dhe muzeu – Strumicë;
Kushtet e posaçme PSP, së paku 180 kredi ose shkallë të VII/1 arkitekturë, urbanizëm dhe planifikim;
Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
Njohje aktive të një prej gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane);
Neto pagesa fillestare për vendin e punës është 19.015 denarë
Marrëdhënia e punës është me orar të plotë të punës – 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte; ndërsa orari ditor i punës është prej ora 08:00 deri në ora 16:00.
- KUL 0304D03004 punëtor profesional për trashëgimi artistike (1) realizues;**
Kushtet e përgjithshme – të përcaktuara me ligj dhe të parapara me Rregulloren nr. 02-114/7 të datës 22.02.2017 për sistematizim të vendeve të punës në IN Enti dhe muzeu – Strumicë
Kushtet e posaçme PSP, së paku 180 kredi ose shkallë të VII/1 historia e arteve
Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
Njohje aktive të një prej gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane);
Neto pagesa fillestare për vendin e punës është 19.015 denarë
Marrëdhënia e punës është me orar të plotë të punës – 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte; ndërsa orari ditor i punës është prej ora 08:00 deri në ora 16:00.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët e interesuar duhet të parashtojnë:

- Certifikatë/diplomë për shkallën e mbaruar të arsimit
- Vërtetim/Dëshmi për njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- Vërtetim/Dëshmi për njohje aktive të gjuhëve
- Dëshmi se nuk i është shquar ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Certifikatë të shtetësisë.

Dëshmitë për përbushje të kushteve duhet të jenë në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter

II. Marrëdhënia e punës themelohet me orar të plotë të punës – 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte; ndërsa orari ditor i punës është prej ora 08:00 deri në ora 16:00.

III. Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të parashtojnë dëshmi me të cilat vërtetohet përbushja e kushteve të parapara.

IV. Shpallja zgjatë (5) pesë ditë pune nga dita e publikimit në shtypin ditor.

V. Fletëparaqitjet me dokumentacionin e nevojshëm të parashtohen në arkiv ose përmes postës në adresën në vijim: IN Enti dhe Muzeu – Strumicë, rr. 27 Mart numër 2 2400 Strumicë.

Në bazë të nenit 27 paragrafët (1) dhe (2) të Kodit zgjedhor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 40/2006, 136/2008, 148/2008, 155/2008, 163/2008, 44/11, 51/11, 142/12, 31/13, 34/13, 14/14, 30/14, 196/15, 35/16, 97/16, 99/16, 136/16, 142/16, 67/17, 125/17, 35/18 dhe 99/18) dhe nenit 5 të Ligjit për ndryshim të Kodit zgjedhor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 99/18), Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, në mbledhjen e mbajtur më 1 qershor 2018 solli

**VENDIM
PËR SHPLLJE TË ZGJEDHJES SË KRYETARIT,
NËNKRYETARIT DHE ANËTARËVE TË KOMISIONIT SHTETËTOR ZGJEDHOR**

- Kuvendi i Republikës së Maqedonisë shpall se do të bëjë zgjedhjen e kryetarit, nënkryetarit dhe pesë anëtarëve të Komisionit shtetëtor zgjedhor.
- Për kryetar, nënkryetar dhe anëtar të Komisionit shtetëtor zgjedhor mund të emërohet personi që përbushë kushtet nga neni 27 paragrafi (1) të Kodit zgjedhor:
 - të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë me vend të vazhdueshëm të banimit në Republikën e Maqedonisë,
 - të ketë arsim sipëror të mbaruar, m,e së paku tetë vjet përvojë pune dhe
 - të mos jetë anëtar i ndonjë organi të ndonjë partie politike.
- Kandidatët e interesuar të cilët përbushin kushtet nga neni 27 paragrafi (1) të Kodit zgjedhor fletëparaqitjen, biografinë personale dhe dokumentet e nevojshme për të dëshmuar përbushjen e kushteve, në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter, t'i parashtojnë deri në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë në afat prej tetë ditëve nga dita e publikimit të këtij vendimi në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.

Kandidatët e interesuar, me dokumentet nga paragrafi 1 të kësaj pike duhet të parashtojnë edhe deklaratë personale të vërtetuar në noter për përbushje të kushtit nga alinea 3 e pikës 2 të këtij vendimi.
- Ky vendim do të publikohet në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” dhe në gazetën “Nova Makedonija”, “Sloboden Peçat” dhe “Koha”.

KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Numër 08 - 3593/1
1 qershor 2018
Shkup


**KRYETARI I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË**

m-r Talat Xhaferi, d. v.


Se dokumenti është i besueshëm me origjinalin vërteton:

**ZËVENDËSSEKRETARI I PËRGJITHSHËM I
KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

Nexhbedin Ibraimi



Republika e Maqedonisë
Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup
Fakulteti i medicinës
Republic of Macedonia
Ss. Cyril and Methodius in Skopje
Faculty of Medicine



Në bazë të nenit 166, 172, 176, 217 paragrafi 2 i 227 të Ligjit për arsim sipëror ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 82/2018) dhe nenit 9, 10, 12 dhe 13 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë – doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 274/2013 – teksti i pastruar), Dekani i Fakultetit të medicinës në Shkup, në përbërje të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, publikon

KONKURS
Për zgjedhje të mësimdhënësve në të gjitha titujt mësimor-shkencor

I. Publikohet konkurs për zgjedhje të:

- 2 mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferën mësimore-shkencore:
 - Anatomi (30100);
- 2 mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferat mësimore-shkencore:
 - Mikrobiologji (30108)
 - Bakteriologji (30109)
 - Virusologji (30110) dhe
 - Parazitologji (30111);
- 1 mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferën mësimore-shkencore:
 - Kirurgji (30309) dhe
 - Kardiokirurgji (30301);
- 1 mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferën mësimore-shkencore:
 - Pediatri (30217) dhe
 - Sëmundjet për fëmijë me trajtim të fëmijës së sëmurë dhe të shëndoshë (30507);
- 1 mësimdhënës në të gjitha titujt mësimor-shkencor në sferën mësimore-shkencore:
 - Neurologji (30213).

II.
 Kandidatët të cilët do të paraqiten në Konkurs duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme nga Ligji për arsim sipëror ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 82/2018), si dhe kushtet në pajtim me kriteret ekzistuese të dhëna në Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë – doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup (Fletorja universitare nr. 274/2013 – teksti i pastruar).
 Kandidatët të cilët do të konkurrojnë duhet të paraqesin: fletëparaqitje, biografi të shkurtë, deklaratë për përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës, dokumente me të cilat do të dëshmohet përmbushja e kushteve dhe certifikatë të shtetësisë.
 Kandidati i zgjedhur do të lidhë marrëdhënie pune në pajtim me vendimin për zgjedhje në titullin përkatës mësimor-shkencor, ndërsa në bazë të dispozitave të Ligjit për arsim sipëror.
 Orari i punës së mësimdhënësit është përcaktuar në pajtim me aktet e Fakultetit.
 Fletëparaqitjet me dokumentacion të kompletuar dorëzohet në afat prej 8 ditëve duke konsideruar nga dita e publikimit të Konkursit në shtypin ditor, në arkivin e Fakultetit në rr. 50-ta Divizija nr. 6, Shkup..

Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup
Fakulteti i medicinës në Shkup

Në bazë të nenit 126 dhe nenit 128 të Ligjit për arsim fillor, Këshilli i shkollës pranë SHFK "Ismail Qemali" Gostivar në mbledhjen e mbajtur më datë 31.05. 2014 solli vendim që të shpall:

KONKURS

për zgjedhjen e drejtorit të SHFK "Ismail Qemali,, Gostivar

Për drejtor mund të zgjidhet personi i cili përveç kushteve të përgjithshme të caktuara me ligj duhet ti plotësojë edhe kushtet për arsimtarë, bashkëpunëtor profesional të ketë më së paku pesë vjet përvojë pune në procesin edukativo-arsimor , të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë.

Kandidati me lutjen duhet të dorëzojë edhe këto dokumente:

- diplomë për arsim të lartë
- vërtetim për përvojë pune
- certifikatë për shtetësi të RM
- certifikatë për dhënien e provimit për drejtor
- certifikatë se kundër kandidatit nuk është ngritur aktakuzë.
- Program për punë për periudhën katërvjeçare.


Konkursi zgjat 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit të kësaj shpalljeje.

Zgjedhja do të bëhet në afat prej 20 ditëve nga dita e mbarimit të konkursit.

Lutjet me dokumentet e nevojshme të dorëzohen në SHFK „ Ismail Qemali” Gostivar, rr."Leningradaska,, pn. Gostivar

0401-222
 01.06.2018
shkollës
 Gostivar

Nga Këshilli i



Republika e Maqedonisë

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 pika 1 dhe nenit 23 të LMP Gazeta Zyrtare e RM nr. 167/15, nenit 79-d të Ligjit për arsim fillor, nenit 6 të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik, Rregullores për sistematizim të vendeve të punës dhe përqimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës nr. 12-12701/5, SHFK 26 Korriku, Shuto Orizarë – Shkup publikon:

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR 04-193

SHFK 26 Korriku, Shuto Orizarë – Shkup ka nevojë për themelimin të marrëdhënies së punës për kohë të pacaktuar për vendet e punës në vijim:

Numër 1 Niveli A1 002. Shifra OBN 04 01 A01 001 mirëmbajtës të higjienës pesë (5) realizues me arsim fillor të mbaruar ose PMP me pagesë fillestare prej 12.000,00 denarë.

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë
- Të jetë i moshës së rritur
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore
- Me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme: me ose pa përvojë pune

Orari i kohës së punës:

- Ditët e punës prej ditës së hënë deri ditën e premte, orët e punës në javë 40, orari i punës ndërrimi i parë prej ora 06,00 deri në ora 14,00 dhe ndërrimi i dytë prej ora 12,00 deri në ora 20,00.
- Shpallja zgjat 5 ditë pune, duke konsideruar nga dita e publikimit në shtypin ditor.
- Zgjedhja në lidhje me shpalljen do të bëhet në afat prej 30 ditëve nga dita e përfundimit të shpalljes.
- Kontrollimi i fletëparaqitjeve dhe dëshmi.


Lutjet së bashku me dokumentet e nevojshme të paraqiten në SHFK "26 Korriku Shuto Orizarë – Shkup, rr. Indira Gandhi nr. 31, tel. 02 2650-453, personi për kontakt Vesna Niçevska.

01.06.2018
 Shkup


Drejtor
 Dritan Ganiu

Shpallje

Shitet shtëpia në Gazi Babë me sipërfaqe prej 100m2, posedon 4 dhoma, bodrum dhe oborr, e rinovuar në gjendje shumë të mirë, çmimi 52.000 euro me mundësi për marrëveshje kontakt tel. 078-353-988



REPUBLIKA E MAQEDONISË
Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" – Shkup
Fakulteti për shkencë informatike dhe inxhinieri kompjuterike



Në bazë të nenit 176 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë nr. 82/18) dhe Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" – Shkup (Fleta universitare nr. 274/13), Dekani i Fakultetit për shkencë informatike dhe inxhinieri kompjuterike në Shkup publikon:

KONKURS
Për zgjedhje në titujt

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor në të gjitha sferat mësimore-shkencore të fushës mësimore-shkencore informatike dhe fushës mësimore-shkencore teknika kompjuterike dhe informatike
2. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor në të gjitha sferat mësimore-shkencore të fushës mësimore-shkencore informatike dhe fushës mësimore-shkencore teknika kompjuterike dhe informatike

Kushtet: Krahas kushteve të përgjithshme të parapara me nenin 166 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë nr. 82/18) kandidatët duhet ti plotësojë edhe kushtet e posaçme të parapara me Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë dhe doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup Fleta universitare nr. 274/13).

Orari i punës do të përcaktohet në pajtim me orarin e orëve.

Pagesa për pozitën 1 lëvizë prej 28.000,00 deri më 44.000,00 denarë.

Pagesa për pozitën 2 lëvizë prej 28.000,00 deri më 44.000,00 denarë.

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë: fletëparaqitje sipas konkursit në të cilën do të qëndrojë se për cilën pozitë paraqiten, dokument për arsimin e mbaruar përkatës, (diplomat e huaja të jenë të nostrifikuara dhe të plotësuara me ekuivalencë të notave), biografi të shkurtë, certifikatë të shtetësisë, listë të punimeve të publikuara shkencore dhe profesionale (nga një kopje të punimeve);
 Zgjedhja do të realizohet në afatin e paraprirë me ligj.
Dokumentet të dorëzohen në original ose kopje të vërtetuar në noter – fletëparaqitjet të cilat nuk janë të plotësuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.
 Fletëparaqitjet të dorëzohen më së voni 8 ditë nga dita e publikimit të konkursit në Dekanatin e Fakultetit për shkencë informatike dhe inxhinieri kompjuterike, rr. Rugjer Boshkoviq 16, Shkup.

Fakulteti për shkencë informatike dhe inxhinieri kompjuterike

SHMK "Orde Çopella" – Prilep në bazë të ligjit për marrëdhënie pune nenit 22 dhe 23, Ligjit për arsim të mesëm nenit 72 dhe 73, pëlqimit të MASH 12-5112/2 të datës 21.05.2018, vendimit për publikim të shpalljes 02-140 të datës 01.06.2018 Drejtori publikon në vijim:

SHPALLJE

Për pranim të bashkëpunëtorit profesional për kohë të caktuar të punës

Neni 1

1. Një punëtor social me orar të plotë të punës 40 orë punë në javë me neto pagesë prej 20.000,00 denarë deri më 31.08.2018. Kandidatët të kenë të mbaruar fakultetin filozofik – Punë sociale dhe politikë sociale.

Neni 2

Dokumentet e nevojshme gjatë konkurrimit

1. Kërkesë pa taksë administrative;
2. Karton nga Agjencia për punësim
3. Diplomë për arsim të mbaruar përkatës
4. Certifikatë të shtetësisë së R. Maqedonisë
5. Certifikatë se nuk është i dënuar

Neni 3

Shpallja zgjatë pesë ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor. Dokumentet e pakompletuara dhe të parashtruara pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

u. d Drejtor
Dimitrijanka Manoleva

Në bazë të nenit 92 – a nga Ligji për arsim të mesëm (Gaz. zyrtare e RM- së nr. 67-2017) , Këshilli i shkollës i SHMK " Negotinë " Negotinë solli vendim për të publikuar :

SHPALLJE PUBLIKE
PËR ZGJEDHJE TË DREJTORIT TË SHKOLLËS

Kandidati përveç kushteve të përcaktuara me Ligj , duhet ti plotësojë edhe kushtet për arsimtarë , pedagog ose psikolog dhe të ketë së paku 5 (pesë) vite përvojë pune në veprimtarinë edukativo – arsimore .

Së bashku me kërkesën kandidati duhet ti komplettojë dhe ti dorëzojë dokumentet si në vijim :

- Biografia e kandidatit ,
- Diploma ose vërtetim për arsim të lartë
- Certifikatë për provimin e kryer për Drejtor shkolle ,
- Vërtetim me të cilin vërtetohet përvoja e punës
- Certifikata e shtetësisë ,
- Vërtetim se nuk është nën hetime
- Program të shkurtër pune 5 (pesë) vite

Shpallja është e hapur 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.
 Kërkesa me dokumentet e nevojshme duhet të dorëzohet në adresë :
 SHMK " Negotinë " f. Negotinë e Pollogut – komuna e Vrapçishtit .
 Dokumentacioni i pakompletuar dhe i dorëzuar jo në kohë nuk do të merret parasysh nga ana e komisionit .

Këshilli i shkollës
SHMK " Negotinë " Negotinë

Në bazë të nenit 126 paragrafi 1 alineja 7 dhe nenit 132 të Ligjit për arsim fillor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 103/08, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13, 41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16, 127/16, 67/17, 64/18), dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës së Manastirit nr. 08-439/1, Këshilli i shkollës pranë SHF "Elpida Karamandi" Manastir publikon:

SHPALLJE PUBLIKE
Për zgjedhje të drejtorit të shkollës

1. Kandidatët për drejtor krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj, duhet të përmbushin edhe kushtet për mësimdhënës ose bashkëpunëtor profesional në shkollë fillore,
 - ka së paku 5 vjet përvojë pune në punë edukativo-arsimore
 - ka provim të dhënë për drejtor
 - ka shtetësi të R. Maqedonisë
2. Kandidatët për drejtor të shkollës duhet të paraqesin dokumentet në vijim:
 - Fletëparaqitje;
 - Diplomë për arsim të mbaruar sipëror;
 - Vërtetim për së paku pesë vjet përvojë pune në institucion edukativo-arsimor të verifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së RM;
 - Certifikatë për provim të dhënë për drejtor të shkollës fillore;
 - Certifikatë të shtetësisë së Republikës së Maqedonisë;
 - Dëshmi se kandidati për drejtor nuk ka aktakuzë që është futur në fuqi ligjore të dhënë nga Gjykata themelore e vendlindjes (dëshmia të mos jetë më e vjetër se gjashtë muaj);
 - Dëshmi se kundër kandidatit nuk është shqiptuar dënim ose sanksion – ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës të dhënë nga organi kompetent (dëshmia të mos jetë më e vjetër se gjashtë muaj);
 - Program për punë për periudhë prej 4 vjet
3. Orari i punës në javë është 40 orë
4. Neto të ardhurat personale janë 26 760 denarë
5. Shpallja publike publikohet në shtypin ditor dhe zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit
6. Zgjedhja do të realizohet në procedurë dhe afate të përcaktuara me ligj
7. Dokumentet e nevojshme në zarf të mbyllur mund të paraqiten personalisht ose përmes postës në adresën: SHF "Elpida Karamandi" Manastir, rr. "Vasko Karangelevski" – pn – Manastir, me shenjë deri te Këshilli i shkollës – shpallje për drejtor. Tel. 047/253 - 798
8. Dokumentet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit do të refuzohen dhe nuk do të shqyrtohen nga ana e Komisionit.

Manastir, 31-05-2018 Këshilli i shkollës së SHF "Elpida Karamandi" Manastir

ÇELËSI I SË ARDHMES!

Gjuha që pasanikët
“vrapijnë” t'u
mësojnë fëmijëve



Të mësuarit një gjuhë të huaj të dytë a të tretë na ofron përfitime të shumta, por një gjuhë në veçanti duket se përbën avantazh ndaj gjuhëve të tjera. Njësoj siç ka qenë latinishtja para qindrave viteve, apo anglishtja në kohët moderne, ajo që shihet si e ardhmja, duket se është gjuha mandarin (kineze). Familjet më të pasura, familjet mbretërore po nxitojnë t'u mësojnë fëmijëve këtë gjuhë, që në moshë të herët. Rreth 1.2 miliardë njerëz flasin këtë gjuhë dhe kjo e fundit përfshin dy dialekte kryesore gjuhën kineze - mandarin dhe kantoneze. Themeluesi i Amazon Jeff Bezos dhe gruaja e tij MacKenzie kanë katër fëmijë dhe njeriu më i pasur në botë ka pohuar për Vogue se mësimi i kinezishtes ka qenë vendimi më i mirë, që ka marrë ndonjëherë për fëmijët e tij! Kina është e ardhmja ka thënë bilioneri. CEO i Facebook Mark Zuckerberg mori mësimin Mandarin disa vjet më parë dhe u përmirësua aq shumë brenda një kohe të shkurtër. Gruaja e tij, Priscilla Chan, është vajza e refugjatëve kinezë që ikën nga Vietnami dhe ajo flet rrjedhshëm kantoneze. Max vajza e vogël e çiftit e flet rrjedhshëm këtë gjuhë gjithashtu. Ivanka Trump dhe Jared Kushner kanë tre fëmijë dhe kanë punësuar një dado kineze për të ndihmuar fëmijët ta mësojnë më shpejtë këtë gjuhë. Vajza e tyre më e madhe Arabella, 5 vjeç këndoi një vit më parë në gjuhën kineze këngën e Vitit të Ri. Çifti mbretëror William dhe Kate po shpejtojnë gjithashtu t'u mësojnë fëmijëve kinezisht. Princi George, 4 vjeç e ka filluar mësimin e kësaj gjuhe në shkollën Thomas Battersea në Londër.

A E SHËRON DROGA KANCERIN?

Çështje më e rëndësishme, nuk ka prova se kanabisi ka ndonjë efekt kurativ ose edhe të dobishëm mbi kancerin, pavarësisht pretendimeve entuziaste për të kundërtën

Për mijëra vjet njerëzit kanë përdorur kanabis për qëllime rekreative, ritualiste dhe mjekësore. Kryesisht ekzistonte bindja se kanabis mund të kuronte kancerin. Dëshmi të mahnitshme rreth kanabisit dhe produkteve të saj që rrjedhin nga tkurrja e tumoreve ose kurimin në fazën e hershme të tyre, gjenden lehtësisht në internet.

Por, këto histori priren të bazohen në

keqkuptime, në mendime të dëshiruara ose në gënjeshtëri të plotë. Përkundër asaj që shumica e njerëzve besojnë, përdorimet mjekësore të kanabisit janë studiuar gjerësisht. Një rishikim i mbi 10.000 studimeve nga Akademia Kombëtare e Shkencave, zbuluan disa aplikime të kanabisit, duke përfshirë menaxhimin e dhimbjeve kronike dhe spazmave të lidhura me sklerozë të shumëfishtë.

Ka pasur gjithashtu dëshmi të mirë se tetrahydrocannabinol (THC), përbërësi kryesor psikoaktive në kanabis, mund të zvogëlojë ndjenjën e të vjellave, të shkakuar nga kimioterapia. Në të vërtetë, një formë sintetike e THC, e quajtur dronabinol, është përshkruar për këtë përdorim gjatë dekadave. Por, çështje më e rëndësishme, nuk ka prova se kanabisi ka ndonjë

efekt kurativ ose edhe të dobishëm mbi kancerin, pavarësisht pretendimeve entuziaste për të kundërtën.

Pse atëherë ka një ndarje të tillë mes perceptimit të publikut dhe provave shkencore? Një pjesë e kësaj është keqkuptimi. Për shembull, një kërkesë e transmetuar shpesh është se THC me dozë të lartë vret qelizat e kancerit. Kjo është e vërtetë, por jo shumë domethënëse. Vrasja e qelizave është jashtëzakonisht e lehtë, ju mund ta bëni këtë në shumë mënyra, nga nxehtësia deri tek sterilizimi i qelizave.

Por, agjentët efektiv kundër kancerit duhet të jenë në gjendje të vrasin në mënyrë selektive qelizat e kancerit në trupin e njeriut, duke kursyer ato të shëndetshme. Realiteti është se kanabisi thjesht nuk mund ta bëjë këtë gjë.

Mosha kur fillojnë problemet me prostatën



Prostata mund të sëmuret në çdo moshë të mashkullit dhe jo vetëm në moshën e pleqërisë (në pleqëri zakonisht ajo preket nga sëmundja e zmadhimit (hypertrofia). Mjekimet për këtë sëmundje janë të shumëllojshme dhe më efektive janë mjekimet e kombinuara (fizioterapi, injeksione, dietat ushqimore etj). Janë mjekime që zgjasin dhe kërkojnë mjaft durim nga pacienti dhe nga mjeku. Për këtë arsye shumë mjekë në botë nuk preferojnë të merren me këta pacientë dhe për pasojë pacientët sorollaten në shumë klinika dhe mjekë, me analiza pa fund dhe bien në dëshpërim, kryesisht sepse mendojnë që kanë ndonjë sëmundje të rëndë që nuk ka shërim. Por zakonisht, kjo sëmundje shërohet me pak vullnet dhe optimizëm, sidomos në moshat e reja dhe sa më shpejt që të fillojnë mjekimet e duhura.

Vendi i parë që ndalon duhanin jashtë

Uells do të ndalojë pirjen e duhanit në ambiente të hapura duke nisur nga vera e ardhshme dhe duke u bërë kështu vendi i parë në Mbretërinë e Bashkuar që e ndryshon këtë ligj. Pritet që deri në verën e 2019-s, nëpër oborret e spitaleve, shkollave dhe parqet për fëmijë të jenë ngritur zona të posaçme për duhanpirës, pasi pirja e duhanit në natyrë nuk do të lejohet.

Sipas qeverisë në këtë shtet, sh-trëngimi i ligjeve për pirjen e

duhanit në publik do të mbrojtë jo duhanpirësit dhe do të zhbëjë konceptin e duhanit si diçka normale tek fëmijët dhe të rinjtë. Teksa pjesa më e madhe e shkollave dhe spitaleve kanë politika kundër duhanpirjes në ambientet e tyre të jashtme, për stafin është e vështirë që ta mbajë situatën nën kontroll. Këto ndryshime në ligj parashikojnë gjopa për këdo që e shkel atë.

Sekretari i Shëndetit u shpreh krenar që "Uells vijon të jetë i pari

në Mbretërinë e Bashkuar që merr masa për të ulur numrin e duhanpirësve dhe për të parandaluar të rinjtë që ta nisin". Sipas tij, që prej vitit 2007 vendi ka parë ndryshime domethënëse sa i përket qëndrimit që kanë qytetarët ndaj duhanpirjes. Duhanpirja kontribuon në shfaqjen e një sërë sëmundjeve në Uells, me përafërsisht 5,450 vdekje në vit dhe duke i shkakuar sistemit shëndetësor një dëm prej 302 milion paund në vit.





DASHI 21. mars - 20. prill

Një fundjavë nervoze për të lindurit e kësaj shenje. Këtë ditë mund të keni probleme por që janë lehtësisht të zgjidhshme në ditët e ardhshme. Hëna do ndikojë pozitivisht për juve këtë të diel.



DEMI 21. prill - 21. maj

Pas disa ditësh të mira, në këtë fund jave mund të pësoni një moment rënieje. Në dashuri jeni në një çast pritjeje. Yjet nuk janë favorizues për juve në fushën e zemrës këtë ditë.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Një fundjavë mjaft e bukur sa i takon ndjenjave. Vihuni në lëvizje për të ndjerë emocione të bukura. Mund të ndjeni pak lodhje në fundin e ditës. Por, në tërësi pritet një ditë e mbarë për juve.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Në fundjavë mund të lindin debate në familjen tuaj. Këtë të diel ju do të ndiheni më energjik fizikisht por edhe mendërisht do ndiheni më mirë. Fundjava do jetë mjaft e mirë sa i takon dashurisë.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Një fundjavë jo shumë e mirë për juve. Po ashtu, jeni të predispozuar për konflikte me persona të ndryshëm. Mundohuni të shmangni debatet këtë të diel pasi kjo nuk është dita juaj me fat.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Një fundjavë interesante për juve. Këtë të diel ju do të kaloni emocione mjaft të bukura. Yjet janë tepër favorizues edhe sa i takon punës. Kjo mund të çelsohet një ditë mjaft e mirë për juve.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Ndiheni mjaft energjikë këtë ditë. Mund të përballeni edhe me sqarime të rëndësishme me persona të caktuar. Sa i takon punës, priten ndryshime rolesh për juve këtë fundjavë.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Këtë fundjavë ju do kaloni momente force. E diela do jetë ditë e mirë për të lindurit e kësaj shenje. Në dashuri do të jetoni momente të bukura. Yjet janë në favorin tuaj, shijojeni këtë ditë.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Do të jetë një ditë me luhatje për të gjithë të lindurit e kësaj shenje. E diela gjithsesi pritet të jetë një ditë e mirë për juve pasi keni hënë në favor. Kujdes në punë, priten disa përplasje.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Këtë të diel ju do të keni hënë në favor. Një ditë relativisht e mirë kjo për juve. E diela mund të cilësohet si dita e rimëkëmbjes në disa drejtime.




UJORI 21. janar - 19. shkurt

Këtë të diel ju mund të keni disa takime interesante. Nuk duhet të mbylleni në shtëpi. Dilni dhe argëtohuni. Do të jeni mjaft energjik. Shfrytëzoni momentin!



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Ju po përjetoni momente mjaft të mira. Qershori do të jetë muaji juaj dhe priten rezultate pozitive në çdo aspekt. Këtë të diel, ju mund të përjetoni disa emocione mjaft të bukura.

Mensur Mamuti	XHAMIA E SHENJË NE JERUSALEM	SISTEM I KOMUNIKIMIT ME TELEGRAF	OPUS	DYSHEK AGJENTI I DYFISHTË GJAKOVAR, HASAN	SH	U	KËNGËTARJA HUJSTEN ISH AMBASADORI SHQIPTAR NE AUSTRI (FOTO)	ISH ÇIKLISTI FRËNG, BERNAR	QË SJIJELL FITIM ORGANIZATA KRIMINELE ITALIANE	F				
ZBUTJIA E GODITJEVE (TE AUTOMJETET)														
BALLINA DHE FAQJA E FUNDIT E LIBRIT														
STRONCIUMI			KIK-BOKSIERI HOLANDEZ MELVIN											
ELEMENT KIMIK (AT)			TEMPERATURA					IBRAHIM MUÇAJ						
														
					I DORËZUJ									
					HEKTARI								RUMANIA	
					AKADEMIKU YNË, ALI								SHPREHJA FRAZEOLOGJIKE	
					ISH PRESIDENTI IRANIAN, BANI									
					KALIUMI								I.Ë.	
KËNGËTARJA AMERIKANE, TORI								ERË VERIPERËNDI-MORE (NE ADRIATIK DHE MESDHE)						
EMRI I MORISONIT (ORIGJINALI)										SHUND				
AKTORI SHARIF														
KOHA	KRYEQYTETI I KATARIT	JETË E QETË DHE E LUMTUR	LIDHËZ (PËR SHKAK SE)	LITRI	OKSIGJENI	INSTRUMENT FRYMOR	LLOJ RRJETE PESHKIMI	ELEMENT I ÇMUAR (KUARC)						
PROFESIONI TJETËR (POLITIK) I PERSONIT NE FOTO									ITALIA					
DHOMA									POHIM ÇEK					
PROFESIONI I PERSONIT NE FOTO										REOMIRI				
VOGËLUSHJA E BOTËS SË ÇUDIRAVE								ELEMENT KIMIK (CL)						

ZGJIDHJET: SHU, F, AMORTIZIMI, KOPERTINAT, SR, MANHOFFI, ASTATIN, IM, I JAR, HA, R, ALIU, SADR, K, IË, AMOS, JIM, O, SAK, DIPLOMAT, I, ODA, BAKRAÇ, HISTORIAN, ALISA, KLOOR.

Shumë i lehtë **Sudoku** mesatar

2		7				1		5			6	5			3		
			1	6							2			3	5		
	4			3				9	9					7			2
7	1	9				6	2	8	6	4				2	7		5
	6							3									
									8			4					9
	9			7			4		1					6			7
				1	3						8			4	2		
6		8				7		3			9	1			8		

Shumë i lehtë: 237948165, 985162374, 146537892, 719354628, 564281937, 823796451, 391875246, 472613589, 658429713. Mesatar: 716528394, 482913576, 935647182, 694832715, 351769428, 827451639, 143286957, 578394261, 269175843.

Gjykata dënon burrin që i dërgoi ish-gruas 7648 mesazhe telefonike

Një burrë, i cili ish-bashkëshortes së tij i kishte dërguar 7648 mesazhe në telefon, u shpall fajtor nga një gjykatë austriake në qytetin Klagenfurt. Ai u dënua me gjashtë muaj burgim me kusht.

Rumuni 33-vjeçar ishte ndarë nga gruaja para gjashtë muajve dhe kishte reaguar shumë keq pas thyerjes së dashurisë, kështu që nisi të dërgojë SMS, në 50 prej të cilëve kërcënoi ish-bashkëshorten.



I pyetur se si kishte arritur të dërgojë mesatarisht 190 SMS mesazhe në ditë dhe që të kryejë të gjitha detyrat në punë njëkohësisht, ai u përgjigj se mesazhet i shkruante kryesisht natën.

Gjykata përfundimisht vendosi që dënimi të shpallet i kushtëzuar, pasi që

burri ndaloi të keqtrajtojë ish-bashkëshorten, pak kohë pasi e ka njoftuar policinë.

Ai premtoi se do të paguajë alimentacionin për djalin e përbashkët. Agjencia APA shkruan se ndërtesën e gjykatës ata e lëshuan së bashku.

Revolucioni i Coca-Cola, shet pije alkoolike në Japoni

Coca-Cola ka nisur për të parën herë në histori prodhimin e pijeve alkoolike, që korenspondon me një pije alkoolike me limontë hedhur në treg në Japoni. Kjo është një përpjekje për të kapur tregje dhe konsumatorë të rinj. E para në botë në tregun gjigant të pijeve, kompania nga SHBA shiti tre pije me limon të lëngshëm të hënën, duke i dhënë jetë revolucionit të saj. Produkti synon një treg në rritje të "pijanecëve" të rinj, sidomos grave. Të përshkruara nga Coca-Cola si "unike" në historinë 125-vjeçare të kompanisë, të tre pijet alkoolike të prodhuara kanë nga 3% deri në 8% alkool. Në përputhje me traditën e kompanisë, receta është e ruajtur me kokfortësi, por pijet janë modeluar në bazë të pijes popullore Chu-Hi të Japonisë, zakonisht një përzjerje e shpirtit lokal dhe një sërë aromash frutash.



Chu-Hi, një shkurtime për "shochu highball", janë shitur si një alternativë për birrën, duke u provuar veçanërisht në masë të gjerë tek femrat. Kompanitë lokale si Suntory, Asahi dhe Kirin aktualisht dominojnë sektorin për pije të konservuara Chu-Hi. Shijet më të njohura janë agrumet e forta si grejpfrut ose limon, ndërsa kjo e fundit është shija që Coca-Cola tani dëshiron të shpërndajë duke vendosur diktatin në treg. Coca-Cola thotë se nuk ka plane për të nxjerrë pijet e reja në tregjet jashtë Japonisë. Pijet Alcopop boomed në Evropë dhe në Mbretërinë e Bashkuar

në vitet 1990, por edhe Smirnoff Ice dhe Bacardi Breezer u bënë jashtëzakonisht popullore. Ato ishin të diskutueshëm dhe inkurajuan të rinjtë për të pirë më shumë alkool për shkak të shijes së butë.

Zyrtari i Taxhikistanit shpall boksin "haram"

Një zyrtar i lartë në Taxhikistan i shpalli boksin dhe sportet luftarake "pa rregulla, haram", apo të ndaluara me ligjin islamik. Saidmukarram Abdulkodirzoda, kryetari i Këshillit Islamik Ulema të Taxhikistanit, tha gjatë faljes së xhumasë në Dushanbe se sportet e tilla luftarake janë të ndaluara sepse mund "të dëmtojnë" shëndetin e njeriut. "Sidomos boksi dhe sportet luftarake pa rregulla konsiderohen haram nga pikëpamja fetare, sepse mund të dëmtojnë shëndetin, ta bëjnë të paaftë dikë", tha Abdulkodirzoda. "Të gjitha llojet e lojërave dhe dueleve që bëhen për para, janë haram", shtoi ai.

Apartamenti i Titos në New York shitet për 12 milionë euro

Apartamenti dykatësh në New York në pronësi të ish-Jugosllavisë do të shitet me vlerë prej 12.1 milionë dollarë ndërsa paratë nga shitja do të ndahen mes vendeve të ish Jugosllavisë, ka bërë të ditur Ministria e Punëve të Jashtme të Serbisë. Apartamenti i cili ka gjashtë dhoma gjumi dhe katër banjo është shfrytëzuar nga ambasadorët jugosllavë në SHBA e në të ka qëndruar dhe ish kryetari Josip Broz Tito gjatë vizitave në New York. Apartamenti, i cili nga viti 1992 qëndron i zbrazur është blerë në vitin 1975 në shumë prej 100 mijë dollarë, shpenzimet për mirëmbajtje i ka paguar deri më sot Serbia andaj kërkon 40 për qind nga shitja.



1039 - Henri III shpallet Perandor i shenjtë romak
1632 - Princi Frederik Henri okupon Venlon
1647 - Ushtria britanike arreston Mbretin Çarlsin I
1745 - Frederiku i Madh i Prusisë mund austriakët dhe saxonët
1784 - Madam Elizabeth Thible - fluturuesja e parë femër me balon
1800 - Përfundon ndërtimi i Shtëpisë së Bardhë. Vendosen kryetari Xhon Adams dhe bashkëshortja e tij.
1845 - Fillon lufta mes SHBA dhe Meksikës
1928 - Presidenti i Republikës së Kinës Zhang Zuolin vritet nga agjentë Japonez
1940 - Forcat gjermane futen në Paris
1941 - Nazistët ndalojnë hyrjen hebreje në plazhe dhe pishina
1944 - Gjenerali francez De Goll arrihet në Londër
1945 - SHBA, Rusia, Anglia dhe Franca pajtohen të ndajnë Gjermaninë
1991 - Qeveria e parë jo komuniste pas Luftës së II Botërore në Shqipëri
1991 - Papa Xhon Pali II krahason abortin me vrasjet naziste

KALENDARI HISTORIK 4 QERSHOR



Princesha Charlotte nuk mund të ulet me të rriturit në darkat mbretërore! Fëmijët e familjes do t'u duhet të ulen në tavolinën e të vegjëlve, derisa ata të mësojnë "artin e një bashkëbisedimi të sjellshëm". Fustani me jakën e Piter Pan, është veshja e ditës! Sa herë që Charlotte është parë në publik, ajo ka patur të njëjtën formulë veshje; një fustan me ngjyra të ndryshme me jakën e Piter Pan. Gjithashu edhe i vëllai George gjithmonë mban veshur pantallona të shkurtra, dhe çorape. Charlotte ka gjithmonë një fjongo në kokë. Nëse nënat ne na kanë mësuar se nuk je asnjëherë e veshur sa duhet, kur nuk ke një buzëqeshje në fytyrë, për princeshën është fjongo në flokë, që plotëson 'outfit-in' e ditës, që zakonisht kombinohet me ngjyrën e fustanit.

3 LLOJET E ÇIFTEVE

Në këtë botë ekzistojnë tre lloje çiftesh.

1. Ata që kanë një profil në Facebook me emrat e të dyve!
2. Ata që kanë secili profilin e vet, por që tërë kohës rrinë nëpër profilet e njëri-tjetrit.
3. Ata që nuk kanë profile hiç, por ekzistojnë diku në hijen e "djali king" ose "princesha jote"...



Nuk është shenjë e mirë e shëndetit mendor të jesh përshtatur mirë në shoqëri të sëmurë.
(Jiddu Krishnamurti)

A E DINI SE...

BARSOLETA

THËNIA E DITËS